



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 4 NËNTOR 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 28.10.2019 *(neni 44 i Rregullores)*
2. Njoftimi i akteve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*
3. Interpelancë urgjente me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, kërkuar nga një grup prej 8 deputetësh të opozitës *(neni 80 i Kushtetutës dhe 97 i Rregullores)*
4. Akt normativ nr. 2, datë 02.10.2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”” *(nenet 78 dhe 101 të Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje
Shprehet nismëtari.
Shprehet Komisioni përgjegjës për
Ekonominë dhe Financat.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare.)
Koha e votimit
5. Akt normativ nr. 3, datë 02.10.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar *(nenet 78 dhe 101 të Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*
Pyetje
Shprehet nismëtari.
Shprehet Komisioni përgjegjës për
Ekonominë dhe Financat.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare.)
Koha e votimit

5. Projektligji “Për rininë” (neni 78 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin Europian.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

6. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës” (nenet 121 dhe 122 të Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

7. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (neni 45 i Rregullores)

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta.

Gramoz Ruçi – Uluni, kolegë deputetë!

Ftohen mediet të futen në sallë.

Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Ka vërejtje për procesverbalin?

Kostaq Papa – Përsëritet, kolegë deputetë!

Zoti Kryetar, nuk mund të ngrihet në çdo seancë çdolloj deputeti dhe të na flasë për festën e Vietnamit apo për festën e ndonjë vendi fqinj, në një kohë që jemi në parlamentin e Shqipërisë dhe të gjithë këtu janë deputetë shqiptarë. Kështu që mendoj që nga procesverbali i herës së kaluar të shuhet një paragraf, sikur nuk ekziston fare, sepse nuk ka të bëjë fare me seancën.

Dua t’u bëj edhe një herë thirrje deputetëve, meqë unë mbroj dhe do të mbroj gjithmonë vijën kombëtare, që asnjë deputet nuk ka të drejtë, në ditët tona më të mira, në shekullin e shqiptarëve, në vitin e shqiptarëve, të bëjë të tilla marrëzira. Kështu që kërkoj që kjo të parashkruhet.

Në një moment të caktuar do të flas edhe për diçka që nuk ka lidhje me procedurën, sepse nuk mundet që këtu në parlamentin tonë një grup i caktuar deputetësh, të majtë dhe të djathtë, të veprojnë sikur nuk janë deputetë shqiptarë, por deputetë të vendeve fqinje, që marrin urdhra nga jashtë.

Pra, kërkoj vetëm parashkrimin e këtij paragrafi të shkurtër në faqen nr. 3, paragrafi i parafundit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Nuk ka.

Miratohet.

Njoftime

Këshilli i Ministrave ka depozituar tri projektligje. Një grup prej 28 deputetësh ka depozituar kandidaturën e zonjës Pranvera Strakosha për Komisionere për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Listën e njoftimeve e keni përpara, kurse materialet, si gjithnjë, do t’i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Vazhdojmë me interpelancën urgjente, të kërkuar nga deputetët Andi Përmeti, Alban Zeneli, Arben Elezi, Arlind Çaçani, Korab Lita, Koçi Tahiri, Halil Jakimi dhe Kostaq Papa, me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme me objekt “Dhënien e shpjegimeve për rastin e djalit 11-vjeçar, që ndodhet në kampet e Sirisë”.

Në mbështetje të nenit 96 të Rregullores, nga deputetët kërkues është konfirmuar zoti Andi Përmeti, i cili do të parashtojë interpelancën për jo më shumë se shtatë minuta.

Fjala është për ju, zoti Përmeti.

Andi Përmeti - Zoti Kryetar, kjo që do të them tani nuk ka të bëjë me interpelancën, sepse atë do ta filloj pak më pas, por është një kërkesë ndaj jush.

Me sa kuptoj unë dhe nga çfarë më njoftuan shërbimet e Kuvendit, ministri për Europën dhe Punët e Jashtme nuk ka ardhur, kurse ministri përgjegjës, që do të përgjigjet për interpelancën, është zonja Spiropali.

Zoti Kryetar, mua më vjen keq që ju e shkelni kaq hapur Rregulloren, sepse unë jam njoftuar sot në mëngjes për këtë ndryshim.

Për të gjithë ata që na dëgjojnë, por edhe për mediet në radhë të parë, sipas nenit 96 të Rregullores së Kuvendit, të cilën mund ta gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, interpelanca është kërkesa me shkrim drejtuar Kryeministrit, zëvendëskryeministrit ose çdo anëtar tjetër të Këshillit të Ministrave për të marrë shpjegime për motivet, synimet dhe qëndrimin e Këshillit të Ministrave ose lidhur me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tyre. Interpelanca i paraqitet Kryetarit të Kuvendit, i cili vë në dijeni menjëherë anëtarin e Këshillit të Ministrave, të cilit i drejtohet kërkesa për interpelancë.

E njëjta gjë, zoti Kryetar i Kuvendit, është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit për të gjitha mediet dhe publikun.

“Rendi i ditës, e hënë, datë 04.11. 2019.

Bazuar në urdhrin nr. 34, datë 28. 10. 2019, të Kryetarit të Kuvendit, zotit Gramoz Ruçi...”. Një ndër pikat e rendit të ditës është “Interpelancë urgjente me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme”.

Pra, zoti Ruçi, në shkelje të Rregullores, ju keni thirrur një ministër tjetër, që mbase nuk di të përgjigjet dhe mbase nuk ka faj për këtë gjë.

Mua më vjen keq për këtë gjë, sepse përgjatë 6 muajve që unë jam pjesë e parlamentit, por edhe jashtë, përshtypja ime është për një njeri që të paktën në profesionin e tij, pavarësisht politikës, është shumë korrekt. Ju nuk jeni nga ata këtu që Rama i tërheq për hundësh. Të paktën këtë profil keni krijuar ndër vite. Kështu që do të ishte në nderin tuaj që,

sipas Rregullores, sot të kishit detyruar ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, atë që është kërkuar, të vinte këtu dhe të jepte përgjigje, por për këtë gjë unë nuk kam çfarë të bëj. Kjo ngelet në nderin dhe përgjegjësinë tuaj.

Kështu që, unë po vazhdoj me interpelancën.

Të nderuar kolegë,

Para dy javëve emisioni italian “*Le Iene*” transmetoi rastin e trishtë të Alvin Berishës.

Alvini, sot një djalë 11 vjeç, në moshën 6 - vjeçare u rrëmbye nga e ëma, një grua e radikalizuar, e cila nëpërmjet aeroportit të Bergamos, në dhjetor të vitit 2014, në mos gaboj, u largua në drejtim të Sirisë ku iu bashkua luftëtarëve të ISIS-it.

I ati, Afrimi, nuk reshti një minutë së kërkuari të birin. Pas vitesh të tëra lufte për ta gjetur ku ishte dhe për ta sjellë në shtëpi, djali, siç u informuam nga emisioni italian “*Le Iene*”, është gjetur dhe ndodhet i plagosur rëndë në këmbë nga një bombë që ka shpërthyer në Siri, bombë e cila i ka marrë jetën së ëmës, njerikut të tij, që ishte një luftëtar i ISIS-it dhe dy fëmijëve të njerikut. Sot Alvini është lokalizuar dhe ndodhet i vetëm në kampin “Al-Hol”, kamp që shërben për të burgosurit në Sirinë e Veriut, që sot është Kurdistan i sirian.

Në atë kamp sot jetojnë në kushte mizerabël rreth 75 mijë gra dhe fëmijë. Alvini atje është i vetëm. Nga përplasjet e dhunshme që ndodhin midis grave në atë kamp, sepse, në fund të fundit, të gjitha janë ish-luftëtare të ISIS-it ose gra të luftëtarëve të ISIS-it, çdo ditë në atë kamp vriten një deri në dy persona.

Me ndihmën e emisionit italian “*Le Iene*” dhe jo të shtetit shqiptar, që nuk ka bërë asgjë për këtë çështje, Afrimi e gjeti të birin. Fati i madh i bashkoi ata të dy pas 5 vjet kërkimesh, por çdo e mirë e madhe që vjen në këtë botë e ka një kleçkë, edhe në këtë rast kishte një kleçkë të madhe, sa e thjeshtë në dukje, aq e pamundur në realizim. Afrimi nuk e merrte dot të birin nga kampi. Për këtë gjë duhej një diplomat i shtetit shqiptar. Ata që po na dëgjojnë dhe që kanë parë videon do të thonë se është e thjeshtë. Kështu menduan edhe gazetarët e “*Le Iene*”. Telefonuan ambasadorin më të afërt me pjesën e Kurdistanit të Sirisë, që ishte ambasadori shqiptar në Turqi, i cili, sigurisht, i mallëngjyer si çdo prind dhe mbase edhe ju këtu, u përgjigj që jo vetëm do ta

merrte djalin prej atje dhe do ta bashkonte me familjen, por do ta bënte këtë gjë personalisht sa më shpejt të ishte e mundur. Afrimi u mallëngjye, por harroi që drejtuesit e shtetit shqiptar nga ajo që thonë me atë që bëjnë kanë në mes një oqean të tërë, i cili, praktikisht, përherë është i pamundur të kalohet. Ambasadori i nderuar shqiptar në Turqi jo vetëm që nuk erdhi për disa ditë ta merrte Alvinin, por nuk u hapi më telefonin gazetarëve të “Le Iene”. Edhe një herë të vetme që iu përgjigj, u kërkoi të mos e shqetësonin më.

Sot Alvini është i vetëm në atë kamp. 15 ditë pasi është gjetur nga i ati, jo nga shteti shqiptar, është i plagosur rëndë (të gjithë i kemi parë pamjet), është i vetëm në një kamp ku çdo ditë vriten njerëz dhe jeton në kushte mizerabël. Shteti shqiptar nuk ka bërë asgjë.

Sot unë po i drejtoj ministres së punëve të jashtme të përkohshme, ditore, Elisa Spiropali, pyetjet e mëposhtme:

A ka shteti shqiptar një databazë të personave shqiptarë të larguar drejt ISIS-it? Në qoftë se ka, a ka informacione ku ndodhen këta persona?

A ka një shpjegim shteti shqiptar se pse Alvinin nuk e gjetën dot institucionet shqiptare, të cilave Afrim Berisha u është drejtuar pa reshtur, por e gjeti një medie italiane?

A ka dijeni shteti shqiptar për rreth 50 fëmijë shqiptarë në kampin “Al -Hol” dhe në se ka, çfarë masash janë marrë për t’i tërhequr këta fëmijë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Shameti, mbase nuk jam kaq interesant, por ju lutem flisni me zë pak më të ulët.

Faleminderit!

Pse ambasadori shqiptar në Turqi, i cili varet direkt nga shteti shqiptar, premtoi tërheqjen e Alvinit pa asnjë problem dhe më pas u tërhoq jo vetëm nga marrja e Alvinit, por, sipas mediave, u tërhoq edhe nga pozicioni i tij, por që ju nuk po e lejoni të largohet?

A iu bë presion nga instanca më të larta për të mos e tërhequr fëmijën, duke e detyruar të japë dorëheqjen, ambasadorit shqiptar në Turqi? Në qoftë se jo, pse shteti shqiptar nuk mori vetë masa ndaj ambasadorit, që publikisht premtoi tërheqjen e fëmijës dhe më pas u tërhoq nga premtimi?

A është momentalisht qeveria shqiptare në bisedime me qeverinë e Rojavës në Kurdistanin Sirian për të tërhequr Alvinin dhe fëmijët e tjerë shqiptarë që ndodhen në atë kamp?

A ka kryer ndonjë veprim shteti shqiptar për të siguruar jetën e këtyre fëmijëve, para se të shpërthente skandali mediatik, që na turpëroi në të gjithë Europën?

A ka komplekse Kryeministri, ministri i Jashtëm, jo ju zonja Spiropali, për të shpëtuar jetën e Alvinit dhe fëmijëve shqiptarë nga marrëdhënia inferiore që ka me palën turke dhe që sot po e bombardon atë kamp?

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Përmeti!

Dua të bëj dy sqarime.

Së pari, administrata e Kuvendit dhe unë si Kryetar kemi zbatuar në mënyrë të përpiktë Rregulloren e Kuvendit. Pra, nuk është bërë asnjë shkelje. Shkelje do të kishte nëse nuk do të ishte bërë njoftimi, si dhe nëse interpelanca urgjente nuk do të bëhej, sipas agjendës, në seancën më të parë.

Mandej, Kryeministri, që është njëherësh edhe ministër i Jashtëm, ka të drejtë ekskluzive kushtetuese dhe ligjore ta delegojë te një nga anëtarët e kabinetit nëse ai e ka të pamundur ardhjen në parlament. Në rastin konkret e ka deleguar te ministrja që mbulon marrëdhëniet me parlamentin, zonja Spiropali, e cila, sipas Rregullores, është e lutur të marrë fjalën deri në 20 minuta.

Elisa Spiropali – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Kur Presidenti Obama në vitin 2015 shpалosi në Shtëpinë e Bardhë platformën e tij kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, jehona në opinionin publik shqiptar vinte e largët. Ky fenomen dukej ende i huaj për vendin tonë, ndonëse, fatkeqësisht, ishim prekur jo pak prej tij.

Që në fillim të konfliktit në Siri nisi rekrutimi i personave, të cilët, nën një premtim të rremë, ideologji të rënë apo financim të errët, u nisën verbërisht të luftojnë për atë që më pas u konfiguroi si ISIS.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor u adaptuan politika të forta dhe dënime për rekrutimin dhe pjesëmarrjen e luftëtarëve të huaj në luftëra që nuk u përkisnin.

Fatkeqësisht edhe nga Shqipëria pati qytetarë, të cilët iu bashkuan kësaj thirrjeje që në fillimet e veta, ndonëse qeveria shqiptare ndërmori hapa të menjëhershëm për të adresuar këtë murtajë botërore.

Në perspektivën strategjike, Shqipëria ka zhvilluar një kuadër të mirë për t'u përballur me fenomenin e terrorizmit, në fakt që prej vitit 2001, dhe për herë të parë terrorizmi u etiketua si një kërcënim për sigurinë kombëtare në strategjinë kombëtare të vitit 2004.

Kjo strategji u rishikua në mënyrë thelbësore në vitin 2014, duke e kontekstualizuar terrorizmin edhe si kërcënim të brendshëm dhe jo ekskluzivisht si ndërkombëtar. Në vitin 2014 u integrua për herë të parë në këtë dokument strategjik fenomeni i ekstremizmit ideologjik, fetar dhe nacionalist.

Në këtë kontekst, Shqipëria është përpjekur, në hapësirën që i takon dhe me mjetet që zotëron, të luajë një rol domethënës në përballimin e terrorizmit dhe pasojave shoqëruese që e ndjekin. E kemi bërë përmes strukturave të NATO-s, por kemi qenë aktivë në këtë drejtim para se të ishim anëtarë me të drejta të plota të Aleancës Atlantike.

Vijueshmëria në detyrimet tona ndaj partnerëve dhe aleatëve tanë euroatlantikë ka qenë e përhershme dhe e pakursyer, duke nisur nga misionet tona ushtarake dhe paqeruajtëse në disa zona të nxehta të globit. Gjithashtu, strukturat tona të brendshme kanë vijuar impenjimin e tyre maksimal që nga ashpërsimi i ligjeve deri në krijimin e Drejtorisë së Posaçme të Antiterrorit në Policinë e Shtetit. Po ashtu, për të miradministruar përgjigjen shtetërore ndaj ekstremizmit të dhunshëm është krijuar Zyra e Koordinatorit Kombëtar kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, i cili punon me të gjithë faktorët ndërkombëtarë dhe institucionet publike, në mënyrë që të garantohet një bashkëpunim ndërinstitutional për parandalimin, për menaxhimin dhe për monitorimin e rasteve me rrezikshmëri për ekstremizëm të dhunshëm, duke ndërvepruar, gjithashtu, me komunitetet fetare dhe aktorët e ndryshëm socialë dhe komunitarë në zona specifike.

Nërkohë që beteja me ISIS-in, po fitohet, për ta vendosur këtë në kontekst, duke parashikuar një shpërndarje të re të luftëtarëve dhe duke pasur parasysh edhe informacionet në

vijim për familjarët e tyre dhe përfshirjen e tyre në zonën e konfliktit, muaj më parë, në fillim të vitit, është ngritur një grup ndërinstitutional pune me urdhër sekret të Kryeministrit për të përgatitur planveprimin e integruar për reagim ndaj personave me ekspozim ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe shtetit islamik në zonat e konfliktit, si dhe për të përcaktuar strukturat, metodologjinë dhe trajtimin nga institucionet shtetërore dhe, pa dyshim, evidentimin e shtetasve shqiptarë në këto zona konflikti.

Gjatë gjithë kësaj periudhe ka pasur një shkëmbim të vazhdueshëm informacioni ndërmjet strukturave shtetërore shqiptare dhe partnerëve të ndryshëm si për të ndjekur zhvillimet në zonën e konfliktit, ashtu edhe për të përditësuar informacionin për shtetasit shqiptarë që gjendeshin në atë zonë. Por të gjithë jemi plotësisht të vetëdijshëm se përballja me këtë fenomen është, në radhë të parë, një përpjekje e madhe kulturore dhe kërkon, para së gjithash, ndërgjegjësim social dhe përfshirje të të gjithë operatorëve, përveç komunikimit dhe ndërveprimit me partnerët tanë.

E bëra gjithë këtë përmbledhje për të gjithë ata në këtë sallë apo jashtë saj, që gabimisht ose qëllimisht mendojnë se filluam të kujdesemi për këtë problem pas mediatizimit të fenomenit kohët e fundit. Shqipëria i ka kushtuar gjithnjë vëmendje të veçantë këtij fenomeni, pra luftës kundër ISIS-it, terrorizmit dhe luftëtarëve shqiptarë që kanë marrë pjesë në këtë konflikt, duke filluar që në vitin 2014, kur ishim vendi i parë që ashpërsuam dënimet e Kodit Penal për të gjithë ata që luftonin për ISIS-in, çka dha rezultat pozitiv duke zëruar numrin e personave që udhëtonin nga Shqipëria drejt zonave të konfliktit pas vitit 2014. Më pas ishim vendi i parë në rajon që me mbështetjen e fortë të partnerëve tanë përgatiti strategjinë kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe hapi qendrën e parë rajonale për këtë funksion.

Pavarësisht nga fakti se javët e fundit u transmetua rasti fatkeq dhe tmerrësisht i trishtë i Alvinut, strukturat shtetërore shqiptare janë vënë në lëvizje qysh në fillim të këtij problemi, me qëllim kthimin sa më parë të të gjitha grave dhe fëmijëve që qëndrojnë në kampet e ISIS-it.

Situata në Siri është tejet e komplikuar jo vetëm pasi vazhdon të mbetet një zonë konflikti, duke i komplikuar edhe urat tona të

komunikimit, por sepse identifikimi i shtetasve shqiptarë ka qenë një proces i vështirë si pasojë e informacionit të kufizuar nga zonat e konfliktit dhe nga fakti që shumë prej tyre kanë udhëtuar pa përdorur dokumente identifikimi të lëshuara nga Republika e Shqipërisë; kanë ndryshuar identitetin e tyre, duke marrë emra arabë dhe dokumente të tjera, ose kanë kaluar kufijtë në mënyrë të paligjshme dhe pa u identifikuar. Për pasojë, konsolidimi i informacionit dhe identifikimi final është një operacion i vështirë, sidomos për shkak të mosekzistencës së institucioneve homologe në terren në zonën e konfliktit, gjë që vështirëson konfirmimin dhe raportimin për çdo rast, pasi i kanë zhdukur dokumentet shqiptare dhe janë pajisur me dokumente të Kalifatit, të cilat në shumë raste janë grisur tashmë për të mos u identifikuar në ISIS.

Duhet pasur parasysh se këto kampe menaxhohen nga struktura paramilitare, joshetërore dhe nuk u binden rregullave apo ligjeve ndërkombëtare për shkëmbimin e robërve e të tjera. Kjo nuk na pengon të eksplorojmë çdo mundësi politike, humanitare dhe operacionale për të gjetur zgjidhje. Shteti shqiptar është duke bërë gjithçka është e mundur për të kthyer fillimisht gratë dhe fëmijët që gjenden në ato kampe.

Në situatën e rindezur në terren hapat e ndërmarrë nuk mund të bëhen kurrsesi publikë, flas për hapat operacionalë, pasi kjo do të ishte tërësisht e papërgjegjshme nga ana jonë dhe do të vinte në rrezik vetë operacionin dhe jetën e grave dhe të fëmijëve që gjenden në ato kampe. Duke zbuluar identitetin e këtyre personave, ne i ekspozojmë ata para një rreziku vdekjeprurës, duke shtuar risqet me të cilat këta fëmijë dhe gra përballen çdo ditë. Sigurisht, organizatat që i menaxhojnë këto kampe nuk duan që personat të largohen dhe, kur rrjedh informacion për identitetet nga dëshira e individëve të caktuar për t'u larguar, operacioni komplikohet dhe jeta e këtyre personave vihet në rrezik; këtë e themi me përgjegjësi të plotë. Për pasojë, do t'ju lutesha që, për përfitim politik ose vëmendje mediatike, të mos përpiqemi ta kompromentojmë situatën e operacioneve në terren apo edhe jetën e personave që po përpiqemi të shpëtojmë, që në masën më të madhe janë viktimat të pafajshme, fëmijë. Fatkeqësisht, disa nga këto fakte janë

shfaqur tashmë nëpër mediet shqiptare, ndoshta nga dashamirësia për të ndihmuar në këtë proces, duke shtuar rrezikun dhe mundësinë për t'i zbuluar plotësisht identitetet e këtyre grave dhe fëmijëve shqiptarë para personave që janë ende terroristë dhe eksponentë të shtetit islamik dhe, paçka se mbahen në këto kampe, përbëjnë rrezikshmëri për banorët e tjerë të atyre kampeve.

Nuk ka nevojë të përsëriten këtu sërish emrat, faktet dhe detajet nga operacionet, të cilat janë të mbledhura dhe të identifikuar prej kohësh nga strukturat shtetërore dhe janë pjesë e përpjekjes sonë të shpëtimit.

Ju garantojmë ju, personalisht, si grupi i deputetëve që keni kërkuar interpelancën, të gjithë deputetët e këtij Kuvendi dhe nëpërmjet jush opinionin publik se institucionet e përfshira po bëjnë detyrën me profesionalizëm dhe ndjeshmëri maksimale, natyrisht pa asnjë zhurmë e bujë, për ta zgjidhur këtë problem. Kemi qenë në vazhdimësi në monitorim të situatës dhe vazhdojmë të jemi po aq të fokusuar në të gjitha elementet e çështjeve komplekse të këtij operacioni. Duhet të theksojmë këtu se nuk ka pasur asnjë precedent të përfshirjes së ndonjë shteti në riatdhesimin e shtetasve të tyre nga zonat e konfliktit deri më 18 prill të vitit 2019, pra është fenomen shumë *recent*.

Kur ka ndodhur riatdhesimi i parë në masë, 110 shtetas kosovarë, mes tyre 4 luftëtarë dhe pjesa tjetër gra dhe fëmijë të transportuar nga strukturat e partnerëve tanë për në aeroportin Erbili në Irak, organet shtetërore kosovare janë njoftuar prej tyre dhe i kanë zhvilluar procedurat e identifikimit nga Erbil, pra në aeroport, ku disa persona janë kthyer pas në kamp, ndërsa të tjerët, sigurisht, janë transportuar nëpërmjet transportit ajror të kryer nga forcat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në pamundësi të veprimit në zonën e konfliktit.

Në kuadër të këtij informacioni të marrë nga shërbimet, si dhe nga familjarët e viktimave të mitur, Shqipëria ka nisur menjëherë punën pranë partnerëve për identifikimin e personave me shtetësi shqiptare në zonat e konfliktit për periudhën prill-maj të vitit 2019. Pra, për të sqaruar situatën në kampet ku mbaheshin këta shtetas, në këtë proces janë përfshirë të gjitha institucionet përgjegjëse, duke përfshirë ambasadat tona në ato vende, duke përfshirë

edhe prezencën në terren, si dhe organizatat humanitare që operojnë në atë zonë. Janë organizuar disa takime nga një grup pune me përfaqësues nga institucionet publike të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në identifikimin dhe në riatdhesimin sipas modelit të Kosovës, si dhe në fazat e tjera të trajtimit të tyre pas mbërritjes në Shqipëri, pasi një numër prej tyre mund të përbëjnë rrezik të mundshëm. Në vijim janë identifikuar një numër shtetasish shqiptarë dhe të mitur nga informacionet e agjencive të inteligjencës, duke përfshirë fëmijë të lindur në zonën e konfliktit nga prindër shqiptarë.

Duke pasur parasysh mungesën e strukturave shtetërore në zonën e konfliktit, kontaktet janë vendosur nëpërmjet partnerëve gjatë muajve qershor dhe korrik. Në fund të muajit gusht është diskutuar një operacion i mundshëm riatdhesimi, si dhe janë përcaktuar hapat specifikë që duheshin marrë nga institucionet shqiptare në terren nga identifikimi, shoqërimi, pritja dhe trajtimi pas mbërritjes.

Pas propozimit të planit për transferimin nga kampet në struktura të specializuara për të bërë më pas transportin drejt Shqipërisë, situata në zonën e konfliktit ka ndryshuar si pasojë e zhvillimeve të fundit që kanë sjellë rindezjen e konfliktit, çka ka sjellë, në fakt, ngrirjen e operacionit.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës u tërhoqën dhe pati një sërë luftimesh ndërmjet forcave të armatosura turke dhe njërive të ndryshme në atë zonë. Pas armëpushimit ka një situatë të re gjeopolitike në terren, gjë që paraqet sfida të reja për operacionin e riatdhesimit të shtetasve shqiptarë. Aktualisht, një grup operacional po rivendos kontaktet në terren dhe po peshon të gjitha mundësitë për të siguruar riatdhesimin e shtetasve shqiptarë, duke pasur parasysh situatën aktuale dhe rolet e ndryshuara të aktorëve në terren.

Në këtë situatë të re konflikti të rindezur, dua të theksoj edhe një herë rëndësinë e madhe që merr mospublikimi i të dhënave dhe i identitetit të këtyre shtetasve që mund të jenë objekt sulmi nga të gjitha palët. Pra, situatat aty janë të përmbysura dhe është e rëndësishme që ne të jemi seriozë në deklaratat që bëjmë dhe emisionet televizive që transmetohen shpesh edhe me fytyra, duke treguar edhe pajisje elektronike që njerëzit brenda këtyre kampeve

kanë, gjë që mund t'i kthejë ata në viktimë të mundshme.

Për sa i përket rastit të djalit që ju përmendët, Alvin Berisha, unë nuk dua të hyj në të gjitha detajet, por mund t'ju them se prezenca e tij në kamp është njoftuar për herë të parë nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar pranë ambasadës sonë në Kajro në fillim të muajit shtator. Megjithatë, siç është bërë publike edhe nga emisioni që ju përmendët, babai i djalit, Afrim Berisha, ka marrë një letër nga djali më 27 qershor. Ambasada jonë në Romë është kontaktuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Italisë në datën 20 shtator, ndërkohë po më 20 shtator pranë konsullatës në Milano ka ardhur një telefonatë dhe komunikim zyrtar (letër) nga producentët e emisionit, ku njoftohej se në datën 22 shtator do të udhëtohej drejt Erbil, në Irak, për të marrë fëmijët nga kampi. Në vijim është vepruar me të gjitha mundësitë, në zbatim të ligjeve shqiptare, për të ndihmuar familjen Berisha dhe ka një komunikim në vazhdim me ta edhe sot, por kjo nuk ka qenë e mundur brenda premisave të atij emisioni, të cilat ne nuk mund t'i shtjellojmë këtu.

Takimi në kampin e “Al-Hol”-it ka ndodhur më 25 shtator. Përpyekjet tona për t'i riatdhesuar të gjitha gratë dhe të miturit shqiptarë vazhdojnë edhe sot. Kontaktet me Alvinin dhe me të tjerët janë mbajtur nëpërmjet organizatave humanitare dhe deri tani kampi “Al-Hol” është i sigurt, përkundër asaj që deklarohet nëpër medie nga të gjitha informacionet e inteligjencës, por edhe nga kontaktet me organizatat humanitare që ne kemi në kampin “Al-Hol” për ta vënë këtë në kontekst, janë rreth 70 mijë gra dhe fëmijë, nga të cilët 10 mijë joshirane. Pra, janë shtetas të huaj, përfshirë vendet europiane si: nga Franca, nga Italia e me radhë. Kujtojmë se Franca ka rreth 700 shtetas në atë kamp dhe të tjerë. Pra, nuk mungon vullneti i këtyre vendeve për t'i kthyer, por është konteksti i posaçëm në të cilin ata shtetas ndodhen. Për ta kuptuar edhe më qartë situatën duhet të shqyrtohet në këtë kontekst. OKB-ja dhe Lidhja Arabe vlerësojnë rreth 400 mijë persona të vrarë në atë konflikt në Siri, 6,6 milionë njerëz të shpërngulur, 5,6 të emigruar, duke e konsideruar si konfliktin e dytë më të madh në shekullin XXI. Përveç të gjitha fakteve të mëparshme, më 9 tetor 2019 forcat turke kalojnë në ofensivë në verilindje të Sirisë. Janë

rreth 1 mijë individë nga Ballkani Perëndimor të evidentuar, duke përfshirë këtu gra dhe fëmijë në Siri dhe në Irak, rreth 500 prej tyre ndodhen ende në atë zonë infernale. Nga informacionet paraprake vlerësohet se në këta 500 persona nga rajoni i Ballkanit, 150 janë shqiptarë nga të gjitha trevat dhe rreth 72 nga Shqipëria, ku përfshihen edhe 11-13 burra të klasifikuar terroristë në burgjet e kontrolluara nga forcat kurde. 28 fëmijë janë evidentuar me të gjitha gjeneralitetet pas një pune intensive në bashkëpunim me partnerët. Për t'iu përgjigjur pyetjes suaj: a ka evidenca shteti shqiptar? Sigurisht, sepse puna, siç ju thashë, nuk ka nisur tani që dalin nëpër medie, por ka nisur shumë kohë më parë, që në përfundimin e konfliktit. Ka edhe fëmijë të lindur në zonën e luftimit, por numrin e tyre nuk mund ta konfirmojë asnjë institucion, sepse nuk janë regjistruar me gjeneralitete në shtetin shqiptar.

Rreth 460 janë kthyer në vendet e tyre në rajonin e Ballkanit, duke e bërë këtë rajon me përqendrimin më të lartë të luftëtarëve të huaj në Europë.

Unë dua të rendis edhe një sërë masash që janë marrë nga qeveria shqiptare për një plan që përfshin jo vetëm kthimin e tyre përmes operacioneve, por riatdhesisin dhe integrimin e tyre në vend. Nxjerja jashtë zonës së rrezikut të fëmijëve dhe grave që pas procesit të hetimit rezultojnë pa lidhje me organizatën ISIS...

Gramoz Ruçi - Zonja Spiropali faleminderit! Ju mbaroi koha.

Ftoj zotin Përmeti të shprehet lidhur me përgjigjet e ministres deri në 15 minuta.

Andi Përmeti – Po e filloj me zotin Ruçi. Për të qenë korrektë me njëri-tjetrin, zoti Ruçi, dhe në radhë të parë me publikun, Kryeministri ka të drejtë t'ia delegojë interpelancën kujtdo nga kabineti i ministrave, kur kërkohet interpelancë me Kryeministrin. Unë nuk kam kërkuar interpelancë me Kryeministrin, por me ministrin e Jashtëm dhe asnjë ministër nuk ka të drejtë t'ia delegojë interpelancën një pjesëtari tjetër të kabinetit.

Tani do të vazhdoj me përgjigjet. Kur mora vesh sot se interpelancën do ta kisha me zonjën Spiropali dhe jo me ministrin e Jashtëm apo me zëvendësministrin, që është i deleguar, mendova se do të jenë të përhershme sloganet që

zakonisht i përdorin zonja Spiropali dhe zoti Rama.

U surprizova se kishit disa slogane të reja. Për të qenë i sinqertë, zonja Spiropali, mendova se si argument në fillim do të thoshit (besoj se krahu këtej dhe krahu andej i mbajnë mend të gjithë): “Delta force”. A e mbani mend atë filmin e vjetër, atë të parin me *Chuck Norris* dhe *Lee Marvin* kur me një automatik të vetëm *Chuck Norris* i vriste të gjithë të këqijtë dhe shpëtonte amerikanët e rrëmbyer, sepse në fund të ditës, zonja Spiropali histori si të Alvinut bëhen edhe filma në Europë. Por ne nuk jemi këtu për këtë histori. Ne jemi për t'i dhënë zgjidhje një historie, së cilës deri më sot nuk i është dhënë zgjidhje. Ju përmendët shumë statistika. Unë ju falënderoj për to! Disa mund të jenë edhe të vërteta. Unë nuk jam profesionist i fushës së këtyre statistikave, por ju përdorët shumë slogane dhe nuk dhatë asnjë zgjidhje. Ju përdorët identikisht të njëjtat slogane që publikisht ka përdorur zoti Rama. Ai “Skënderi” juaj politik që “bej” nuk u bë kurrë. Ju përdorët slogane dhe populli shqiptar është mësuar me këto slogane që janë tallëse për ta. Nëse populli shqiptar do t'i kishte dëgjuar vetëm sloganet tuaja për ta, sot në politikë kriminelin do të ishte politikani i së ardhmes, përdhunuesi do të ishte kryetar bashkie dhe vrasësi do të ishte bamirësi më i madh. Po t'i kishin dëgjuar sloganet tuaja, sot në Shqipëri nuk do të kishte largime masive, por po vijmë të huajt për të jetuar në një shtet ku reformat tuaja po ndrijnë. Po t'i dëgjonin sloganet tuaja shqiptarët, këtu në Shqipëri nuk ka as vrasje, as drogë as krim. Këto vrasje që njerëzit dëgjojnë përditë janë lojëra “*counter strike*” që bëjnë populli dhe fëmijët me njëri-tjetrin. Po t'i dëgjonte populli sloganet tuaja, sot është fajtor BE-ja që nuk na ka pranuar brenda me rregullat, me reformat, me përmirësimin që kemi bërë. Në fund të ditës humbasin ata dhe jo ne, apo jo, zonja Spiropali?!

Këtu ne nuk jemi për slogane, jemi për një fakt konkret. Ju thatë, pasi i mbajta shënim disa nga detajet kur dhatë në përgjigjet, “Është vështirë t'i gjejmë, sepse nuk kanë dokumente”. Dakord, kjo qëndron, por më e vështirë qenka për ju t'i gjeni sesa për “*Le Iene*”? Më vështirë qenka për ju, sesa për Kryqin e Kuq? Lidhuni me Kryqin e Kuq, gjejini ju mënyrat! Nuk jua gjej dot unë mënyrat. Unë nuk thashë se ju nuk keni

filluar punën. Ju u mburrët shumë për fillimin e punëve, siç mburreni për çdo fillim pune fasade që bëni ndër vite, por që nuk arrini kurrë rezultat. Unë ju pyeta për rezultatet. Jeta e atij djali varet nga ju. Nëse atij djali i ndodh gjë, puna juaj nuk ka asnjë vlerë. Ka vlerë vetëm rezultati. Kaq më të aftë janë kosovarët sesa ne?! E cituat ju, por do ta citoj edhe unë. Zonja Spiropali, kosovarët kanë tërhequr 110 veta. Unë e kuptoj se për politikë janë më të aftë, këtë e treguan zgjedhjet. Ata hapur preferuan demokracinë direkte, ku populli voton qytetarët dhe përfaqësuesit e tij. Ju jeni gati të vriteni me njëri – tjetrin; kush të jetë më servili i Ramës për të zënë një vend në listë. Por kjo gjë nuk ka të bëjë me këtë diskutim. Kosovarët i tërhoqën 110 veta. Nuk është e vërtetë që shtetet e tjera nuk kanë tërhequr, kanë tërhequr Anglia, Suedia dhe Danimarka në numra të vegjël, një deri në katër veta, por i kanë tërhequr. Pse vetëm ne nuk po i tërheqim dot?

Unë nuk kërkoja emrat zonja Spiropali. Për asnjë moment të vetëm nuk ju thashë më thoni një emër! Për asnjë moment të vetëm nuk ju thashë më thoni një gjeneralitet. Për asnjë moment të vetëm nuk ju thashë më thoni se si do të veproni ushtarakisht apo diplomatikisht për t'i tërhequr këta fëmijë. Unë ju thashë: ku jeni me rezultatet? Cili është afati se kur do të tërhiqen këta persona? Është e vërtetë, se atje ka probleme, por nuk është e vërtetë se nuk ka drejtues. Atje është një qeveri me qendër në Paris, që drejton sot, por, edhe në mos qoftë ashtu, dhe të ketë vetëm një drejtim paramilitar, ai ushtari me automatik në dorë, që qëndron atje, ka një gjeneral mbi kokë. Shkoni atje dhe me rregullat paramilitare shpëtojeni djalin, sepse është një qytetar shqiptar 11 vjeç.

Zonja Spiropali, kjo është kërkesa ime dhe unë këtë ju kërkoja. Kur do të shpëtojë ai dhe fëmijët e tjerë? Nuk ju kërkoja as emra, as marrëdhënie ushtarake dhe as sesi do të veproni ju.

Një nga pyetjet që ju bëra ishte: a keni ndonjë informacion pse ambasadori shqiptar në Turqi tha: “Po, do ta tërheq unë”? Përse ata, që qëndrojnë atje brenda kampit, thanë: “Mjafton që të vijë një diplomat shqiptar”? Sigurisht, për ata brenda kampit ju nuk keni përgjigje, dhe me të drejtë, por të paktën të keni një përgjigje për ambasadorin shqiptar.

Së fundi, një përgjigje që ju takon është për afatet: kur mund të përfundojnë këto punë? Sepse sot kampi mund të jetë i sigurt, unë nuk kam informacion për këtë dhe po e marr të mirëqenë këtë që thatë, por ajo është një zonë lufte dhe mund të mos jetë nesër e sigurt, mund të mos jetë pas 3 orësh, ose tani që jemi duke folur. Ju nuk e komandoni dot luftën botërore. Ju mund ta dini se sot është i sigurt. Kur do të tërhiqet djali?

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Faleminderit, zoti Përmeti!

Përsëri insistoj në atë fjalën e rëndë “gënjen”. T’i thuash Kryetarit të parlamentit gënjen për Rregulloren, është fjalë shumë e rëndë, prandaj tërhiqe mbrapsht.

Duhet të dish se, nëse do të ishte Edi Rama edhe ministër i Jashtëm, pra jo Kryeministër dhe ministër i Jashtëm, ke të drejtë ti, që një ministër nuk mund ta delegojë interpelancën, por, kur Edi Rama është Kryeministër dhe ministër i Jashtëm, ka të drejtë ta delegojë, qartë? Prandaj le ta quajmë se e ke nga padija.

Zonja Spiropali, fjala është për ju.

Elisa Spiropali - Në fakt, kur përgatita relacionin për sa i përket kësaj interpelance, sigurisht, për shkak të ndjeshmërisë së lartë të qytetarëve shqiptarë, mbledha të gjithë informacionin e mundshëm, por edhe në respekt tuajin, duke menduar se ju hallin, shqetësimin dhe brengën e kishit për Alvin Berishën, Afrim Berishën të atin e tij, për familjarët, fëmijët dhe gratë e tjera në kamp, por ju çështjen e paskeni pasur te sloganet, te BE-ja, te lufta mes maxhorancës dhe opozitës jashtëparlamentare dhe te çështje të tjera, që nuk kanë asnjë lidhje me këtë interpelancë. Pra, ju bëtë një imitim shumë të shëmtuar të atyre që tani janë në rrugë, por më parë ishin në këtë parlament. Të themi të drejtën, midis kopjes dhe origjinalit zgjedhim origjinalin. Ishte më mirë Flamur Noka dhe Ed Paloka në këtë përballje, sesa ju, zoti Përmeti. Ju bëni punën për të cilën keni dalë. Këtu kërkuat një interpelancë. Ne jemi përballur edhe me ta, me Berishën, me Bashën, me Palokën e të tjerë dhe nuk na tremb përballja me slogane me ju, por unë mendova se duhej seriozitet në këtë interpelancë, prandaj u përgjigja me shifra, me fakte, me operacione, duke iu përgjigjur edhe pyetjeve tuaja. Konkretisht, ju thatë disa të pavërteta, por besoj se mediet mund t’i rendisin.

Unë nuk ju thashë se po punojmë për evidentimin, po ju thashë se janë evidentuar të gjithë fëmijët me gjeneralitete, janë rreth 28 në atë kamp. Po bëhet vlerësimi i përpjekjes për nxjerrjen e tyre në komunikim të vazhdueshëm me partnerët. Ky është një operacion, është luftë. Nuk varet jeta e këtyre njerëzve nga ne, por nga ata terroristët që janë në kamp, nga lufta, nga marrëdhëniet mes tyre, si dhe nga situata e përmbysur tani.

Po ju them se në programin operacional janë të përfshira institucione, si: Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Drejtoria Antiterror, SHISH-i, prokuroria, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, sepse plani nuk përfshin vetëm nxjerrjen e fëmijëve jashtë zonës së rrezikut, por edhe grave që pas procesit të hetimit rezultojnë të palidhura me veprimtarinë e ISIS-it, por integrimin e tyre në komunitet, krijimin e narrativës fituese komunitare, riintegrimin e plotë të këtyre njerëzve në jetën normale, sepse imagjinoni që kanë qenë në një vend ku ka luftë, trauma e me radhë dhe mund të kenë pasur edhe veprimtari brenda atyre zonave. Ngritja e grupit të punës në institucionet e mësipërme është bërë me koordinatorët dhe partnerët rajonalë në Kosovë, Maqedoni, Bosnje-Hercegovinë, Mal të Zi, si edhe me partnerët tanë strategjikë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe...

(Bie gongu.)

Gramoz Ruçi - Faleminderit, zonja Spiropali!

Fjalën e ka zoti Përmeti, 3 minuta.

Andi Përmeti – Zoti Ruçi, pyesni cilindo jurist të parlamentit tuaj të krahut të majtë nëse unë e kam gabim.

Ju kërkoi ndjesë për fjalën “gënjeshtar” publikisht. Nëse ju e keni gabim interpretimin, më kërkoni ndjesë publikisht për fjalën “i paditur”.

Zonja Spiropali, nuk e dija që u mërzitët kaq shumë nga krahasimi me Ramën, sa më krahasuat me Flamur Nokën dhe Edi Palokën. Ju kërkoi ndjesë! Kujtoja se ju pëlqente ky lloj krahasimi.

Unë ju kërkova zgjidhjen dhe nuk bëra politikë. Ju thashë se ju thatë slogane dhe nuk dhatë zgjidhje, afat për atë djalë. T’ju bëj një

pyetje të singertë: a e keni parë videon, zonja Spiropali? Nuk e di nëse e keni parë apo jo. Po ta shikoni atë video, ju jeni nënë në pritje, nuk e them për keq këtë, sepse edhe unë jam baba në pritje, ajo video ishte emocionuese. Po të mos bëje politikë, i shkoje dhe i zije derën atij që nuk di shqip në Ministrinë e Jashtme dhe vije bashkë me të, derisa ai ta tërhiqte atë fëmijë kudo dhe sido të ishte e mundur. Kjo është mosbërja politikë. Sillnit fëmijën dhe nuk bënit politikë.

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Përmeti!

Këtu mbyllet interpelanca e kërkuar

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk keni më të drejtë.

Vazhdojmë me aktin normativ nr. 2, datë 02.10.2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019””. Ka pyetje?

Urdhëroni, për procedurë!

Korab Lita - I nderuar zoti Kryetar,

Është hera e dytë që dal për procedurë në lidhje me përbërjen e Grupit Parlamentar Demokrat. Para disa ditësh ju kam sjellë një vendim të shumicës së grupit, të cilët kanë vendosur të mos pranojnë anëtarë të rinj në këtë grup. Sot keni edhe një kërkesë tjetër të firmosur nga shumica e anëtarëve të grupit.

Shoh se në listën e diskutimeve, meqenëse ju nuk e bëtë prezente, është edhe një deputete, e cila nuk është pjesëtare e grupit. Grupi ka vendosur të ketë vetëm 9 anëtarë, prandaj, ju lutem, të keni reagimin e nevojshëm dhe në kontigjentin e diskutantëve të grupit të jenë vetëm anëtarët e grupit!

Po ashtu, ju kërkoi të reagoni ndaj shkresës që ju kam dërguar sot për ta mbyllur një herë e mirë këtë situatë që është krijuar, e cila, realisht, po na e pengon punën në grupin parlamentar.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Ju lutem shumë, edhe një herë në lidhje me këtë çështje, ju kam sqaruar në seancën e kaluar dhe ju kam thënë se nuk është kompetencë as e Kryetarit të Kuvendit, as e seancës plenare të merret me lëvizjet e deputetëve, me zgjedhjen e kryesisë së grupeve parlamentare e të tjera. Këto janë çështje që duhet t’i zgjidhni ju brenda, kolegë të dashur. Mos e implikoni as drejtuesin e seancës, as Kryetarin e parlamentit, as seancën plenare në këto çështje. Në qoftë se është një emër i renditur te lista juaj, është e drejtë ekskluzive e çdo deputeti të kërkohet fjalën. Deputeti ka të drejtë të

shprehet se në cilin grup dëshiron të bëjë pjesë, kurse grupet kanë të drejtë të pranojnë apo të përkasojnë. Këto janë punët tuaja, s'janë as të miat, as të seancës.

Urdhëroni, zonja Ministre e Financave, mund ta merrni fjalën në lidhje me aktin normativ nr. 2 "Për disa ndryshime në ligjin "Për buxhetin e vitit 2019".

Anila Denaj – I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Prezantimin e sotëm të aktit normativ nr. 2 "Për disa ndryshime në ligjin për buxhetin e vitit 2019", më lejoni ta filloj me një përmbledhje të shkurtër të zhvillimeve makroekonomike gjatë këtij viti, si dhe me perspektivën në vijim.

Pavarësisht një ngadalësimi të rritjes ekonomike në gjysmën e parë të vitit për shkak të disa faktorëve të luhatshëm dhe të përkohshëm, sektorët kryesorë të ekonomisë vazhdojnë të përmirësohen. Konkretisht, sektorët që kanë shënuar rritje të qenësishme pozitive në tremujorin e dytë të këtij viti, me kontribut më të lartë pozitiv, janë:

Industria nxjerrëse, ajo përpunuese (përveç energjisë eklektike), me 15,6% rritje.

Industria e prodhimit të veshjeve dhe këpucëve me 4,4% rritje, ajo e produkteve të drurit dhe letres me 15,6 % rritje.

Rritje të qenësishme, që varion nga 4,8 në 13,9%, pati në pjesën më të madhe të sektorit të shërbimeve, që nga akomodimi dhe shërbimi ushqimor, transporti, komunikacioni, aktivitetet financiare dhe atë të pasurive të paluajtshme.

Performancë të ulët kanë shënuar sektori i energjisë elektrike dhe ai i argëtimit dhe çlodhjes, ku bëjnë pjesë lojërat e fatit, të dyja me një efekt minus 1,6 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë.

Ky ritëm më i ulët i rritjes ekonomike se ai i parashikuar për këtë vit ka rritur edhe përgjegjshmërinë për të parë ritmin e rritjes së këtij viti, duke e korrigjuar atë në 3,4% në përfundim të këtij viti. Sigurisht, kjo do të sjellë një efekt negativ edhe në nivelin e të ardhurave ndaj parashikimit.

Në aspektin e kërkesës agregate, rritja në gjysmën e parë të vitit 2019, është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, specifikisht nga konsumi, si edhe nga eksportet neto të shërbimeve, të cilat reflektojnë një performancë

mjaft të mirë të turizmit edhe gjatë këtij tremujori.

Treguesit kryesorë të ekonomisë gjatë tremujorit të dytë dëshmojnë bazat e forta në:

Vijueshmërinë e performancës pozitive në tregun e punës me një ulje të mëtejshme të shkallës së papunësisë nën nivelin prej 12%, niveli më i ulët i regjistruar gjatë dy dekadave e fundit. Punësimi u rrit me 3,3%, e ushqyer kjo kryesisht nga rritja e shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës.

Stabilitetin financiar dhe përshpejtimin e kreditimit të ekonomisë. Qëndrueshmëria e sektorit financiar, në terma të kapitalizimit, likuiditetit dhe përfitueshmërisë, vazhdon të mbetet e përmirësuar. Kreditë me probleme (NPL) kanë vijuar të ulen, tashmë deri në nivelin rreth 11%, nga 24% që u akumuluan rreth dy vjet më parë. Gjithashtu, kreditimi i sektorit privat të ekonomisë ka njohur tashmë për tre tremujorë rresht të këtij viti një zgjerim të qenësishëm, duke regjistruar një rritje mbi 7% kundrejt një viti më parë, e cila i atribuohet si kredisë drejt bizneseve, ashtu edhe asaj drejt konsumatorëve.

Qëndrueshmërinë e financave publike dhe vijimin e konsolidimit fiskal. Konsolidimi fiskal ka dhënë efektet e tij edhe për vitin 2019, ku pritshmëria e deficitit buxhetor mbetet nën 2%, nga 5% të PBB-së në vitin 2013. Në vitet e fundit borxhi publik neto është reduktuar nga niveli më i lartë prej 71,9% të PBB-së regjistruar në vitin 2015 në rreth 64% i pritshëm për vitin 2019.

Gjithashtu, edhe rritja e madhe prej 10% e Investimeve të Huaja Direkte në tremujorin e parë dhe me pothuajse 20% në tremujorin e dytë, të shpërndara në disa sektorë të ekonomisë, mbulojnë efektet e përfundimit të fazës së ndërtimit të investimeve madhore.

Disa nga rezultatet paraprake fiskale deri në shtator 2019 tregojnë se realizimi i përgjithshëm i buxhetit mbetet plotësisht në përputhje me objektivat dhe parametrat kryesorë fiskalë.

Të ardhurat totale të mbledhura për 9-mujorin e vitit 2019 u realizuan në masën 301,3 miliardë lekë ose 3,7% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u realizuan në vlerën 120,8 miliardë lekë ose 2,5% më shumë se 9-mujori i vitit 2018,

Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u realizuan në vlerën 180,5 miliardë lekë ose 4,6% më shumë se 9-mujori i vitit 2018.

Rimbursimi i TVSH-së është rritur me 40%, krahasuar me vitin 2018, ose +4,2 miliardë lekë.

Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për kontributet u realizuan në masën 70 miliardë lekë, 8% ose 3,8 miliardë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2018.

Në 9 muaj të vitit 2019 shpenzimet korrente rezultuan në rreth 304,3 miliardë lekë, 71% e planit vjetor me një rritje prej rreth 8,1% kundrejt 2018;

- shpenzimet kapitale rezultuan në një realizim në masën 41,4 miliardë lekë ose 47% e planit vjetor;

- shpenzimet kapitale me financim të brendshëm kanë një realizim relativisht të kënaqshëm prej rreth 53% të planit vjetor, apo me një rritje prej rreth 8,9% krahasuar me 2018.

Deficiti i përgjithshëm për nëntë muajt e parë të vitit 2019 rezultoi në nivelin 2,3 miliardë lekë. Për tre muajt e mbetur të vitit, sipas trendit të zakonshëm të financave tona publike, pritet që shpenzimet në përgjithësi dhe ato kapitale në veçanti të kenë një përshpejtim të ekzekutimit të tyre, sidomos në nëntor dhe dhjetor.

Për t'u rikthyer në diskutimin e aktit normativ nr. 2, dëshiroj të theksoj arsyet kryesore të nevojës së këtij akti, që janë:

- garantimi i financimit të fondit rezervë të buxhetit të shtetit, në vijim të situatës emergjente të krijuar pas tërmetit të datës 21.09.2019;

- kompensimi i disa zërave të shpenzimeve buxhetore të prekura në 2019 për efekt të financimit të Paktit për Universitetin;

- reflektimi i ecures optmale të të ardhurave vendore, gjatë gjysmës së parë të vitit 2019;

- rritja e eficiencës së përdorimit të burimeve publike për rialokime drejt projekteve të investimeve me progres të mirë deri tani.

Disa ndër synimet kryesore të këtij akti normativ janë:

1. Ruajtja e nivelit të planifikuar në buxhetin e vitit 2019 të parametrave kryesorë makroekonomikë të theksuar më sipër.

2. Sistemime dhe/ose rialokime të tjera pa kosto shtesë efektive mes zërave të shpenzimeve buxhetore, por të cilat ndikojnë ndjeshëm në rritjen e performancës së pritshme të realizimit të treguesve në fund të vitit 2019.

Së pari, ato sigurojnë financimin për disa zëra sensitivë të shpenzimeve korrente, si fondi rezervë, skema e fermerëve, skema e PAK-së, arsimit i lartë, rendi, mbrojtja etj., dhe konkretisht disa prej tyre janë:

Ministria e Brendshme: 450 milionë lekë për orët jashtë orarit për efektivet e Policisë së Shtetit dhe për orë pune shtesë për Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë/kursantet;

Ministria e Mbrojtjes: 120 milionë lekë për mirëmbajtjen e sistemeve të IT-së;

Ministria e Shëndetësisë: 300 milionë lekë për Skemën e Personave me Aftësi të Kufizuar;

Ministria e Arsimit: 300 milionë lekë për arsimin bazë;

Ministria e Bujqësisë: 200 milionë lekë për skemën e fermerëve për kompensimin e çmimit të qumështit.

Së dyti, rrisin performancën e shpenzimeve kapitale, përmes alokimit të burimeve dhe rialokimit të fondeve drejt projekteve të investimeve publike, të cilat rezultojnë me progres të mirë, me qëllim arritjen e nivelit të programuar të tyre për vitin 2019. Konkretisht, ky akt normativ garanton specifikisht, ndër të tjera, sa vijon:

Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë: 1 miliard lekë financim i huaj për të mundësuar avancimin e punimeve në bapjasin e Fierit dhe përfundimin e një krah të rrugës dhe 370 milionë lekë për shpronësimet në objektet e Autoritetit Rrugor Shqiptar;

Fondi Shqiptari i Zhvillimit: 800 milionë lekë për avancimin e projekteve kryesore;

Ministria e Kulturës: 200 milionë lekë për shtimin e ritmit të punimeve për rikonstrukcionin dhe pajisjet e godinës së Teatrit Kombëtar;

Ministria e Bujqësisë: 200 milionë lekë për vazhdimin e financimit të projekteve me fokus mbrojtjen e argjinaturave lumore dhe sistemin e kanaleve ujitëse;

Ministria e Financave: 125 milionë lekë për blerjen e pajisjeve për "Polin e Drejtësisë";

Ministria e Shëndetësisë: 90 milionë lekë, "Rikonstrukcioni i godinës së maternitetit të vjetër";

Bashkia Tiranë: 1 miliard lekë për avancimin e punimeve për projektin e “Bulevardit verior dhe rehabilitimit të lumit të Tiranës”.

Së treti, reflektimi i rritjes së tavanit të shpenzimeve për njësitë vendore.

Përmes këtij akti normativ në nivel vendor është siguruar një rritje e të ardhurave nga taksat lokale me rreth 3 miliardë lekë. Rritja në të ardhurat vendore është realizuar me argumentimin, si më poshtë:

- për 6-mujorin e parë të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore janë realizuar në masën 60,9% të planit vjetor ose 22% më shumë se plani paraardhës;

- njësitë e vetëqeverisjes vendore në 6-mujorin e dytë të vitit 2019 pritet të tejkalojnë planin e parashikuar të të ardhurave të veta vendore, si pasojë e rritjes së eficiencës së mbledhjes së të ardhurave;

- trendi rritës i të ardhurave vendore konstatohet edhe në realizimin 9- mujor, ku të ardhurat vendore, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, janë në rritje.

Gjithashtu, rritja e të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore do të reflektohet në rritjen e shpenzimeve me rreth 4 miliardë lekë, në akomodimin e nevojave të reja të funksionimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë (vetingut), si nga pikëpamja e shpenzimeve, ashtu edhe e numrit të punonjësve.

Ky akt normativ alokoi burimet e nevojshme shtesë, njerëzore dhe financiare, për disa institucione të reja të vetingut, konkretisht:

Për SPAK-un/Byronë e Hetimit, kemi akomoduar organikën e re prej 100 punonjësish shtesë, me një buxhet total prej 66 milionë lekësh, për periudhën tetor-dhjetor 2019.

Për Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë kemi akomoduar organikën e re prej 40 punonjësish, me një buxhet prej 10 milionë lekësh, për periudhën tetor-dhjetor 2019.

Nërkohë, që në retrospektivë për të gjithë 9 mujorin e parë të vitit 2019, financimi i pagave të reja të magjistratëve për institucionet e sistemit të drejtësisë (veting) është realizuar në zbatim të nenit 13 të ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, në zërin “Fondi rezervë për sistemin e drejtësisë”. Ky fond i planifikuar në masën 1,35 miliardë lekë, deri në datën 31

tetor 2019 është përdorur në masën 1,2 miliardë lekë ose në rreth 89,1% të tij.

Prokurorisë së Përgjithshme i është dhënë buxhet shtesë 600 milionë lekë, për shpenzime personeli.

Këshillit të Lartë Gjyqësor i është dhënë buxhet shtesë 400 milionë lekë për shpenzime personeli.

Këshillit të Lartë të Prokurorisë i akordohen 65 punonjës shtesë dhe një buxhet prej 88 milionë lekësh shpenzime korrente dhe 20 milionë lekë investime.

Këshillit të Lartë Gjyqësor i akordohen 54 punonjës shtesë dhe një buxhet prej 62 milionë lekësh shpenzime korrente dhe 20 milionë lekë investime.

Gjykatës së Lartë i akordohet shtesë buxheti në masën 13,2 milionë lekë për shpenzime korrente.

Bazuar në sa më sipër, në rëndësinë për ecurinë e financave publike, për funksionimin e strukturave të lidhura me Reformën në Drejtësi dhe në bindjen se ndryshimet e propozuara ruajnë treguesit kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë, si dhe sjellin përmirësim të të gjitha projekteve deri në fund të vitit, ju ftoj të votoni këtë akt normativ.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Lista e diskutantëve për këtë akt është si më poshtë:

Olta Xhaçka, Ogerta Manastirliu, Etilda Gjonaj, Taulant Balla, Ervin Bushati, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj, Xhevit Bushaj, Senida Mesi, Ilir Beqaj, Antoneta Dhima, Myslim Murrizi, Halit Valteri, Edlira Hyseni, Kostaq Papa dhe Zef Shtjefni.

Urdhëroni, zoti Murrizi!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Kam parë sa munda aktin normativ të qeverisë “Për ndryshimin e buxhetit faktik të vitit 2019” dëgjova edhe ministren e Financave.

Pjesa e parë m’u duk si paradë suksesi për ngritjen e punësimeve, pagave, mirëqenies, uljen e papunësisë dhe uljen e borxhit publik. Në fakt, një raport i sotëm i FMN-së deklaroi të kundërtën. Thotë se borxhi publik është pothuajse i njëjtë me shifrat që Kontrolli i Lartë i

Shtetit ka raportuar në materialin e tij, sepse shkon 69,9 % e jo 67,1 %. Pra, është rreth 2,9 % më i lartë nga sa është deklaruar prej qeverisë. Me 69,9 %, pra rreth 70 % e prodhimit të brendshëm bruto, i bie që shqiptarët të kenë sot rreth 10 miliardë euro borxh, ose nga 3 mijë e ca euro për frymë.

Gjithsesi, pashë me vëmendje lëvizjet e brendshme të parave publike, nga ai që është miratuar fundvitin e kaluar në këtë Kuvend, pra në buxhetin e vitit 2019, lëvizje që sot qeveria i mendon të rëndësishme për zhvillimin e objekteve të ndryshme, për kompensimet, për Ministrinë e Bujqësisë, për riparime, pra për përfundimin e projekteve që janë gjykuar si më të rëndësishme nga politikëbërja e kësaj qeverie.

Ajo që vë re, është se nuk na thuhet prej nga hiqen, konkretisht. Pra, kujt i ishin planifikuar rreth 25-26 milionë euro, që do t'i jepnin sipas buxhetit të miratuar në fund të vitit 2018 për vitin 2019. Nga lëvizin këto para, që ishin planifikuar për X ministri, ndërsa sot shpërndahen sipas renditjes që na lexoi ministria e Financave, me vlerat përkatëse. Një zë, që është rreth 15,6 milionë euro, pra afro 2 miliardë lekë të reja, thuhet që kanë qenë rritje pagash. Se për cilat paga bëhet fjalë të jenë planifikuar për t'u ngritur në këtë buxhet, e që sot zerohen, kjo nuk thuhet. Pra, se cilës kategori të administratës publike e shtetërore qe planifikuar se do t'i ngriheshin pagat. Në këtë rialokim fondesh zerohet kjo ngritje, 16 milionë euro i hiqen tabelës së pagave.

Thuhet që Ministria e Bujqësisë i rrit me 1,5 milionë euro shpenzimet, rreth 200 milionë lekë të reja për mbështetjen e skemës së fermerëve në lidhje me kompensimin e qumështit. A ka ndonjë llogari konkrete se sa i takon për çdo fermer, sa është prodhimi i qumështit, sa familje fermerësh përfitojnë konkretisht, nëse kjo do të bëhet e mundur të shpërndahet deri në fund të këtij viti, sa u takon atyre 100 lekëve që do t'i kompensojnë për çdo litër qumështi, për të cilat u fol para disa kohësh në këtë sallë, kur fermerët myzeqarë protestuan dhe derdhën qumështin rrugës? A e zgjidhin këto 1,5 milionë euro në total, kompensimin e të gjithë prodhuesve të qumështit? Na thoni se sa fermerë përfitojnë nga këto 1,5 milionë euro, se kaq është e gjithë shtesa, që ju i çoni Ministrisë së bujqësisë. 1,5 milionë euro të tjera, Ministria e

Bujqësisë do t'i ketë për projektet e mbrojtjes së argjinaturave të lumenjve. Fjalë shumë të përgjithshme. Cilët lumenj? Sa kilometra argjinaturë? Sa ndikon kjo në lidhje me ato përmbytjet e famshme që kemi parë gjatë viteve të fundit, nën të gjitha qeveritë? Çfarë është planifikuar konkretisht? Çfarë argjinaturash do të bëhen me këto 1,5 milionë euro, dhe sa arrijnë këto argjinatura t'i ndalojnë përmbytjet, që kanë filluar qysh sot, që është dita e parë e shiut dhe ujërat kanë vërshuar nëpër rrugë.

7,5 milionë euro do t'i shkojnë Ministrisë së Integritimit, për të financuar projektet që janë me investim të huaj, e këtu bëhet fjalë për bajpasin e Fierit. A mbaron ky bajpas me 7,5 milionë euro, pra ai që është: nga Mulliri i Artë deri në Levan? Do të zgjidhet përfundimisht, a bëhet i kalueshëm e me katër korsi, apo do të ngelet prapë për buxhetin e vitit 2020?

Ajo që shohim në tabelat e paraqitura, kur është miratuar buxheti i vitit 2019, në krahasim me të gjitha të ardhurat që realizon ky vend, rreth 4 miliardë euro, është që Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, këto dy sektorë me të cilët duam të avancojmë dhe të mbajmë në këmbë ekonominë e këtij vendi, sepse sektori i vetëm prodhues është bujqësia, ndërsa sektori me të cilin mburremi se do të ecim përpara, është turizmi, kanë: 2,99 % të të ardhurave totale të buxhetit të shtetit Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit 0,78 %, Ministria e Kulturës 0,77 %. Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka 4,96 %. Edhe te ky rialokim që bëni ju sot, prapë pjesa e luanit i shkon Fondit, rreth 6,5 milionë euro, ndërsa 125 milionë e 243 mijë euro janë planifikuar në fillim.

A mund të na jepni një shifër apo ndonjë detaj konkret? Çfarë bën ky Fond? Cilat janë objektet që tenderohen nga ky Fond, dhe përse ky Fond, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka buxhet më të madh se tri ministri të marra së bashku? E keni fuqizuar me buxhet më shumë se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Ministria e Kulturës. Pra, tri ministri së bashku nuk kanë buxhet sa ç'ka Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Gjithashtu, doja t'u bëja me dije edhe atyre që kanë durim të na ndjekin, se Kontrolli i Lartë i Shtetit i paska dërguar një shkresë në datën 10 shtator të këtij viti Kryeministrit Edi Rama,

zëvendëskryeministrit, zotit Braçe, ministres, zonjës Balluku, si dhe Kryetarit të Kuvendit, zotit Ruçi, në të cilën thuhet: “PPP-të Balldren-Milot dhe PPP-ja Orikum-Dukat janë të fryra tej mase qysh në projekt”.

Nuk e di pse kjo letër është mbajtur si konfidenciale, kur ka qenë publike, dhe pse nuk është bërë me dije edhe pjesa e opozitës, tre grupet parlamentare që janë këtu? Pse është mbajtur si nën sirtar? Më 10 shtator ka ardhur kjo letër, më 12 shtator kemi kaluar në këtë sallë, ju, sepse ne e kemi votuar kundër, dy PPP-të. Kontrolli i Lartë i Shtetit shprehet me plot rezerva në drejtim të të dyja projekteve, si tej mase të fryrë dhe me ngritje artificiale të kostos së punimeve, si në rastin e Balldren-Milotit, si Orikum-Dukatin.

Shkresat që vijnë në adresë të zyrtarëve të shtetit, unë nuk besoj se janë shkresa që u vijnë në postën private të familjeve apo në numrin postar që kanë në shtëpi. Këto shkresa duhej të ishin shpërndarë për të gjithë deputetët.

Uroj dhe shpresoj që ndryshimet e paraqitura për t’u miratuar, me aktin normativ të qeverisë, të ndikojnë sadopak në arnimet e mundshme të atyre përllogaritjeve që nuk janë bërë siç duhet në fillim, kur është menduar buxheti i vitit 2019.

Shoh se rreth 7,5 milionë euro i shkojnë Bashkisë së Tiranës, për punimet e bulevardit verior dhe rehabilitimin e lumit të Lanës. Nuk e di cili është bulevardi verior dhe sa herë do të mirëmbahet, riparohet e rregullohet ky lumi i Lanës. Për cilën gjatësi bëhet fjalë? Janë ura dërrase, është zgjatim i atij që është?

Ministritë së Shëndetësisë i keni dhënë rreth 900 milionë lekë për rikonstruksionin e godinës së maternitetit të vjetër. Po ashtu, fondi i Teatrit të Operas dhe Baletit, dhe bëhet fjalë për Pallatin e Kulturës, besoj, jo për këtë teatrin, që ditën kërkon ta prishni ju, ndërsa natën ruhet nga të tjerët, është 1, 5 milionë euro.

Inshallah, të gjitha këto, rreth 26 milionë euro, të cilat hiqen në mënyrë të fshehtë, por nuk na thuhet saktësisht se nga hiqen, që synohet të shkojnë për të përmirësuar atë që ju keni planifikuar me rezerva në fillim, nuk do të vidhet gjysma e tyre, por do të shkojnë atje për ku i keni nisur.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Murrizi!

Fjala për Ogerta Manastirliun. Të përgatitet Edlira Hyseni.

Ogerta Manastirliu – I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot jemi duke diskutuar për aktin normativ, rishikimin e buxhetit faktik të vitit 2019, i cili në fakt është një buxhet që për dy sektorë, të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, realizon apo konsolidon programet tashmë të nisura, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, për të rritur aksesin në shërbimet shëndetësore e sociale, që këto shërbime të jenë sa më të shpejta në kohë, por dhe me cilësi për qytetarët.

Ky është një akt normativ, i cili për të dy sektorët, të shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale, parashikon një rritje me 300 milionë lekë në sektorin e mbrojtjes sociale, për të mbuluar dhe financuar skemën e aftësisë së kufizuar si një ndër skemat që po reformohet dhe po transformohet në kuadër të reformës për modernizimin e asistencës sociale, e cila tashmë ka nisur dhe do të mbështesë më shumë persona në nevojë, por sigurisht edhe do të orientojë financimin e qëndrueshëm të kësaj skeme drejt atyre që kanë më shumë nevojë.

Buxheti për vitin 2019 është buxheti i qytetarëve, pasi 450 mijë qytetarë janë përfutues të drejtpërdrejtë nga programi ynë i rehabilitimit të 300 qendrave shëndetësore, që tashmë kemi nisur. Tetëdhjetë prej tyre kanë përfunduar, ndërsa 100 qendra shëndetësore dhe ambulanca janë në proces rindërtimi, për të ofruar më shumë shërbime të kujdesit parësor.

Buxheti i vitit 2019 është buxheti i qytetarëve, pasi 411 mijë qytetarë e kanë realizuar falas kontrollin mjekësor bazë të përvitshëm në të gjithë sistemin e kujdesit parësor, duke shënuar kështu rritjen më të madhe të numrit të qytetarëve, të cilët kanë përfutur nga ky program falas, me 29 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018.

Ky është buxheti i qytetarëve, ky është buxheti i fëmijëve, pasi nëpërmjet politikës së re të bonusit të bebeve, kemi mundur që, deri në dhjetëmujorin e parë të këtij viti, më shumë se 18 milionë euro të shkojnë në xhepat e familjeve, si dhe të mbështeten më shumë se 26 mijë fëmijë të lindur këtë vit, nëpërmjet bonusit të bebes, nga

400 dollarë deri në 1200 dollarë për fëmijët e porsalindur.

Ky është buxheti i qytetarëve, sepse sot kemi mundësi të trajtojmë sëmundshmërinë më shumë se pesë vjet më parë, të risim buxhetin për sëmundjet tumorale me pesë herë. Sot dedikohen nga buxheti i shtetit 24 milionë dollarë, për mbulimin më të mirë me barna dhe me materiale mjekësore. Mbulohen më mirë me terapitë e mjekimit, edhe me terapitë e targetuara, sa u përket sëmundjeve tumorale, siç janë kanceri i gjirit limfomat malinje, në lidhje me të cilat kemi siguruar që nëpërmjet kontratave të posaçme, në listën e rimbursimit të barnave të kemi mbulesë universale dhe me terapi të targetuara. Këto janë terapi të shtrenjta, por tashmë janë të mbuluara për të gjitha ato grupe pacientësh që vuajnë nga këto sëmundje.

Ky është buxheti i qytetarëve, sepse më shumë se 47 mijë qytetarë kanë kryer ndërhyrje operatore nëpërmjet një procesi tashmë të garantuar, atij të instrumenteve dhe sterilizimit, i cili ofrohet në të gjitha spitalet rajonale e bashkiake. Këtu dua të ndalem, për të kthyer edhe disa përgjigje, që besoj se janë të nevojshme, në kuadër të këtij programi, i cili ka ndryshuar rrënjësisht e në mënyrë esenciale ofrimin e shërbimeve kirurgjikale në të gjithë vendin. 47 mijë pacientë kanë kryer ndërhyrje kirurgjikale me standarde të larta, me siguri të lartë. 7,3 % më shumë ndërhyrje kirurgjikale të kompleksitetit të lartë, se një vit më parë. 12 % ndërhyrje kirurgjikale të kompleksitetit të mesëm më shumë se një vit më parë.

Pikërisht nëpërmjet riorganizimit shumë më të mirë, shumë më eficient, si dhe optimizimit të këtij shërbimi, kemi realizuar që, ndërhyrjet e kompleksitetit të lehtë, po ashtu edhe mjekimet e plagëve, të kryhen nëpërmjet disa seteve, të cilët konsiderohen si sete të sterilizimit me avull, dhe ato të kompleksitetit të ulët, të cilët janë 50 % më shumë se një vit më parë.

Sigurisht, këtu ka një vlerë shumë të madhe optimizimi e racionalizimi që ne po bëjmë nëpërmjet strukturës që kemi ngritur për administrimin e koncesioneve. Pikërisht për këtë dua të siguroj qytetarët që çdo qindarkë e shpenzuar për këtë shërbim esencialisht është përkthyer në performancë për mjekët dhe garanci për shëndetin e pacientëve. Asnjë ankesë nuk ka

sot nga qytetarët për vonesë në shërbimin e kirurgjisë.

Atyre që flasin, kush nga padijenja dhe kush nga ligësia, iu them se ky koncesion nuk është koncesioni i veglave të kirurgjisë, por është një koncesion që ka lidhje me shërbimin e sterilizimit të instrumenteve kirurgjikale. Më shumë se 9 centrale sterilizimi janë investuar në spitalet rajonale të vendit, më shumë se 90 mijë sete instrumentesh kirurgjikale të reja përdorin sot mjekët tanë kirurgë. Sigurisht nuk është vetëm instrumenti i ri ai që është thelbi i këtij partneriteti, por është i gjithë procesi i shërbimit të sterilizimit duke filluar nga pastrimi i instrumenteve, procesi i evadimit të mbetjeve të sallës deri te sterilizimi i sallave të operacionit. I gjithë ky shërbim sot ofrohet me cilësinë më të lartë sipas standardeve bashkëkohore. E them këtë, sepse dua që të siguroj qytetarët që asnjë vonesë nuk ka për të pasur për ta për ndërhyrjet operatore, qoftë kur janë urgjente, që nuk ka asnjë diskutim se do të kryhen në kohë dhe sipas nevojës, por edhe për ndërhyrjet e planifikuara, të cilat janë duke u realizuar sipas të gjitha procedurave në të gjitha spitalet e vendit.

Gjithashtu, më lejoni të them që ky buxhet do të vijojë të mbështesë të gjitha investimet që ne kemi ndërmarrë në të gjitha spitalet e vendit, kryesisht me fokus mbështetjen në spitalet e Kukësit dhe të Lezhës për ndërtimin e maternitetit të Beratit, i cili ka filluar dhe, gjithashtu, për përfundimin e një sërë projektsh të rëndësishme, siç janë investimet për pediatriinë e Durrësit dhe në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, e cila tashmë është një kantier ndërtimi, ku, në fakt, ndërtimi i kirurgjisë ka përfunduar dhe shumë shpejt fillon funksionimi, por është hapur kantieri i pediatriisë, që do të përfundojë në vitin 2021, i cili do të sigurojë për pacientët e vegjël, por edhe për ekipin mjekësor në QSUT një shërbim cilësor.

Sigurisht, kemi shumë për të bërë sa i përket mbulimit me shërbime, aksesit në shërbime, si edhe uljes së shpenzimeve nga xhepi, por rruga e nisur drejt transformimit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale nuk do të ndalet për të optimizuar të gjitha burimet tona, për të siguruar që të kemi në të gjithë territorin mjekë me performancë të lartë, të mbështetur pikërisht edhe në sajë të të gjithë politikave incentive të Ministrisë së Shëndetësisë dhe

Mbrojtjes Sociale dhe, gjithashtu, për investime, të cilat do të jenë të realizuara në kohë dhe me të gjithë parametrat e përcaktuar nga shërbimet e kujdesit shëndetësor.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Edlira Hyseni. Të përgatitet zonja Etilda Gjonaj.

Edlira Hyseni – Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të kabinetit qeveritar,

Çështja që kemi për diskutim është akti normativ, i cili propozon një rishikim dhe ndryshime të buxhetit të vitit 2019, të miratuar me ligjin nr. 99 të vitit 2018.

Akti normativ informon për disa tregues financiarë të mosrealizimit ose realizimit të planit. Sipas aktit normativ, ka një rënie të të ardhurave tatimore dhe jotatimore prej 3 miliardë lekësh të rinj dhe ka një rritje të të ardhurave të buxheteve vendore 4 miliardë lekë. Kështu që një ndër çështjet kryesore që ka prekur aktin në rishikimin e buxhetit të vitit 2019 është rishpërndarja ose riorganizimi i shpenzimeve buxhetore për të pasqyruar rënien e të ardhurave tatimore në vlerën 3 miliardë lekë. Informacionet që kemi pasur kanë qenë të shumta dhe të njëkohësishme, sepse brenda këtij muaji kemi kaluar buxhetin faktik të vitit 2018, tani po rishohim buxhetin e vitit 2019, dhe pas pak do të diskutohet edhe buxheti i vitit 2021.

Lidhur me aspektet pozitive dhe informacionet e detajuara që përmban akti foli ministrja dhe jemi të mirinformuar.

Unë do të ndalem te çështjet që janë më të paqarta dhe për të cilat do të doja të kisha një informacion më shumë.

Në tabelat që shoqërojnë aktin normativ është tabela e treguesve makrofiskalë të treguesve financiarë. Pyetja e parë që më lind këtu është: Pse të gjitha ndryshimet që i janë bërë buxhetit të vitit 2019 janë dhënë, por informacionet si është ky buxhet i pasqyruar në ligjin e miratuar një vit më parë nuk na janë dhënë? Pra, kemi si kanë qenë shifrat në aktin normativ të vitit 2018, por nuk kemi shifrat e planit buxhetor të vitit 2019 të miratuar me ligjin e mëparshëm. Ne, në fakt, sot po ndryshojmë buxhetin e miratuar një vit më parë, kështu që do

të ishte me vend të kishim të dhënat se si ishte buxheti i miratuar me ligj dhe si ndryshon sot me këtë akt normativ.

Gjithashtu, kemi të dhënat e buxhetit faktik të vitit 2018, por në ato tabela mund të ishin edhe të dhënat në lidhje me buxhetin faktik të vitit 2018, i cili nuk ka qenë një realizim i plotë i planit sipas të dhënave të aktit normativ të vitit 2018.

Meqenëse jemi tek treguesit makrofiskalë, në lidhje me deficitin buxhetor më lind një pyetje, e cila po diskutohet edhe në opinionin publik, sepse kemi tri shifra të ndryshme: në aktin normativ të vitit 2018 (meqenëse atë na e keni dhënë për referencë në këtë kohë) deficitin buxhetor është 2%, në të dhënat zyrtare buxheti faktik i vitit 2018 rezulton 1,6%, në raportin e KLSH-së shkruhet se deficitin buxhetor është 2,2%. Pra, për deficitin buxhetor kemi tri vlera të ndryshme, një në planifikim, një në buxhet faktik dhe një në raportin e KLSH-së. Limiti ligjor është 2%. Deficitin buxhetor duhet të mbetet brenda 2%-shit të GDP-së. Atëherë, do të doja të dija nëse për vitin 2019 do të jemi në të njëjtat kushte, pra deficitin buxhetor do të ketë këto luhatje, kur qeveria thotë se është më pak se 2%, ndërsa KLSH-ja thotë se është më shumë se 2%? A është respektuar apo jo limiti ligjor, i cili tani në aktin normativ parashikohet të jetë 1,9%? Duket që jemi brenda limitit ligjor, por si do të jetë ai faktik dhe si do të jetë sipas KLSH-së kjo është për t'u parë më tej.

Duke parë aktin normativ të vitit 2018 dhe aktin normativ të vitit 2019, si dhe ndryshimet që keni bërë nga ligji i miratuar i buxhetit, vihen re që janë zëruar disa zëra, pra që nuk ekzistojnë më. Edhe kryetari i Komisionit të Ekonomisë, zoti Ahmetaj, që nuk është tani në sallë, ka folur shpesh për bonusin e pensionistëve, i cili ka qenë një ndër sukseset e buxhetit paraardhës dhe, në fakt, në vitin 2018 bonusi i pensionistëve ka qenë 3 miliardë lekë, por në vitin 2019 bonusi i pensionistëve është ende zero. Ka qenë zero në planin fillestar, është ende zero edhe në këtë akt normativ. Pra, pensionistët do ta marrin apo jo bonusin e tyre për këtë vit? Sipas shifrave që kemi deri sot, nuk e kanë, por shpresojmë të kemi një rialokim tjetër ose ndryshim të momentit të fundit.

Ka pasur në vitin 2018 një fond shpërblimi për familjet në nevojë, i cili ka qenë 300 milionë

lekë. Edhe ai fond shpërblimi për familjet në nevojë është bërë zero, pra pensionistët dhe familjet në nevojë që në vitin 2018 kanë pasur disa fonde, në këtë vit duket që janë pasuruar dhe e kanë më të nevojshme për t'u mbështetur, ose mbase do t'iu vijë radha pak më vonë.

Raporti i KLSH-së është një raport shumë i rëndësishëm, por neve na ka ardhur në tavolinë ditën kur ka qenë mbledhja e Komisionit të Ekonomisë. Është një raport me rreth 400 faqe dhe voluminoz, është auditimi i pasqyrave financiare i buxhetit të konsoliduar të shtetit shqiptar, i cili për rëndësinë që ka dhe punën që është bërë, duhej të shihej me kujdes, por ka qenë e pamundur, sepse ditën që diskutohej buxheti faktik i vitit 2018, po atë ditë na erdhi edhe raporti i KLSH-së. Gjithsesi, nëse do të shihnim qoftë përmbledhjen e shkurtër të opinionit të KLSH-së, të shprehur qartë që në fillim, KLSH-ja për buxhetin e vitit 2018 të vendit tonë shpreh rezerva. Unë jam audituese dhe audituesit thonë që, nëse opinionin është pa rezervë do të thotë që unë nuk ka asnjë dyshim që informacionet financiare që pasqyrohen në bilance janë të sigërtë dhe të vërteta dhe nuk ka anomali financiare. Ndërkohë, KLSH-ja thotë që buxheti i vitit 2018 ka anomali të theksuara, lidhur me zëra të rëndësishëm buxhetor, sidomos në deficitin buxhetor dhe borxhin publik për të cilin folëm më përpara. Vetë KLSH-ja ngre një sërë problematikash, të cilat unë do të doja të dija nëse qeveria i ka marrë parasysh në vitin 2019. Pra, me këto ndryshime që po bëhen, a ka përmirësuar diçka në lidhje me rekomandimet, gjetjet dhe vërejtjet që ka bërë KLSH-ja për vitin 2018?

Një nga çështjet që ngre raporti i KLSH-së është që detyrimet e prapambetura dhe stoku në rritje i TVSH-së nuk reflektohen në treguesit e konsoliduar fiskalë, treguesit e deficitit ose të borxhit publik për vitin e kaluar. Po për këtë vit çfarë ndodh? A do të pasqyrohen detyrimet e prapambetura dhe stoku i TVSH-së së parimbursuar në treguesit makrofiskalë?

Sipas KLSH-së, vitin e kaluar ka pasur shumë raste të mosraportimit të shpenzimeve për disa zëra buxhetorë, kryerjen e shpenzimeve pa u mbështetur në plane buxhetore, mospërdorimin e fondeve, dhe pse të miratuara nga Kuvendi, për njësitë e pushtetit vendor dhe mosplanifikim të shpenzimeve. Pra, KLSH-ja konstaton një sërë

shkeljesh dhe një sërë problematikash lidhur me faktin si është menaxhuar, si është kontrolluar dhe si ka funksionuar buxheti i vitit të mëparshëm. Në rishikimin që ju po i bëni buxhetit, për të cilin na informoni që keni më pak të ardhura tatimore dhe jotatimore në 3 miliardë lekë, por nuk na thoni se cilat zëra janë më pak, na thoni se ka 4 miliardë më shumë lekë nga bashkitë, por nuk na thoni ku do të shkojnë ato? Ju thoni se 4 miliardë lekë që janë arkëtuar më shumë, në fakt, bashkitë do t'i shpenzojnë, por nuk na thoni se për çfarë do të shpenzohen ato? Unë nuk kam informacion se ku do të shkojnë 4 miliardë lekë. Jemi shumë të kënaqur që paska një performancë më të mirë, por mirë është të dinim se ku do të përdoren ato 4 miliardë lekë.

Ju na keni thënë si do të pakësoni shpenzimet buxhetore për këta 3 miliardë lekë më pak të ardhura, keni thënë që do të hiqni (atë që tha kolegu paraardhës) fondin për rritjen e pagave, që në ligjin nr. 99 të vitit 2018 ka qenë i parashikuar për 2 miliardë lekë, por në këtë akt normativ bëhet zero. Pra, për të kompensuar të ardhurat më të pakta tatimore dhe jotatimore është hequr fondi për rritjen e pagave, i parashikuar 2 miliardë, por i bërë zero. Është pakësuar edhe fondi rezervë për drejtësinë, janë pakësuar transfertat qeveritare që do t'u shkojnë sigurimeve shoqërore.

Do të thosha që ka shumë informacione financiare që janë të rëndësishme, mbase bëhet e mërzitshme nga ana teknike e shifrave, por mendoj se të gjitha japin një pasqyrë të saktë të situatës ekonomike ku është vendi. Qytetarët duhet të dinë ku jemi dhe ku po shkojmë, a jemi më mirë apo ka vend për më mirë.

Unë shpresoj...

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Hyseni!

Fjalën e ka zonja Etilda Gjonaj, të përgatitet Ervin Bushati.

Etilda Gjonaj – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Pavarësisht vendimit jo pozitiv të Këshillit të Europës për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, të gjitha vendet europiane njohin rezultatet e Shqipërisë në reformat shtetformuese. Vlerësimet vijnë edhe nga ato vende europiane që janë një zë i fortë në

procesin e vendimmarrjes së çeljes së negociatave, të cilat po na ndihmojnë të ecim më tej në zbatimin e detyrave tona për t'u bërë pjesë e familjes europiane. Por puna jonë nuk ndalet, përkundrazi ajo është intensifikuar edhe më shumë me ndihmën e shteteve europiane dhe të organizmave ndërkombëtarë, që operojnë në fushën e drejtësisë për të përmbushur detyrat tona, mjaft të rëndësishme në vetë reformat e ndërmarra për forcimin e shtetit të së drejtës.

Në këtë kuadër, më lejoni të ndaj me ju një lajm pozitiv, atë të pranimit zyrtarisht në Agjencinë e Bashkimit European për Bashkëpunimin në Drejtësinë Penale, EUROJUST. Ky pranim vjen pas një pune intensive e filluar me nënshkrimin e marrëveshjes në tetor të vitit 2018, marrëveshje e ratifikuar tashmë edhe nga Kuvendi, mes Ministrisë së Drejtësisë dhe agjencisë EUROJUST. Përgjigjja pozitive është një notë vlerësuese e punës sonë përmes caktimit të shpejtë të një prokurori në zyrën e EUROJUST-it në Hagë, e cila do të rrisë më tej besimin e partnerëve tanë të vullneti i Shqipërisë për të luftuar krimin ndërkufitar.

Do të garantojmë shkëmbimin në kohë të informacionit të nevojshëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe më gjerë, si dhe me grupet e përbashkëta të hetimit me prokurorë të vendeve europiane do të bëhet më efikase lufta kundër kriminalitetit. Pa dyshim që në vitin 2020 caktimi i prokurorit të Shqipërisë në Hagë, do të gjejë edhe mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit apo edhe nga mbështetja financiare që Komisioni European ka dhënë nëpërmjet projekteve IPA.

Të nderuar deputetë,

Nëpërmjet këtij akti normativ do të na jepet mundësia për të vijuar më tej objektivat që udhëheqin punën tonë si në zbatim të reformës në drejtësi, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, rritjes të sigurisë në institucionet penitenciare, si dhe vijimin e investimeve dhe të modernizimeve të sistemeve. Me këtë akt normativ që po diskutojmë sot në total Ministrisë së Drejtësisë i janë shtuar 62 milionë e 500 mijë lekë në investime të brendshme, duke rialokuar dhe mirëmenaxhuar një pjesë të shpenzimeve koherente të pashpenzuara, kjo falë edhe mirëmenaxhimit që u është bërë fondeve. Vazhdimësia e projektit të investimit për

ndërtimin e arkivit elektronik, motorit të kërkimit të Qendrës së Botimeve Zyrtare, do të jetë pjesë e këtij akti normativ për të bërë të mundur modernizimin e sistemit dhe lehtësimin në aksesimin e akteve, si dhe informimit më të mirë të qytetarëve.

Gjithashtu, një fond i konsiderueshëm i është rialokuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për investime dhe shërbime, për pajisje të ndryshme sigurie në sistemin e burgjeve. Disa zëra financiarë që lidhen me shpenzime personeli apo zërat financiarë të kursyer nga ndjekja më e mirë e procedurave të prokurimeve publike janë pikërisht ata që i pakësohen fondit, duke u rialokuar për nevojat më imediate dhe vazhdimësinë e projekteve sipas prioriteteve të Ministrisë së Drejtësisë dhe të qeverisjes.

Për vitin 2019 buxheti i parashikuar për Ministrinë e Drejtësisë në total ka qenë i planifikuar në shumën 12 miliardë e 401 milionë lekë. Ky buxhet krahasuar me buxhetin e vitit 2018 pa diskutim ka një rritje prej 14%. Buxheti i akorduar po administrohet me kujdes dhe në interes të qytetarëve. Ministria e Drejtësisë, tashmë e shkëputur nga një periudhë e keqplanifikimit dhe keqadministrimit të parave publike, këtë e tregojnë kontrollet dhe auditet e kryera në Ministrinë e Drejtësisë, po vijon me mbështetjen që i ka dhënë buxheti i vitit 2019, por edhe ky akt normativ, duke përcaktuar dhe duke vijuar prioritetet, të cilat janë vendosur që në krye të herës së këtij mandati.

Qeveria është angazhuar publikisht për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që qytetarët shqiptarë marrin nga Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e saj të varësisë. Buxheti i vitit 2019 po bën të mundur përmbushjen e këtij angazhimi. Shërbimet më eficiente dhe më profesionale të ofruara nga organet ligjzbatuese të sistemit të drejtësisë dhe profesionet e lira nëpërmjet politikave rregulluese, kanë qenë prioritet i vitit 2019 për Ministrinë e Drejtësisë dhe qeverinë shqiptare. Nëpërmjet ngritjes së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas Ministria e Drejtësisë siguron aksesin në organet e drejtësisë për të gjithë përdoruesit e sistemit, pavarësisht mundësive financiare. Ministria e Drejtësisë në këtë projekt, për vitin 2019, alokoi 89 milionë lekë nga buxheti i shtetit.

Këtë vit pati një vëmendje më të shtuar të institucioneve shqiptare në garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Përpjekjet e institucioneve të drejtësisë u fokusuan jo vetëm në garantimin e aksesit në drejtësi të të miturit, por edhe në garantimin e të drejtave të fëmijëve të bashkërenduara me institucionet e linjës. Për këtë qëllim po zbatohet strategjia e drejtësisë për të miturit, e cila përbën dokumentin e parë të politikave të qeverisë shqiptare që përcakton shtyllat bazë të reformës së drejtësisë për të miturit, duke i dhënë kështu edhe vëmendjen që duhet.

Në këtë kuadër Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2019 angazhoi 140 milionë lekë për ngritjen e institucioneve të reja, siç është Qendra e Parandalimit të Krimit të të Miturve dhe të Rinjve, institucion ky i konceptuar si një mekanizëm varësie i Ministrisë së Drejtësisë, i cili është në fazën e hartimit të programeve parandaluese dhe do të kryejë mbikëqyrjen për një periudhë 6-mujore të të miturve pas përfundimit të dënimit.

Në sistemin penitenciar në kuadër të reformës së ndërmarrë gjatë vitit 2019 janë përmirësuar kushtet dhe trajtimi i të dënuarve. Për këtë qëllim buxheti i Ministrisë së Drejtësisë gjatë vitit 2019 parashikoi për programin e burgjeve fondin prej 5 miliardë e 853 milionë lekësh. Gjatë vitit 2019 pajisëm pas 10 vjetësh personelin policor të burgjeve me uniformë, ku janë 3559 punonjës policie. Po ashtu pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve për vitin 2019 janë rritur me 7% ose rreth 181 milionë lekë më shumë dhe kjo rritje do të vijojë edhe me miratimin e ligjit për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, si dhe ligjin për Policinë e Burgjeve, ku parashikohet një rritje me fasha për 3 vjetët e ardhshëm.

Dëshiroj t'ju theksoj se kjo është rritja e parë që u bëhet pas kaq shumë vitesh punonjësve të policisë së burgjeve. Në sajë të rritjes së kërkesave për realizimin e investimeve prej 429 milionë lekësh të akorduara për vitin 2019 për Drejtorinë e Burgjeve, është bërë i mundur përmirësimi i kushteve dhe rritja e sigurisë, e cila është kryefjala e reformës në sistemin penitenciar.

Në fushën e përmirësimit të infrastrukturës ndërtimore janë realizuar disa projekte për rikonstrukcione në IEVP të ndryshme dhe në

Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në vlerën prej 190 milionë lekësh për vitin 2019. Për sistemin penitenciar u vunë në dispozicion 95,5 milionë lekë për forcimin e sigurisë dhe ngritjen e sallës operative, e cila garanton aksesin për 24 orë në kamerat dhe skenarët e institucioneve penitenciare, duke e konsideruar kështu si projekti i “4 syve”. Kjo ndikoi dukshëm gjatë vitit 2019 në mirëmenaxhimin dhe kontrollin me efikasitet dhe në kohë reale të të gjithë sistemit penitenciar në Shqipëri.

Buxheti i vitit 2019 ka parashikuar edhe investime për blerje pajisjesh të ndryshme, për sistemin e burgjeve në funksion të përmirësimit rrënjësor të menaxhimit dhe të administrimit të sistemit penitenciar shqiptar nëpërmjet edhe krijimit të bazës së nevojshme logjistike, rritjes së rendimentit të punës apo edhe përmirësimit të vazhdueshëm të elementeve të sigurisë.

E fundit, por jo nga rëndësia, është nisma dhe angazhimi i qeverisë shqiptare dhe yni si Ministri e Drejtësisë, në luftën kundër korrupsionit. Një punë që ka filluar që prej vitit 2018 me ngritjen e Task Forcës Antikorrupsion dhe po vijohet më tej me konsolidimin e strukturës së dedikuar antikorrupsion, e cila do të koordinojë me shpejtësi dhe eficiencë çdo rast dhe çdo denoncim të ardhur nga qytetarët nga 16 agjencitë e përzgjedhura në të gjithë vendin.

Ministria e Drejtësisë po punon intensivisht në bashkëpunim edhe me shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë për të përmbushur misionin e saj si koordinatorë në luftën antikorrupsion. Pa dyshim duhet një mbështetje më e madhe buxhetore për realizimin e sistemeve të përshtatshme në luftën kundër korrupsionit, por, njëkohësisht shpreh bindjen që në vitin 2020, edhe nëpërmjet mbështetjes buxhetore, por edhe nëpërmjet mbështetjes me asistencë teknike dhe buxhetore nga Komisioni Europian, ky objektivi do të jetë më mirë i mbështetur financiarisht.

Një peshë të konsiderueshme të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë e zë edhe fondi për kompensimin e pronës, që shkon në vlerën prej 4 miliardë lekësh dhe 1 miliard lekë për kompensimin e ndërtimeve informale.

Të nderuar deputetë,

Buxheti i vitit 2019 dhe ndryshimet përmes këtij akti që prekin Ministrinë e Drejtësisë janë prova më e mirë që qeveria është e vendosur për

t'u siguruar qytetarëve një sistem drejtësie efikas dhe luftë pa kompromis ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Gjonaj!

Fjalën e ka deputeti Ervin Bushati.

Të përgatitet deputeti Kostaq Papa.

Ervin Bushati – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Parametrat makroekonomikë të ekonomisë sot në Shqipëri janë në një nivel shumë të mirë dhe është e rëndësishme, ndërkohë që ne diskutojmë për ekonominë dhe financat, të mos të biem pre e një trysnie qoftë edhe konceptuale për të mos ruajtur parametrat, ndërkohë që flitet për mosrealizim plani.

Ndërkohë, të gjithë e dimë që projektbuxheti, ndaj quhet i tillë, është një projekcion, dhe teoria e planifikimit të ekonomisë ka shkuar me sistemin e kaluar. Është shumë e rëndësishme të jemi realistë dhe të shohim çdo moment që të përmirësojmë sa më shumë klimën e ekonomisë dhe të ruajmë këto parametra, të cilët në fakt janë favorizues.

Rritja ekonomike, e cila është në parametrat 2,3- 2,4% në raport me GDP-në është një rritje e mirë, ka një rënie në krahasim me vitin e kaluar, por ndërkohë duhet të kemi parasysh që në një sinkron qoftë edhe global ekonomia ndërkombëtare ka marrë një ulje, FMN-ja dhe Banka Botërore kanë parashikuar një rënie në të gjitha ekonomitë e botës. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh ekonominë tonë në Shqipëri, si dhe sektorët, të cilët kanë vuajtur më shumë. Kemi ulje të prodhimit të energjisë elektrike, kemi ulje në të ardhurat që kemi pasur nga lojërat e fatit, por duhet të kemi parasysh që edhe klima e acaruar politike nuk na ka ndihmuar për të ruajtur parametrat makroekonomikë. Është mjaft e rëndësishme të mos biem pre e një ndikimi qoftë edhe politik dhe të fillojmë të tolerojmë në parametra, të cilët janë të mirë.

Deficiti buxhetor patjetër që duhet mbajtur nën kontroll, këtë vit është në nivelin 1,9% në raport me GDP-në, kjo bën që edhe ulja e borxhit kombëtar të shkojë drejt atij trendi që e kemi parashikuar të gjithë bashkë dhe këtë vit mund të shkojë edhe 65% në raport me GDP.

Pra, është shumë e rëndësishme, si pikë e parë, të mos biem pre e këtyre presioneve, qoftë edhe politike dhe të ruajmë parametrat makroekonomikë që janë të mirë. Duhet të kemi parasysh që sot në treg norma e interesit të parasë është shumë e ulët dhe kjo është favorizuese si për shtetin, ashtu edhe për biznesin. Në fakt, ka qenë vendimmarrja e qeverisë dhe e kësaj maxhorance që të dalim sa më shumë nga tregu i brendshëm në mënyrë që të ulen normat e interesit, pra të mos jetë efekti i shishes (*Crowding Out Effect*) ku shteti merr më shumë para nga tregu i brendshëm dhe bizneset nuk mund të marrim më kredi nëpër banka. Sot kreditimi dhe interesat nga bankat janë në pikën e tyre më të ulët, dhe kjo ka bërë që bankat të tregohen më skeptike, gjë që ka të bëjë edhe me rregullat që janë ndërruar, pasi në të gjithë botën kanë filluar rregullat e Bazelit, në mënyrën e dhënies së kredisë, që kjo ka ndikuar edhe në Shqipëri.

Ky është momenti, për të reflektuar edhe nga bizneset shqiptare, të cilat duhet të jenë më të kujdesshme në mënyrën se si i paraqesin planet e biznesit, për të përfituar nga normat e interesit.

E dyta, është mirë që reformat të vazhdojnë pikërisht në këtë moment. Siç ju thashë edhe më lart, parametrat makroekonomikë janë të mirë, por në ekonomi ka një rregull, nuk është mirë që reformat të bëhen në kohë krize, por të gjithë kujtohen në kohë krize, presioni politik është gjithmonë në kohë krize. Momenti më i përshtatshëm për ta rregulluar shtëpinë është në kohë të mirë. Pra, çatia rregullohet në kohë me diell. Ndërkohë që ne i kemi këta parametra makroekonomikë, deficitin buxhetor të ulët, borxhin kombëtar drejt uljes, rritjen ekonomike e kemi pozitive, normat e interesit janë të ulëta, kreditë me probleme janë në rënie, ky është momenti për të vazhduar me reformat.

Shpeshherë në ekonomi ndodh që gjëja më urgjente shtyn të domosdoshmen. Gjithmonë, kur jemi para diçkaje që duket si urgjente nga pikëpamja politike, vazhdojmë dhe shtyjme reformat, të cilat ndërkohë janë shumë të domosdoshme. Ato reforma që duhet të vazhdojnë tani është momenti që të ecin përpara.

Pika e tretë ka të bëjë me klimën e biznesit. Për momentin kemi një klimë favorizuese për biznesin, e cila duhet të ishte reflektuar edhe në

tregjet e brendshme financiare dhe ekonomike, ku bizneset të mund të kishin oportunitetin për të marrë më shumë kredi dhe të përfitonin nga normat e ulëta të interesit.

Në fakt, ka disa faktorë, të cilët kanë ndikuar negativisht. Të gjithë jemi të qartë që faktorët pozitivë që kanë qenë nga pikëpamja apo termat makroekonomikë e kanë ndihmuar biznesin, por protestat e vazhdueshme të opozitës negative kanë bërë që klima e biznesit në Shqipëri të shkojë drejt përkeqësimit. Nuk mjafton vetëm mirëmbajtja e parametrave makroekonomikë, por duhet patjetër që edhe klima politike që të jetë e favorshme. Në fakt, kemi qenë të gjithë dëshmitarë të një opozite negative, e cila është përpjekur në çdo moment të tejçojë një klimë dhe një energji negative në ekonomi. Përplasjet nuk i bëjnë mirë klimës së biznesit, sepse krijojnë pasiguri si për investitorët e huaj, ashtu edhe për ata vendas.

Jemi të gjithë dëshmitarë që kemi kaluar një vit elektorale (kishim zgjedhjet lokale), me një opozitë, e cila është përpjekur në çdo mënyrë të ndalojë, apo të mbajë nën një re negative të gjithë ekonominë dhe shoqërinë shqiptare dhe patjetër që kjo ka dhënë efektin e vet si në konsum, ashtu edhe në investime. Të mos harrojmë që protestat e përjavshme të opozitës, sidomos në fundjavë, e kanë dhënë efektin e tyre në pikëpamjen e dëshirës për të investuar nga bizneset vendase dhe të huaja. Patjetër që një opozitë negative ndikon dhe e përkeqëson klimën e biznesit në Shqipëri, ndaj shpresojmë që në të ardhmen opozita të mos ketë si të vetmen arsye përkeqësimin e situatës ekonomike, të mos ketë vetëm planin e përkeqësimit të ekonomisë, me qëllimin për të ardhur në pushtet, por të ketë një alternativë reale.

Shpresoj që qeverisja të vazhdojë në parametrat e saj për të mbajtur nën kontroll deficitin buxhetor, borxhin kombëtar, për të ruajtur parametrat e inflacionit dhe për të mbajtur normat e interesit të ulëta. Ky ndoshta do të ishte momenti që t'i sugjeroja qeverisë të shohë mundësinë për të ulur normat e interesit në treg.

Para 3-4 javësh Greqia doli në tregjet ndërkombëtare me *Eurobond*-in e saj dhe mori norma të interesit negative, prandaj them që ky ndoshta është momenti që edhe qeveria shqiptare të mund të bëjë një *reschedule* të borxhit që ka

dhe pse jo, në këto momente, kur normat janë kaq të ulëta, në shumë raste kanë qenë negative dhe edhe vendet, të cilat kanë parametrat më të përkeqësuar ekonomikisht sesa Shqipëria, kanë dalë dhe kanë marrë norma negative të interesit në tregjet ndërkombëtare, kur në tregjet ndërkombëtare ka likuiditet, ndoshta ky është momenti që të ulim shpenzimet, pasi normat e interesit shpeshherë ndikojnë në ekonominë shqiptare me 15-20 milionë euro në vit, prandaj duhet bërë ndonjë aksion financiar për t'i ulur normat e interesit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Bushati!

Fjalën e ka Kostaq Papa.

Të përgatitet Vullneti Sinaj.

Kostaq Papa – Përshëndetje, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Pyetja e parë që lind në lidhje me buxhetin e vitit 2019 është: problematikat e pambyllura nga buxheti i vitit 2018 i prek, apo i përmirëson buxheti i vitit 2019? Jo? Atëherë buxheti i 2019-s dhe buxheti i 2018-s ngjasojnë si dy pika ujë. Buxheti i vitit 2019 e lë popullin më të varfër, pa investimet e duhura publike, sidomos në përmirësimin e infrastrukturës rrugore të fshatit, i cili ngelet pa shërbime dhe nuk flasim dot për cilësi shërbimesh, se ai nuk arrin të marrë ato për efekt të mungesës së rrugës. Fshati shqiptar po përjeton periudhën e fshatrave europiane të periudhës së pak viteve pas Luftës së Dytë Botërore.

Pyetja e dytë. A i shlyen buxheti i vitit 2019 detyrimet e prapambetura për nënat që lindën fëmijët në vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019? Jo. Atëherë ky buxhet qenka vaj me det, i lirë në miell, i shtrenjtë në krunde, ka dhënë para për aktivitete apo për probleme, që nuk ndikojnë në jetën e përditshme dhe përmirësimin total të jetës së shqiptarëve dhe nuk ka dhënë fondet e duhura, apo 5 mijë lekëshat, për nënat, që sjellin në jetë shqiptarinë, breza që ju i përndiqni çdo ditë derisa ta boshatisni këtë vend të bekuar nga Zoti.

Buxhet vetëm për militantët do të bëni ju?! Ka 75 vjet që po provohet se ky shtet nuk mund të bëhet nga militantët dhe nga partishmëria. Deri në vitin 1990 militantët, paraardhësit tuaj, ofruan utopinë dhe marrëzinë, denatyrimin

shoqëror dhe njerëzor, ndërsa në këta 30 vjet u provua nga ju dhe nga ata që ikën, nga të dyja palët që qeverisët me të njëjtën moto, uzurpimi i shtetit për të ruajtur rrogat e militantëve, por militantizmi është parazit rrogëtar, kolltukofag, burokrat, që nuk prodhon ide dhe reforma, por i mbyt ato për të ruajtur rrogën, madje edhe pensionet.

Buxheti i vitit 2019 nisi me një zhurmë të madhe investimesh të mëdha por doli një fiasco. Arteriet infrastrukturore kryesore të Jugut, apo e thënë ndryshe, boshti i Jugut, nga pjesa më jugore e tij, duke filluar nga ura e Kardhiqit deri në urën e Shelegarit në Sarandë u ndërpre, duke bllokuar financimin dhe investimin aq të nevojshëm për Sarandën, kryeqytetin e plazhit europian, për Delvinën patriotike të lënë në harresë, për fshatrat piktoreskë të toskërisë nga Peca, Muzina, Nivica, Sopiku, Mursia, për fshatrat e pamposhtur të Labërisë, që bënë luftën dhe historinë e që me rrugën kërkojnë të dalin nga izolimi, që u la nga diktatura dhe të vizitojnë kanionet natyrore me aromën e trëndelinës, të çajit të malit dhe me traditën e bulmetit, i cili nga skela e Sarandës në vitet '30 shkonte në diasporën shqiptare të Amerikës dhe të Kanadasë.

A mund të na thotë kush nga maxhoranca apo nga qeveria pse u ndërpre rruga Kardhiq-Delvinë, tuneli i qafës së Skarficës? U ndërpre për mungesë fondesh? Qeveria dhe buxheti i shtetit janë në krizë për para, pra për fonde, tërheqja dhe vonesa e këtij aksi kombëtar të rëndësishëm e lë qeverinë "Rama 1" dhe "Rama 2" pa veprën rrugore, e cila do ta klasifikonte këtë qeveri në një qeveri rrugëbërëse të një aksi të rëndësishëm, përfundimi i të cilit do të ishte më i kollajtë se ai i Rrugës së Arbrit. Në fakt, tërheqja nga investimi këtë vit dhe ndërprerja e tunelit të Skarficës tregon qartë se qeveria ka borxhe të sigurimeve shoqërore që nga viti 2018 në vlerën 14 miliardë, ose rreth 110 milionë euro. Rreth 1000 apo 1100 institucione publike nuk i kanë paguar sigurimet shoqërore për punonjësit e sektorit publik, nuk u kanë paguar as përqindjet që u kanë mbajtur nga rrogat, sidomos ata të pushtetit lokal. Mospagesat cenojnë besueshmërinë e qeverisjes, fshehin deficitin buxhetor apo edhe borxhin publik të vendit. Heshtja dhe mungesa e një sqarimi publik për gjendjen reale të deficitit dhe për bërjen

publike të problemit financiar, por edhe për sqarimin e shifrave të mospagesave në sigurimet, kur dokumentet tregojnë se janë paguar, tregojnë se ka nevojë për një plan masash për daljen nga amullia dhe mostransparenca, por më e rëndësishmja, për një plan real për pagesat e deficitit. Kjo heshtje vret ekonominë dhe investimet publike, dobëson ekonominë familjare për efekt të mbylljes së punëve dhe vë njëkohësisht në rrezik pensionet. Janë të domosdoshme evidentimi i institucioneve dhe i ndërmarrjeve publike, që nuk i kanë shlyer siguracionet bashkë me pagat, penalizimi i institucioneve dhe drejtuesve të tyre, shlyerja e borxhit të sigurimeve përmes bllokimit të investimeve kancelarike dhe shërbimet, shlyerja e borxhit të sigurimeve përmes zvogëlimit të çdo shpenzimi operativ, dhe rregullimi në afatet e qarta i shlyerjes së detyrimeve të mbajtura. Fryrja e administratës me punonjës militantë në institucionet qendrore dhe lokale ka qenë ndikuesi kryesor i kësaj problematike.

Dalja e shpeshtë nga kornizat ligjore të veprimtarisë së institucioneve shtetërore ndikon gjithashtu në këtë problematikë jo vetëm duke rrezikuar pagesat, pensionet, jo vetëm duke rrezikuar kredon e qeverisë, por duke rrezikuar seriozisht shtetin me rritjen e borxhit publik dhe duke e çuar vendin në rrugën e falimentimit.

Qeveria duhet të japë sot llogari për këtë situatë të rëndë dhe taksapaguesi shqiptar nuk ka pse ta mbajë këtë barrë të rëndë përmes rritjes së shfrenuar të taksave, deficitit buxhetor, apo skemave të pensionit, nuk ka pse të mbajnë këtë kosto pensionistët apo kontribuuesit e sigurimeve shoqërore për pensione, duke mos iu rritur pensionin sipas indeksit të inflacionit apo çmimeve të tregut. Nuk kanë pse ta mbajnë këtë kosto punonjësit, të cilëve nuk u ngrihen rrogat për të përballuar jetesën. Institucionet monitoruese publike apo private, si KLSH-ja etj, duhet të bëjnë vlerësimin real të gjendjes së institucioneve dhe shifrave. Interpelanca me ministrin e Financave dhe me Kryeministrin duhet të ishte e pashmangshme.

Ajo që dua t'i kujtoj maxhorancës dhe qeverisë është taksative, se rritja e pensioneve të ulëta, apo e pensioneve në përgjithësi, është e domosdoshme, pra çdo vit rritje sipas indeksit të inflacionit, duke e vënë theksin në pensionet shumë të ulëta të fshatit. Është e domosdoshme

rritja e rrogave të ulëta publike dhe private, është e domosdoshme që buxheti i vitit 2019 të shlyejë borxhet e viteve të fundit. Investimet publike në infrastrukturën rrugore janë të domosdoshme.

Materiali i këtij diskutimi u shkrua të martën dhe të mërkurën e javës së kaluar, kur ministrja e nderuar doli ditën e enjte në faqen e parë të gazetës dhe e pranoi borxhin publik me më tepër se rreth 13 miliardë, një gropë e zezë kjo në sigurimet publike të institucioneve qendrore dhe lokale, e cila rrezikon pagesat dhe pensionet e ardhshme.

Një masë direkte që zvogëlon gropën është shfryrja e administratës qendrore dhe lokale nga punëtorët e fushatave, që u futën në bordero disa muaj para dhe pas fushatës. Një masë tjetër është zvogëlimi i tenderave të vjedhjes në territoret e Bashkisë së Tiranës, mbyllja e kaosit, që ka shkaktuar, që i ka stresuar të gjithë, sidomos me trafikun e rënduar. Ky kaos pune nuk e gënjen dot qytetarin, nuk tregon punë, por zvarritje dhe vonesa procesesh për të justifikuar grabitjen. Një masë tjetër është lehtësimi nga burokracia për shpejtimin e proceseve, që ndikojnë në prodhim, sepse del që harxhohet më shumë para për letra, për projekte sesa për veprimtaritë në terren, që sjellin produkte, ushqime dhe shërbime. Ndërprisni blerjen e makinave dhe bërjen e zyrave luksoze për ministrinë dhe bashkitë!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Papa!

Fjalën e ka Vullnet Sinaj.

Të përgatitet Halit Valteri.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të kritikosh qeverinë, të nxjerrësh problemet apo të kërkosht rritje pensionesh, rritje pagash apo bërje rrugësh është shumë e thjeshtë, por puna është se kush do të japë këshilla se çfarë duhet bërë për të rritur këto të ardhura. Kjo është një nga arsyet që qeveria në këto kushte dhe me këtë ekonomi që ka Shqipëria (të gjithë e dimë se këtë situatë na kanë lënë, pra nuk është se këtu është parajsa), ka nxjerrë këtë akt normativ, i cili zakonisht nxirret në raste të nevojës dhe të urgjencës, kur zgjidhja e problematikave nëpërmjet procedurave të zakonshme apo të përshpejtuara të nxjerrjes së ligjeve, nuk mund të sjellë efikasitet dhe shpejtësi në zgjidhjen sa më shpejt të nevojës së paraqitur.

Rishikimi i buxhetit në mes të vitit buxhetor me anë të një akti normativ, është një instrument ligjor, praktik dhe i konsoliduar ndër vite. Qëllimi i aktit normativ të Këshillit të Ministrave, që do të miratojmë, duke i dhënë fuqinë e ligjit sot në Kuvend, është të ndryshojmë ligjin e buxhetit të vitit 2019, duke pasqyruar këto ndryshime të ndodhura në ekonominë e vendit gjatë këtyre 9 muajve, si dhe pritshmëritë për realizimin e treguesve kryesorë makroekonomikë e buxhetor deri në fund të vitit.

Ndryshimi i buxhetit sipas aktit normativ do të realizohet pa ndryshuar parametrat kryesorë të buxhetit, pa ndryshuar as borxhin dhe as deficitin buxhetor. Niveli i deficitit buxhetor mbetet aq sa ishte parashikuar, 1,9% e PBB-së, po kështu borxhi publik qëndron në kufijtë e parashikuar në buxhetin e miratuar me 65,5% e PBB-së. Në rastin konkret, ndryshimet buxhetore janë të nevojshme dhe urgjente, pasi krijojnë mundësinë për realizimin e disa objektivave të rëndësishëm ekonomikë dhe socialë.

Së pari, mundësojnë një mbështetje më të madhe për pushtetin vendor, duke rritur financimin e tij me 4 miliardë lekë. Kjo rritje e financimit të pushtetit vendor reflekton ecurinë mjaft pozitive të mbledhjes së të ardhurave vendore gjatë këtij viti. Për periudhën 9-mujore të ardhurat nga pushteti vendor janë rritur nga 2,5 në 3 miliardë. Rritja e financimit të pushtetit vendor do të sigurohet nga rritja e të ardhurave të veta me 3 miliardë dhe 1 miliardë financim nga jashtë.

Së dyti, sigurohet financimi i fondit rezervë të buxhetit të shtetit, i cili rritet me 450 milionë lekë dhe kjo masë synon të sigurojë financimin e nevojshëm për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 21 shtator 2019.

Së treti, bëhen disa riallokime mes zërave të shpenzimeve korrente, që bazohen në ecurinë e 9-mujorit dhe synojnë rritjen e sigurisë dhe realizimin e treguesve të buxhetit nga ministrinë dhe institucionet publike, rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, si dhe reduktimin e detyrimeve të prapambetura. Këto riallokime janë: 200 milionë lekë për mbështetjen e skemës së fermerëve lidhur me kompensimin e çmimit të qumështit, 450 milionë lekë për orët jashtë orarit të efektivëve të Policisë së Shtetit, 300 milionë lekë për financimin e

arsimit bazë, 300 milionë lekë për mbështetjen e skemës së aftësisë së kufizuar.

Së katërti, realizohet rishpërndarja e fondeve të investimeve drejt projekteve me ecuri më të mirë, si: bajpasi i Fierit 370 milionë lekë, 800 milionë lekë për projektet kryesore të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, 200 milionë lekë për rikonstruksionin e TOB-it, 200 milionë lekë për mbrojtjen e argjinaturave të lumenjve, duke parë dhe situatën në të cilën jemi, 90 milionë lekë për rikonstruksionin e godinës së maternitetit të vjetër, 1 miliard lekë për avancimin e punimeve në projektin e bulevardit verior dhe rehabilitimin e lumit të Lanës.

Mendoj se është e pamundur, por dhe mund të kishte shumë vështirësi sikur me anë të një akti normativ të realizohej gjithçka që kishte nevojë ekonomia. Për faktin se në aktin normativ përmenden dy zëra, pasojat e tërmetit dhe subvencionet në bujqësi, nuk mund të rrija pa u bërë disa kërkesa ministrive përkatëse dhe Ministrisë së Mbrojtjes e Drejtorisë së Emergjencave për tërmetet që kanë ndodhur edhe më parë.

Për shembull, në zonën ku jam deputet, në datën 19.05.2018, në krahinën e Smokthinës, në fshatrat Matogjin, Bashaj, Vërmik, ka rënë tërmet dhe janë shkatërruar 41 shtëpi, nga të cilat 23 janë të pabanueshme. Po ashtu, në fshatin Kocul ka ndodhur një rrëshqitje e tokës dhe janë dëmtuar 27 shtëpi. Ndoshta ka pasur probleme edhe nga bashkia e mëparshme, që ka vonuar dokumentet për të ardhur në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe ndoshta për këtë arsye akoma nuk janë marrë masa për riparimin e këtyre shtëpive, por do t'i kërkoja ministres së Mbrojtjes, Drejtorisë së Emergjencave dhe qeverisë që në projektbuxhetin e vitit 2020 të bëjnë një parashikim fondesh, që të kemi mundësinë t'i përballojmë dëmet e këtyre tërmeteve.

Tërmet ka rënë edhe më 4 janar të këtij vitit në Kuç, në Bashkinë e Himarës, ku janë dëmtuar 94 shtëpi dhe 4 prej tyre janë klasifikuar si të pabanueshme. Duke marrë parasysh edhe tërmetin që ra në Smokthinë, kam besimin se në projektbuxhetin e vitit 2020 do të merren masa për t'i eliminuar këto pasoja.

Ndalemi pak te subvencionet në blegtori.

Zona ku unë jam deputet është malore dhe favorizon mbarëshkrimin e bagëtisë së imët. Edhe

pse kam pasur një takim me ministrin e Bujqësisë dhe më ka premtuar që do të ketë një vendim qeverie, ku do të ketë një shtim të fondit për subvencionin e bagëtive të imta, si deputet i kësaj zone do të kërkoja shtimin edhe më tepër të këtij fondi për shumë arsye.

Me masën që u mor për këto subvencione aplikuan rreth 256 fermerë të zonës sime dhe përfituesit nga ky fond ishin shumë pak. Unë jam kritik i parimit “kush vjen i pari, renditet i pari”. Parimi “kush vjen i pari, renditet i pari në këto subvencione” i ka penalizuar pak fermerët e zonës sime, që është malore”.

2300 është numri i aplikuesve në gjithë Shqipërinë. Nga këta 2300 aplikues, 500 fermerë kanë marrë subvencione. Kanë ngelur edhe 1800 fermerë. Nuk do të ishte ndonjë gjë e madhe të ishin subvencionuar edhe këta 1800 fermerë. Këtë e kërkoj për shumë arsye. Një ndër arsyet është se në zonat malore dhe tepër malore blegtorja e imët është baza e ekonomisë së fermerëve. Prodhimet që ata nxjerrin do të kompensojnë çdo produkt, që mund të vijë nga importi në tregun tonë, por pse të mos jenë edhe produkte për eksport, kur e dimë që cilësia e mishit të këtyre fermave shqiptare është nga më të mirat që mund të ketë Europa?

Shpreh besimin se të gjitha kërkesat e mia, si deputet i kësaj zone do të merren parasysh nga Ministria e Mbrojtjes, për dëmet e tërmetit në Smokthinë dhe në Kuç, ashtu edhe për të shtuar subvencionimin e fermerëve për mbarëshkrimin e bagëtive të imta, për t'u krijuar atyre mundësinë që vitin e ardhshëm të kenë sa më shumë prodhime blegtorale. Kjo edhe për arsyen se bujqësia është një sektor që e subvencionon gjithë bota, e subvencionon Amerika, Europa dhe Ballkani.

Kështu që politikat ekonomike për bujqësinë dhe blegtorinë do të propozoja të mos i kishim vetëm kombëtare, por edhe pak rajonale, me qëllim që të mos lejojmë konkurrimin e produkteve të fermave shqiptare nga produktet e fermave të rajonit.

Duke menduar se qeveria po bën maksimumin e mundshëm për përmirësimin e kushteve ekonomike, siç janë masat që po merr për financimet në pushtetin vendor, për subvencionimin e bujqësisë dhe të çmimit të qumështit dhe masa të tjera, të nderuar deputetë, edhe ju të opozitës, që mundoheni të jeni kritikë,

ndonjëherë edhe për shkak të pozicionit ku ndodheni, por jo për shkak të realitetit dhe atyre që ka bërë qeveria “Rama” (se ju garantoj që ato që kanë bërë qeveritë “Rama” në këta 6 vjet janë shumë herë më tepër se ato që kanë bërë qeveritë e mëparshme në 24 vjet), ju ftoj ta votoni këtë akt normativ, i cili mbas miratimit tonë do të marrë fuqinë e ligjit!

Faleminderit që më dëgjuat!

(Drejtimit e seancës e merr zoti Murrizi.)

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Sinaj! Fjalën e ka deputeti Halit Valteri.

Halit Valteri – I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të marrësh fjalën mbas arritjeve të qeverisë “Rama”, është pak e vështirë ta “godasësh”, se Vullnetin e kam mik dhe nuk rrimë dot...

Kjo, Vullnet, është qeveria e barsolletave, që, kur vjen puna të menaxhimi i parave të shqiptarëve, konkurron bindshëm edhe me Nastradinin dhe bëmat e tij, ku çdo javë del një personazh që të gajas.

Kur bëhet fjalë për buxhetet, para çdo buxheti del emri i ministres së Energjetikës, Belindës, ministres sonë të nderuar, e cila dikur drejtonte kujdesin ndaj klientit në një kompani telefonike në vend, u katapultua vetëm në poste të larta shtetërore dhe s’i preku këmba në baltë. Sot do të menaxhojë pjesën më të madhe të tepsisë së shtetit, disa miliarda lekë, vetëm në dorën e saj.

Të dashur shqiptarë,

A e kuptoni çfarë tmerri është ky?! 1/3 e parave tuaja do të mirëmenaxhohen me kaq profesionalizëm nga ministrja!

Nuk kam asgjë kundër atyre që kanë zgjedhur të bëjnë punë të thjeshtë dhe të ndershme, madje i respektoj të gjithë ata që mund të bëjnë prokopi në jetë, por ministrja jonë, që do të menaxhojë paratë e shqiptarëve, nuk bën pjesë te kapacitetet mendore kombëtare, për sa kohë që askush nuk gjen ndonjë dokument të veçantë për formimin intelektual të saj, përveçse është diplomuar në ’99-n për administrim biznesi në Athinë.

Eksperiencia e saj, duke iu përgjigjur të gjitha pikëpyetjeve që kanë shqiptarët, mund të vlejë fare mirë për të rinjtë që po largohen çdo ditë dhe, pse jo, të bëhet edhe model frymëzimi për ta, që sot më shumë se kurrë janë të demoralizuar nga politikat e kësaj qeverie. Se

mos ndoshta ua mbush mendjen të rinjve, që kanë marrë rrugët e Europës dhe ata kthehen dhe ndjekin rrugëtimin e saj të suksesit...!

Po, le t’i kthehemi buxhetit. Ministrja, që dikur drejtonte kujdesin ndaj klientit në kompaninë e celularëve, sot do të kujdeset edhe për paratë e shqiptarëve, më saktë, për majmjën e klientëve të qeverisë, dhe nuk i ka pasur aspak marrëdhëniet e mira me buxhetin. Për shembull, ka pasur një shpërdorim të 61 milionë lekëve të shqiptarëve për ndërtimin e një palestre në kohën kur ajo drejtonte Albkontrollin, së cilës nuk i hyri aspak në punë. Rezultatit e atij shpenzimi të pajustifikuar e keni para jush, mjafton t’i hidhni sytë, se nuk ka nevojë për koment.

Në fakt, nuk kanë faj, se, teksa ju dhe familjet tuaja përpigjeni të siguronit bukën e gojës dhe të shtyni ditët duke kërcitur dhëmbët sa herë shihni personazhet e famshme në ekran, këta sforcohen ku t’i kalojnë netët, ku t’i shpenzojnë paratë tuaja në hotele më 5 yje, 6 yje, 7 yje, 8 yje, se këta i kanë yjet pa fund! Këta nuk dinë se në cilin universitet të botës do t’i shkollojnë fëmijët, janë në mëdyshje se çfarë rrobash firmato do të veshin, çfarë makine do të blejnë që të kapardisen si milionerë apo ku do t’i kalojnë fundjavat më këta drejtorë, që punojnë me intensitet të plotë, që të sigurojnë këtë luks për ju!

Teksa shqiptarët mezi sigurojnë kafshatën e fëmijëve, Gentin (kur e bënë ministër, dukej si emigrant nga Lampeduza dhe sot i janë zmadhuar faqet, por jo për shkak të integritit, se ka pasur maraz për negociatat, i shkretë) e mbajnë këta ministrat e tjerë me kokrra gruri e kokrra misri dhe po e bëjnë si gjel deti për ta prerë për Vitin e Ri, për të ngrënë mish, se për pensionistët nuk ka gjela deti, do të hanë Gentin!

Sigurisht, shqiptarët gajasen me ju. Shqiptarët janë të drobitur me ju. Ju jeni figurat që çdo ditë u gllabëroni lekët dhe nuk dini çfarë t’u thoni!

Pyeta më parë kolegët e mi të Komisionit të Ekonomisë për këtë buxhet, për këtë akt normativ që kanë sjellë, dhe nuk mora asnjë shpjegim. Nuk dihet se ku do të shkojnë 300 milionë lekë të rinj! Çojmë akte normative nga 3 miliardë lekë të shqiptarëve për Paktin për Universitetin dhe nuk thoni se si do të përdoren këto para!

Gjithsesi, nëse keni sadopak ndërgjegje, bëni spitale, se po vdesin shqiptarët çdo ditë! Blini ilaçe, jo të skaduara, dhe çojuni shqiptarëve! Paratë e shqiptarëve nuk mund të përdoren për qejfe personale, se do të na mbijë ndonjë ditë të bajpasi i Fierit ndonjë sauna apo ndonjë palestër, që të dobësoni cilësinë e rrugës, jo cilësinë e ministrave!

Doja të replikoja pak edhe me zonjën Gjona, por nuk qenka këtu, se foli për arritjet në sistemin e burgjeve. Për pak mendova se isha në ëndërr dhe po mendoja burgjet e Skandinavisë, Suedisë, Norvegjisë dhe Danimarkës.

E nderuar Ministre, a e di që punonjësit e burgjeve enden rrugëve, duke bërë *autostop* që t'i marrë dikush e t'i çojë në shtëpi të fëmijët, mbasi kanë qëndruar 12 orë në punë me kriminelët, mbasi kriminelët janë kapardisur me luks dhe i kanë të gjitha kushtet, sikur të ishin jashtë, e po i ruan shteti? Ndërkohë, ju flisni për rrogat skandaloze që kanë ata, për 300 mijë lekë të vjetra, që nuk dalin as për ujë, as për drita dhe as për qejfet e shefave dhe të drejtorëve të burgjeve!

Kështu që mos lini nam! Hajdeni këtu dhe sillni diçka serioze, jo këtë buxhet dhe këtë akt normativ, që të skandalizon!

Të nderuar shqiptarë, ju takon juve dhe e keni ju në dorë një herë në 4 vjet atë të shkretë votë, por duhet ta mbani mend teatrin që bëjnë këta monstra!

Faleminderit!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Valteri!

Fjalën e ka deputeti Xhevit Bushaj.

Të përgatitet Senida Mesi.

Xhevit Bushaj – Faleminderit, zoti drejtues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Akti normativ që diskutojmë sot në këtë seancë, "Për disa ndryshime në ligjin nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019"", vjen si një domosdoshmëri për vazhdimin, realizimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2019.

Ky akt është i domosdoshëm dhe i nevojshëm nisur nga këta faktorë: periudha e shtrirjes së realizimit të këtij buxheti; eksperiencia tashmë e krijuar, përafërsisht prej 9 muajsh; kushtet konkrete të realitetit ekonomik, si dhe përshtatshmëria në bazë të legjislacionit dhe akteve normative, që rregullojnë këto

marrëdhënie në buxhet, në të dyja pjesët dhe grupet e tij, në të ardhura dhe në shpenzime.

Ndryshimet e propozuara në aktin normativ nuk prekin treguesit kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë, duke e ruajtur deficitin në nivele të pandryshueshme dhe duke forcuar më tej objektivin e qeverisë për qëndrueshmërinë fiskale.

Disa nga arsyet kryesore për realizimin e këtij akti janë: bën të mundur kompensimin e zërave të shpenzimeve buxhetore, që u prekën në fillim të vitit 2019; të ardhurat vendore janë në rritje dhe kërkojnë rregullim e pasqyrim në këtë buxhet; garantimi i financimit të fondeve rezervë të buxhetit të shtetit, në vijim të situatave emergjente të krijuara pas tërmetit të datës 21.09.2019; për efekt të financimit të Paktit për Universitetin; rritja e eficiencës së përdorimit të burimeve publike drejt projekteve me realizim të mirë deri tani, si dhe rritja e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit në tërësi.

Ndër synimet kryesore, mund të përmend: ruajtja e nivelit të planifikuar në buxhetin e vitit 2019 në parametrat kryesorë, si niveli i deficitit buxhetor, rritja ekonomike, ulja e papunësisë e të tjera, që ndikojnë në shëndoshjen e financave publike; reflektimi i rritjes së shpenzimeve për njësitë vendore, si rrjedhojë e rritjes së të ardhurave vendore, si dhe mundësinë që japin, në masën 1 miliard lekë, financimet e huaja dhe vendore; mundësia e shlyerjes në kohë të detyrimeve financiare kontraktuale të institucioneve buxhetore, nëpërmjet rialokimeve buxhetore, duke reduktuar mundësinë e krijimit të detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2019; akomodimi i nevojave të reja të funksionimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, si nga pikëpamja e shpenzimeve, ashtu edhe nga numri i punonjësve.

Duke pasur parash performancën makro-fiskale të buxhetit të 9-mujorit të vitit 2019, eksperiencën tashmë të njohur në praktikën e përvitshme, si dhe në parashikimet e pritshme të këtyre treguesve deri në fund të këtij viti buxhetor, akti normativ e vë theksin e tij në ruajtjen e parametrave kryesorë të buxhetit të miratuar në fillim të vitit. Deficiti buxhetor mbetet i pandryshuar, ndërkohë që të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit pësojnë sistemime të vogla mes zërave, me efekt neutral për buxhetin e shtetit.

Ky akt normativ krijon rialokim brenda zërave të shpenzimeve të buxhetit, të cilat sigurojnë financime të disa zërave sensitivë të shpenzimeve koherente, si: fondi rezervë, skema e fermerëve, skema e personave me aftësi të kufizuar, arsimin e lartë, si dhe për rendin e mbrojtjen.

Gjithashtu, rritet performanca e shpenzimeve kapitale përmes alokimit të burimeve dhe rialokimit të fondeve drejt projekteve të investimeve publike, të cilat rezultojnë me progres të mirë deri tani, me qëllim arritjen e nivelit të programuar të vitit 2019. Kjo e gjykuar edhe nga trendi ndër vite i realizimit të investimeve publike, ku punimet përqendrohen kryesisht në tremujorin e fundit.

Ndër të tjera, akti normativ i garanton në mënyrë të veçantë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë 1 miliard lekë financime të huaja për mundësinë e avancimeve të punimeve në bapasin e Fierit.

Për të sqaruar kolegët, të cilët pyetën për fazën e punimeve, por edhe publikun, dua të them se njëri aks i bapasis të Fierit ka funksionuar në sezonin turistik të këtij viti, i cili krijoi avantazhe si për banorët e zonës, por edhe për turistët që vizituan zonën e jugut. Gjithashtu, punimet vazhdojnë në mënyrë intensive dhe brenda muajit shkurt mbaron edhe aksi i dytë. Pra, bëhen funksionale bapasi dhe ruga dytësore, e cila do t'u shërbejë banorëve të zonave.

Përfitohen edhe 370 milionë lekë për shpronësime të objekteve të Autoritetit Rrugor Shqiptar. Këtu dua të ndalem pak, sepse kjo është risi si për qeverinë, por edhe për Autoritetin Rrugor Shqiptar, i cili ka një numër të konsiderueshëm fermerësh të padëmshpërblyer, sidomos në zonat e autostradës Levan – Tepelenë, ku përfshihen njësitë administrative të Levanit, Frakullës, Cakranit, Mallakastrës, Memaliajt dhe Tepelenës. Shpresoj që nga rialokimi i këtij fondi apo nga kjo shtesë që bëhet nëpërmjet këtij akti normativ të gjejnë zgjidhje problematikat, që ne vazhdimisht i ndiejmë si shqetësim nga banorët e këtyre zonave.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit përfiton 800 milionë lekë për avancimin e projekteve kryesore të programeve të zhvillimit.

Ministria e Bujqësisë përfiton 200 milionë lekë për vazhdimin e financimit të projekteve me fokus mbrojtjen e argjaturave lumore dhe sistemin e kanaleve ujitëse.

Unë shpresoj të gjendet një zgjidhje edhe për banorët e njësisë administrative të Cakranit, sepse në fushën e tyre pjellore prej 1800 hektarësh, që nga vitit 2008 që është bërë autostrada Levan–Tepelenë, është ndërprerë furnizimi dhe vaditja me ujë e kësaj fushe. Pra, dikasteri i Ministrisë së Bujqësisë në bashkëpunim edhe me pushtetin vendor, i cili ka bërë tentativat e vazhdueshme dhe projekte ambicioze, për ta vaditur këtë fushë, duhet të gjejnë një zgjidhje sa më të shpejtë, në mënyrë që këta fermerë ta ndjejnë dorën e qeverisë për të vaditur fushat e tyre.

Të sigurojnë financime efektive në njësitë vendore nëpërmjet rritjes së kufirit të të ardhurave me rreth 3 miliardë lekë, ndërkohë edhe rritjen e shpenzimeve me 4 miliardë lekë, nga të cilat 3 miliardë rriten për efekt të të ardhurave dhe 1 miliard për efekt të rritjes së tavanit, për projektet me financim të huaj.

Ndryshimet e propozuara nga akti normativ do t'u japin zgjidhje disa nga problematikat e hasura gjatë zbatimit të deritanishëm të buxhetit të shtetit, duke e bërë të mundur arritjen e këtyre objektivave, si: ruajtjen e pandryshuar të nivelit të planifikuar të parametrave kryesorë makroekonomikë, garantimin e financimit të nevojave të pushtetit vendor, garantimin e financimit të fondeve të buxhetit të shtetit për përballimin optimal të situatave emergjente, rritjen e eficiencës së burimeve publike përmes rialokimeve me zërat e shpenzimeve, si dhe rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, të nderuar kolegë, ju ftoj të votojmë projektligjin për këtë akt normativ.

Faleminderit!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Bushaj!

Fjalën e ka zonja Senida Mesi. Të përgatitet zoti Zef Shtjefni.

Senida Mesi – Përsëndetje!

I nderuar drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar bashkëqytetarë që po na dëgjoni,

Akti normativ që po trajtojmë sot është i pari i ndryshuar për këtë vit dhe konsiston në disa elemente kryesore. Nuk është hera e parë që e bëjmë, por është një proces rutinë, ku Ministria e Financave inicion dhe harton një akt normativ me qëllim që të jemi aty ku duhet deri në fund të vitit 2019.

Çfarë është marrë parasysh për trajtimin e këtij akti normativ? Kompensimi i zërave buxhetorë, të cilët u preken në fillim të vitit 2019, reflektimi i ecurisë optimale të ardhurave vendore që nga fillimi i këtij vitit e deri tani, garantimi i financimit të fondit rezervë të buxhetit të shtetit në vijim të situatës së emergjencës së krijuar pas tërmetit të datës 21 shtator të këtij viti, si dhe rritja e eficiencës së përdorimit të fondeve në dispozicion për pjesën e shpenzimeve dhe investimeve.

Çfarë vlen të përmendim deri tani dhe çfarë ka ndodhur në ekonominë shqiptare, duke lënë pas vitin 2018 dhe analizën e vitit 2019? Tashmë të gjithë e dimë që viti 2018, jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë rajonin, ishte një vit i suksesshëm për rritjen ekonomike. Kjo ishte rritja edhe më e madhe gjatë 10 vjetëve të fundit në Shqipëri dhe njëkohësisht shënoi rënie të papunësisë. Këto nuk janë shifra, por janë fakte.

Sot që flasim në të gjithë rajonin, kjo e konfirmuar edhe nga Fondi Ndërkombëtar, por kryesisht nga Banka Botërore, shohim një tendencë në rënie të rritjes ekonomike. Aktiviteti ekonomik në Ballkanin Perëndimor po ngadalësohet, pasi investimet dhe eksportet kanë vijuar të zbehen në të gjithë vendet e rajonit. Sipas raportit të fundit të Bankës Botërore, për Ballkanin Perëndimor, ritmi i rritjes ekonomike gjatë vitit 2019 vlerësohet të ngadalësohet me 3,2 nga 3,9, pothuajse 4, që ishte vitin e kaluar. Në Maqedoninë e Veriut dhe në Kosovë ritmet e rritjes kanë qenë të përshpejtuara, ndërsa për të gjitha vendet e tjera të rajonit, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, fatkeqësisht, ka shënuar një ngadalësim të rritjes ekonomike. Edhe pse gjatë viteve 2020 – 2021 parashikimet janë pozitive për rritjen ekonomike, sot ne kemi një ngadalësim të kësaj rritjeje. Por edhe pse ka një ngadalësim të rritjes ekonomike, kjo nuk e ka penguar vendin tonë të ketë një numër të shtuar të fuqisë aktive punëtore në punë dhe për të krijuar vende të reja pune. Kur flas për vende të reja pune, dua të ndaj me ju vetëm një shifër

interesante, ndër të gjitha të tjerat janë mbi 43 mijë vende pune të hapura në rajonin e Ballkanit Perëndimor për të rinjtë, kjo listë është bërë nga Banka Botërore, ku Shqipëria listohet si një nga vendet që ka kontribuar me pothuajse gjysmën e kësaj shifre në punësimin e të rinjve.

Të gjithë dakordësohemi që klima politike e acaruar tejmasë, duke filluar nga shkurti i këtij viti, nuk ka rezultuar efektive dhe nuk ka ndihmuar rritjen ekonomike e aq më tepër në ritmin e rritjes së saj. Kjo krijon pasiguri, dëmton imazhin dhe sigurisht, frikëson investimet e huaja direkte, por jo vetëm, ajo po ngurtëson pak edhe kërkesën e brendshme për investim dhe ndoshta njëkohësisht edhe pjesën e kreditimit të këtyre investimeve brenda për brenda territorit të Shqipërisë.

Frenimi i rritjes ekonomike në Ballkan i dërgon sinjale Shqipërisë për të ndërtuar politika, të cilat nxisin sipërmarrjen, lehtësojnë, standardizojnë dhe bëjnë transparente të gjitha procedurat, përfshirë ato tatimore dhe fiskale. Ne kemi nevojë për nxitje drejt ekonomive efeciente e inovative dhe, sigurisht, në përdorimin me efikasitet të shpenzimeve dhe investimeve publike.

Rritja ekonomike, e thënë ndryshe, duhet të jetë më influencive dhe më gjithëpërfshirëse. Pra, qëllimi është që të gjithë të kontribuojmë te rritja ekonomike dhe jo vetëm në disa sektorë të veçantë, sikurse është energjia apo bujqësia. Unë kam besimin që turizmi bregdetar dhe ai malor në ato zona, të cilat sot mund të jenë të abandonuara, por nëpërmjet projektit “100 fshatrat”, skemave të tjera të investimit dhe Ministrisë së Bujqësisë do të zhvillohen, duhet t'i kthejnë Shqipërisë atë që dikur e kishte edhe Italia në zhvillimin turistik malor, pra duhet të japin një benefiit po aq të ngjashëm dhe po aq të suksesshëm ekonomisë shqiptare.

Nuk janë vetëm lehtësirat fiskale, por edhe krijimi i zonave të pavarura dhe të lira, ku nxisin investitor të huaj për të investuar direkt në vendet perla që ka Shqipëria.

Në paketën fiskale të vitit që vjen, ne duhet të shikojmë lehtësira në lidhje me investimet e huaja direkte. Duhet të jemi po aq konkurrues, pse jo edhe më shumë, me vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Kjo duhet të vijë e shoqëruar edhe me një stabilitet të qartë politik.

Luftën kundër informalitetit unë e vlerësoj shumë pozitive. Këtu më lejoni të falënderoj ministrin dhe Ministrinë e Financës për një punë persistente ndaj kësaj. Unë nuk dua ta quaj luftë apo një reformë, por një punë e vazhdueshme që Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë dhe do të vazhdojë të jetë po aq presistente, me qëllim që çdo biznes që ushtron aktivitet të lirë, çdo sipërmarrës në Republikën e Shqipërisë, duhet të regjistrohet dhe duhet të paguajë taksat si gjithë të tjerët. Kjo jo vetëm për të rritur konkurrencën, por edhe për t'i kthyer arkës së shtetit të ardhura dhe detyrimet e nevojshme për t'u paguar.

Akti normativ garanton një rishpërndarje të disa zërave dhe merr parasysh situata të paparashikuara për ne në momentin kur u miratua projektbuxheti i vitit 2019.

Më vjen mirë kur shikoj, për këtë përgëzoj Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave, që në propozimin e këtij akti normativ merren parasysh 450 milionë lekë pagesa jashtë orarit për efektivët e policisë, të cilët, për hir të së vërtetës, pothuajse për 6 muaj kanë dalë në punë jashtë orarit, në një klimë tejet të polarizuar politike dhe jashtë normales, duke filluar nga janari i këtij viti dhe deri para pak muajsh. Unë besoj që jo vetëm e meritojnë, por ne duhet të bëjmë shumë më shumë për një kategori të tillë të punësuar në administratën tonë.

Ky akt i jep Ministrisë së Shëndetësisë shumë e nevojshme për skemën e personave me aftësi të kufizuar, Ministrisë së Arsimit investime shtesë në arsimin bazë, Ministrisë së Bujqësisë, si një faktor shumë i rëndësishëm në rritjen ekonomike, mbi 200 milionë lekë për skemën e fermerëve, ku shumë e rëndësishme është rritja e eficiencës së investimeve, duke marrë parasysh për t'u dhënë prioritet atyre investimeve që kanë ecur sipas një trendi normal, në bazë të planit dhe që kanë arritur nivelin e parashikuar të programimit të investimeve. Pra, është gjykuar që t'u japin lekë atyre projekteve që kanë ecur dhe janë në një linjë me programimin, ndërsa të tjerat, që ende nuk kanë filluar, të mos i fillojnë për t'i lënë përgjysmë deri në fund të vitit, por të finalizojmë ato projekte shumë të rëndësishme që kanë filluar.

Nuk dua të ndalem më tepër në detaje, sepse kolegët e mi i kanë përmendur detajet e

tjera, si financimin dhe mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë apo të Bashkisë së Tiranës për avancimin e projektit të bulevardit e kështu me radhë, prandaj ju ftoj të gjithëve që të miratojmë njëzëri amendimet dhe propozimet për këtë akt normativ.

Faleminderit!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zonja Mesi!

Fjalën e ka deputeti Zef Shtjefni. Të përgatitet zoti Ilir Beqaj.

Zef Shtjefni – I nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot po diskutojmë aktin normativ për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2019. Ju duhet të na informoni pse detyroheni të bëni ndryshime në fund të vitit. Puna juaj e përditshme është të realizoni të ardhurat që vijnë nga mbledhja e taksave nga doganat, nga pushteti vendor dhe nga shërbime të tjera.

Ju duhet të na informoni se çfarë keni bërë me paratë e shqiptarëve në këtë vit. Si ka qenë shpërndarja e fondeve sipas bashkive të vendit? Sa fonde keni dhënë për Veriun e Shqipërisë? Sa fonde keni dhënë për bashkitë që deri dje drejtoreshin nga e djathta? Sa fonde keni dhënë për shtresat në nevojë? Sa fonde keni dhënë për fëmijët e policëve të vrarë në krye të detyrës? Sa fonde keni dhënë për të simuluar hapjen e bizneseve të reja? Pra, keni dhënë zero lekë ose keni dhënë fonde të papërfillshme.

Ju tani kërkoni të transferoni zërat, të kaloni fondet që keni miratuar në zëra të tjerë për investime, ose t'i hiqni fare, sepse nuk keni realizuar mbledhjen e të ardhurave.

Unë nuk dua të besoj që një ish-ministër Financash, socialisti juaj, javën e shkuar deklaroi se shteti nuk ka lekë as për rroga dhe as për pensione. Pra, nuk dua të mendoj se shteti është katandisur deri këtu, por dua t'ju them se ne kërkojmë një pasqyrë të gjendjes reale në Shqipëri, pra si janë financat dhe në çfarë gjendje ndodhet aktualisht vendi. Ne nuk e dimë çfarë keni bërë me paratë e shqiptarëve gjatë këtij viti buxhetor.

Si do të veproni me detyrimet që i kanë shtetit bashkitë që dalin të falimentuara? Ju doni të vini administratorë për të udhëhequr punën, që të dilni nga kjo gjendje, por po punësoni disa

administratorë që nuk do ta ndryshojnë këtë gjendje. Ajo që duhet bërë është të zerohen disa shpenzime dhe borxhe që pushteti vendor ka ndaj shtetit. Këto borxhe janë akumuluar prej shumë vitesh.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Ne duhet të dimë nga qeveria se sa rrugë të reja janë ndërtuar këtë vit. Sa investime janë bërë për Bashkinë e Shkodrës? Sa shkolla janë ndërtuar në zonën e Veriut të Shqipërisë? Sa ujësjellës janë ndërtuar? Sa kopshte të reja janë ndërtuar me buxhetin vjetor dhe jo me investime të ardhura nga jashtë? Kush ka një bilanc për këto shpenzime, le të na e tregojë!

Unë dua t'ju them: bëni diçka të mirë për këtë vend! Shtoni rrogat dhe pensionet! Një ditë, me disa kolegë deputetë, vizituam burgun e Durrësit dhe po ju them se punonjësit e burgjeve janë heronj, që bëjnë një punë të jashtëzakonshme. Bëni diçka për ta! Shtojuni rrogat! Njësojini rrogat e tyre me ato të Policisë së Shtetit! Ata bëjnë një punë të lodhshme, të mërzitshme dhe pa asnjë ndihmë nga shteti shqiptar.

Ministria e Drejtësisë duhet të bëjë gati një draft për pagat, për t'i klasifikuar sipas vështirësive punonjësit e burgjeve. Shpenzoni para për këtë, sepse shteti duhet të jetë i fortë. Punonjësit e shtetit duhet të zbatojnë ligjet dhe të paguhet për punët e vështira që bëjnë.

Votën time do ta keni gjithmonë kur të vlerësoni punët e vështira që janë lënë në harresë nga shumë qeveri të këtij vendi. Pagat dhe uniformat në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve duhen të jenë të njesuara. Ju keni transferuar shumë punonjës të Policisë së Burgjeve, të cilët me gjysmën e rrogës së tyre paguajnë rrugën për të shkuar me shërbime. Thirrja ime është: bëni gati ligjin, që ta kalojmë në parlament dhe ky shërbim kryesor të gjejë zgjidhje sa më parë.

Meqë jemi në prag të buxhetit të vitit 2020, të bëjmë diçka të mirë për punonjësit e shtetit. Ju mund të bëni sa të doni ndryshime për shumë zëra të pazbatuar të buxhetit të vitit 2019, por kjo nuk e ndryshon gjendjen tonë financiare. Sa janë detyrimet e paguara për këtë vit nga kompanitë që kanë kryer investime? Do t'i kaloni për vitin tjetër buxhetor? Rregullojini dhe armoni sa të mundeni, por po nuk ndryshuat gjendjen e qytetarëve shqiptarë, nuk keni bërë asgjë.

Ndryshoni gjërat e prekshme! Ndërhyni për pensionet, për të sëmuret, për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët marrin një pagë të papërfillshme. Ne do të themi se kemi bërë diçka të mirë për vendin, vetëm atëherë kur çdo shtresë shoqërore e këtij vendi ta gjejë veten në buxhetin që do të vijë në parlament.

Gjendja ekonomike e vendit nuk është e mirë, por nuk dua të vajtoj si disa që thonë se ky vend ka marrë fund, se nuk ka as rroga dhe as pensione për t'u dhënë qytetarëve. Ne nuk jemi në atë gjendje, por kërkoj me forcë që paratë e shqiptarëve të përdoren për menaxhimin e jetës së tyre dhe jo të shkojnë në xhepat e disa të babëziturve, që nuk po ngopen në këta 30 vjet.

Parlamenti duhet të monitorojë punën e qeverisë nëpërmjet komisioneve, kontrolleve të vazhdueshme, që, kur të vijë Kontrolli i Lartë i Shtetit, ta kemi të qartë situatën si parlament, por edhe si qeveri. Kontrolli i Lartë i Shtetit nxjerr çdo vit miliona euro abuzime nga administrata e shtetit shqiptar.

Parlamenti duhet të rrisë kontrollin ekonomik-financiar ndaj qeverisë, me qëllim që të ndalohen abuzimet me pushtetin, që të jenë sa më të reduktuara dhe të shkojnë për hallat dhe problemet e qytetarëve shqiptarë. Buxheti i vitit 2020 duhet të jetë tërësisht në dobi të qytetarëve.

Urojmë dhe shpresojmë që ditë më të mira do të vijjnë për Shqipërinë dhe për shqiptarët!

Faleminderit!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Shtjefni!

Fjalën e ka deputeti Ilir Beqaj.

Të përgatitet zonja Anila Denaj.

Ilir Beqaj – I nderuar drejtues i seancës,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Sot po diskutojmë aktin normativ për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të shtetit. Ka vite që është kthyer në praktikë, që gjatë vitit buxhetor të bëhen ndryshime në buxhetin e shtetit me akte normative. Do të ishte mirë që ky instrument të përdorej sa më pak, pse jo, të mos përdorej fare. Megjithatë, zhvillimet ekonomike kërkojnë ende një shkallë të caktuar fleksibiliteti të qeverisë në administrimin e financave publike.

Ka disa javë që zëra të ndryshëm diskutojnë në publik, sipas tyre, për një situatë të rëndë të financave publike. Nuk dua të heq vëmendjen e qeverisë ndaj përgjegjësive të saj për administrimin e financave publike, por shumica e

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 4 NËNTOR 2019

këtyre zërave janë përgjegjës direkt të gjendjes rrënuese të financave publike të vitit 2013. Janë të njëjtët persona që në vitin 2014 u kanoseshin shqiptarëve me rrezikun e skenarit grek për kolaps të vendit.

Ndërkohë, ja ku jemi pas 6 vjetësh: financat publike janë më të shëndetshme; borxhi publik kundrejt produktit të brendshëm bruto është ulur; skenari grek nuk u realizua; ekonomia është rimëkëmbur.

Gjithashtu, ka edhe lajme të tjera të mira për shqiptarët, për ekonominë kombëtare, për sipërmarrjen, për familjet shqiptare. Të ardhurat për frymë të shqiptarëve në vitin 2013 ishin 3 325 euro, ndërsa këtë vit janë 4 780 euro. Pra, janë rritur 44 % për 6 vjet.

Po ashtu, është rritur edhe konsumi i familjeve shqiptare. Në vitin 2014 një familje shpenzonte rreth 69 mijë e 440 lekë në muaj, ndërsa në vitin 2018 ka shpenzuar 75 mijë e 935 lekë. Pra, 9,4 % më shumë.

Në vitin 2014 një familje, pjesë e 10 %-shit të familjeve me konsum më të ulët në Shqipëri, ka shpenzuar rreth 30 mijë lekë në muaj, ndërsa në vitin 2018 ka shpenzuar 36 mijë e 975 lekë. Pra, 23 % më shumë. Kjo do të thotë se familjet më të varfra i kanë rritur shpenzimet e konsumit mujor më shumë se mesatarja e vendit.

Në krahasim me vitin 2013 janë punësuar rreth 275 mijë persona më shumë. Në vitin 2013 u angazhuam të punësonim 300 mijë vetë. Nuk e kemi përmbyshur të plotë angazhimin, por e kemi përmbyshur 90 %.

Buxheti i shtetit për vitin 2019 është produkt i politikave të reja të vitit 2019 dhe i politikave të ndërmarra në periudhën 2014–2018.

Do të risjell në vëmendje të publikut disa prej tyre, për t'i ardhur në ndihmë edhe debatit të gjoja “kapjes së maxhorancës nga oligarkët”.

Po e filloj me politikat e periudhës vjetore 2014–2018, pa marr për sipër të jem shterues.

Nëse do të vijonim me politikat e vitit 2013: 12 mijë e 700 infermierë të sektorit publik, me rrogë mesatare mujore aktualisht 500 mijë lekë, do të paguanin 50 mijë lekë në muaj taksë për pagën. Sot, falë taksës së ndershme, paguajnë 26 mijë lekë në muaj, 24 mijë lekë më pak në muaj dhe 290 mijë lekë më pak në vit. Të gjithë bashkë paguajnë këtë vit 3,65 miliardë lekë ose 3,5 milionë dollarë më pak.

Nëse do të vijonim me politikat e vitit 2013: 15 mijë biznese të vogla, me qarkullim vjetor nga 20 deri në 50 milionë lekë në vit, do të paguanin 10 % taksë. Sot paguajnë zero taksë.

Nëse do të vijonim me politikat e vitit 2013: 18 mijë biznese të vogla me qarkullim vjetor nga 50 deri në 80 milionë lekë do të paguanin 10 % taksë. Aktualisht paguajnë gjysmën, 5 %.

Këto 33 mijë biznese paguajnë së bashku 8 miliardë lekë ose 8 milionë dollarë më pak.

Nëse do të vijonim me politikat e vitit 2013, do të taksonim sëmundjen: TVSH 10 % për barnat dhe shërbimet mjekësore. Këtë vit nuk do të shpenzohen 36 miliardë taksë për barnat. Pra, janë 35 milionë dollarë më pak.

Nëse 12 mijë e 700 infermierët, që paguajnë më pak taksa për pagën janë oligarkë, atëherë le të quhemi “maxhorancë në shërbim të oligarkëve”.

Nëse 23 mijë biznese të vogla, që nuk paguajnë taksë apo paguajnë gjysmën e taksave që paguanin në vitin 2013, janë oligarkë, atëherë le të quhemi “maxhorancë në shërbim të oligarkëve”.

Nëse kemi hequr taksën e të gjithë shqiptarëve për sëmundjet, i gjithë populli shqiptar është oligark.

Le të vijojmë me vitin 2019.

Pas 15 vjetësh premtime nga të gjitha qeveritë, përfshirë edhe ato socialiste, nuk paguhet më 20 % TVSH për inputet bujqësore. Pra, janë 8,5 miliardë lekë më pak taksa në arkën e shtetit për vitin 2019. Nëse të gjithë fermerët që blejnë inpute bujqësore pa TVSH janë oligarkë, na quani “maxhorancë e oligarkëve”.

Në arkën e shtetit këtë vit mungojnë taksat nga lojërat e fatit, që do të thotë se janë 42 miliardë lekë më pak të ardhura në buxhetin e shtetit. Nëse do të ishim maxhorancë e oligarkëve, do të vazhdonim të lejonim pasojat shkatërruese të lojërave të fatit në familjet shqiptare.

Me buxhetin e shtetit të vitit 2019, ne financojmë çekun e bebes. Janë 20 miliardë lekë për bebet e lindura në vitin 2019. Nëse janë oligarkë më shumë se 20 mijë familje, që janë shtuar me vajzë apo djalë në vitin 2019, le të quhemi “maxhorancë e oligarkëve”.

Në buxhetin e shtetit të vitit 2019 janë vënë 20 miliardë lekë në dispozicion të institucioneve

të drejtësisë së re, e shumëkërkuar dhe e shumëpritur.

Viti 2019 është viti i parë i prodhimit të energjisë elektrike me burim energjinë diellore. Në 9 muajt e parë të vitit 2019 janë prodhuar rreth 18 gigawatë/orë energji elektrike me burim diellor. OSHEE-ja paguan rreth 600 milionë lekë për çmimin e tregut, për energjinë që blihet nga prodhuesit fotovoltaike. OSHEE-ja ka lidhje me buxhetin e shtetit, sepse dividendi i saj i mundshëm shkon në arkën e shtetit.

Për parantezë: Enti Rregullator i Energjisë cakton çmimin e blerjes nga OSHEE-ja të energjisë elektrike të prodhuesit fotovoltaike apo eloikë. A duhet të jetë kështu? Duhet ta rivlerësojmë këtë kompetencë të ERE-s. Nxitja e prodhimit të energjisë së rinovueshme me mbështetje nga fondet buxhetore duhet të jetë përgjegjësi e plotë e qeverisë.

E bëra këtë parantezë, edhe pse sot nuk e zgjidhim dot këtë çështje, por vitin e ardhshëm do të ketë më shumë prodhues fotovoltaike, kështu që OSHEE-ja do të shpenzojë më shumë se çmimi i tregut.

Pas disa javësh do të fillojmë diskutimet për buxhetin e vitit 2020. Të fokusohemi tek risitë e vitit 2020. Duhet më shumë të drejta universale të financuara me para publike, duhet më shumë nxitje për punësim, duhet më shumë drejtësi fiskale e më shumë drejtësi sociale.

Faleminderit!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Beqaj!

Fjalën e ka zonja Anila Denaj.

Të përgatitet Taulant Balla.

Anila Denaj – I nderuar drejtues i seancës, Të nderuar deputetë,

Duke u nisur nga disa shqetësime dhe kërkesa, mendoj të adresoj disa prej tyre, të cilat lejojnë dhe rezervojnë të drejtën për informacione të detajuara për çdo nevojë që ju keni.

Sigurisht, informacioni për aktin normativ nuk është pronë e Ministrisë së Financave, por është pronë e qytetarëve dhe e deputetëve, të cilët diskutojnë çdo zë të tij në komisionet parlamentare. Mendoj se çdo kërkesë në detaje për uljen e disa zërave në shpenzimet korrente ose kapitale, apo rialokimet, është e hapur për t'u diskutuar në komisione, por, në mungesë të një debati shterues në komisione, nëse ju mendoni se

duhet ta dorëzojmë individualisht, jemi të gatshëm ta bëjmë.

Kjo vjen edhe si pasojë e shqetësimit të deputetes së Komisionit të Ekonomisë, e cila me të drejtë, konstaton se në fjalimin e mbajtur pak më parë u përmend vetëm rritja e të ardhurave në krahasim me vitin 2018 dhe jo krahasuar me buxhetin faktik. Megjithatë, ky fakt është i saktë. Ne sot kemi 3,4 % më shumë të ardhura se vitin e kaluar. Për këtë nuk po gënjej. Sigurisht, ka një minus në raport me faktikun dhe në asnjë vit nuk besoj se parashikimet kanë qenë 100 % të sakta në raport me të ardhurat, për të mos lejuar parashikimet e ndryshimeve të aktit normativ apo rialokimet. Nuk besoj se bëhet për herë të parë një akt normativ.

Gjithashtu, më lejoni të konstatoj se nga një minus prej 7,5 miliardë lekësh në raport me faktikun tek të ardhurat, rreth 6 miliardë lekë vijnë nga efekti i rritjes ekonomike, që unë përmenda në fjalën time, përjashtimi i TVSH-së së inputeve dhe kursi i këmbimit. Të tria këto janë rreth 6 miliardë lekë minus. Kjo nuk do ta cenonte në asnjë mënyrë deficitin buxhetor, i cili është dhe do të mbetet, sipas parashikimeve, 1,9 %. Nuk ka tri shifra. Është vetëm shifra 1,9 %. Për shifrën 1,9%, sido që të jenë të ardhurat në raport me fundin e vitit, ne kemi marrë masat, duke ngrirë projekte për të mos cenuar parametrat makro-ekonomikë fiskalë.

Unë mund t'i bëj referencë buxhetit faktik, parashikimit të të ardhurave të parashikuara dhe të aprovuara më parë, por nuk mund t'u bëj dot dokumenteve të tjera në këtë diskutim.

Është shumë e rëndësishme të flasim për shpenzimet dhe me të drejtë u kërkua se çfarë nënkuptojnë disa nga shpenzimet, të cilat janë në vlerë të përgjithshme, por jo të detajuara.

Më lejoni që si pikë të parë në zërin e shpenzimeve të vendos "Paktin e universitetit". Shpenzimet e realizuara gjatë këtij viti, duke filluar nga fondi rezervë i këtij viti në shumën prej 1,1 miliardë lekë, plus 300 milionë lekë që u morën nga arsimi bazë, financuan një nga zërat më kryesorë për të mbështetur studentët, gjë për të cilën të gjithë jemi koshientë. Gjithashtu, 800 milionë lekë, që i janë shtuar FSHZH-së, kanë shkuar përsëri për të ndihmuar studentët dhe sidomos rinovimin e godinave në Shkodër, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë.

Skema e qumështit

Kjo skemë është e vërtetë dhe unë besoj se, kush shikon faktet dhe shifrat, nuk mendon se me 200 milionë lekë ne do të zgjidhim problemet e fermerëve. Megjithatë, më lejoni që t'u referohem shifrave, të cilat i ka menaxhuar Ministria e Financave dhe Ekonomisë kur vendosi këtë skemë subvencioni.

Më lejoni t'ju kujtoj diskutimin e fillimvitit, por edhe shqetësimet e fermerëve për ndryshimin e skemës së rimbursimit të TVSH-së nga 20% në 6%. Diskutimi i paketës fiskale në fund të vitit të kaluar dhe efektet që dha gjatë këtij viti, sigurisht që krijuan shqetësime te fermerët. Në vijim të mbështetjes së fermerëve, u mendua që i gjithë fondi, i cili vitin e kaluar ishte llogaritur vetëm nga elementi i skemës së TVSH-së, 280 milionë lekë, të kthehej dhe të jepej si një skemë subvencioni për fermerët, ku përfitimi të merrej nga fermerët dhe jo nga agropërpunuesit. 280 milionë lekë ishte shifra e buxhetit të vitit 2018 që u mor për këtë skemë.

Në fakt, jemi të bindur që skema mund të ketë nevoja për më shumë, por kjo tregon nivelin e lartë të informalitetit. Nëse vitin e kaluar në Ministrinë e Financave numri i fermerëve që kanë raportuar për këtë skemë jombështetëse ishte i lartë, rimbursimi i TVSH-së për të shkoi në vlerën 280 milionë, atëherë hajdeni të shikojmë se si mund ta zgjidhim problemin e informalitetit në bujqësi, para se të vendosim nëse kjo skemë është e pamjaftueshme, sigurisht, për ta mbështetur dhe për ta rritur në vijim.

Rialokimi në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ky rialokim është i brendshëm, ashtu sikurse bëhet çdo vit. Kalimi nga projektet me avancime të ngadalta tek ato me avancime më të shpejta kanë mundësuar përfitueshmërinë e rialokimit të buxhetit. 50% e projektit të bajpasit të Fierit, që përfundoi këtë vit, i cili u përmend pak më parë edhe nga kolegu deputet, krijoi një lehtësi në qarkullim dhe 50%-shi tjetër i mbetur për vitin e ardhshëm nënkupton se ky projekt po avancon shumë mirë, i cili, sigurisht, do të marrë mbështetje maksimale, sikurse është edhe shtimi për kompensimet e shpronësimeve, të cilat menaxhohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Pensionet

Besoj se të gjithë jemi koshientë që pensionet këtë vit, me VKM-në e marrë në muajin mars, janë rritur me 2,8% me një fond

prej 45 miliardë lekësh. Ajo që referohet edhe në kërkesën e Komisionit të Ekonomisë, të cilën unë e kam raportuar dhe jemi duke e analizuar, por ende nuk kemi dhënë një përgjigje shteruese, është elementi i bonusit, i cili është diskutuar edhe në VKM-në e dhjetorit. Sigurisht, shpresoj që të arrijmë të njëjtin përfundim edhe këtë vit, në mënyrë që të shikojmë avancimet dhe zhvillimet e projekteve deri në fund të vitit. Kështu që këtë përgjigje shteruese për rritjen dhe dhënien e bonuseve besoj se do ta kemi në Komisionin e Ekonomisë, ashtu sikurse është kërkuar.

Problemi me detyrimet e ISSH-së

Unë jam e gatshme edhe për interpelancë, kurdo që të jetë e nevojshme, sikurse jam edhe për të gjitha diskutimet që Ministria e Financave dhe Ekonomisë është duke realizuar. Ne duhet t'i eliminojmë të gjitha informacionet keqinformuese.

Së pari, detyrimet datojnë nga viti 2000, pra nuk datojnë sot, dhe është shumë e rëndësishme që ta theksojmë këtë. Ky është një problem dhe një gangrenë e ekonomisë, njëkohësisht edhe e institucioneve, të cilat në mënyrë rigorozë duhet të zbatojnë ligjin, duke mos lejuar të ketë detyrime si në raport me tatimet, ashtu edhe me pensionet. Megjithatë, këto janë detyrime, të cilat për ndërmarrjet buxhetore janë adresuar nëpërmjet ndryshimit të udhëzimit në Drejtorinë e Thesarit. Çdo buxhet shtesë i pushtetit vendor, qoftë edhe nga ky rialokim, që është bërë me fondin e AN-së, do të shkojë, në radhë të parë, për të paguar detyrimet e prapambetura përtej pagesave dhe projekteve të reja.

Ndërkohë, ndaj të gjitha këtyre institucioneve, që nuk kanë zbatuar ligjin dhe që janë në shkelje të plotë të detyrimeve ndaj punonjësve të tyre, njëkohësisht dhe çuditërisht, janë të njëjtat subjekte me problematika dhe me detyrime të tjera ndaj shtetit, do të merren masa, ashtu sikurse edhe ndaj punonjësve, të cilët kanë lejuar këto akumulime detyrimesh prej vitit 2000.

Bashkia e Tiranës.

Po, është një financim me ndihmë të huaj dhe jo nga buxheti i brendshëm. Kështu, në momentin kur ky informacion do të vijë më i detajuar për çdo zë, qoftë me financim të brendshëm, qoftë financim të huaj, ne do të jemi të qartë për palët.

Së fundi, më lejoni të përmend vetëm elementin e pushtetit vendor në raport me elementin e detyrimeve.

Pushteti vendor ka një rritje të konsiderueshme të të ardhurave dhe kjo shpreh qartë edhe politikën, të cilat kanë rezultuar efektive dhe kanë ndikuar në dhënien e një pavarësie në menaxhimin e pushtetit vendor. Sigurisht, kurdo që të hapen, buxhetet do të bëhen publike dhe me objektiv të qartë: pagesën e detyrimeve të prapambetura, para çdo projekti tjetër që do të nisnin bashkitë.

Faleminderit!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zonja Denaj!

Fjalën e ka deputeti Taulant Balla.

Taulant Balla – Faleminderit, zoti Nënkrjetar!

Në fakt, nisur edhe nga disa reagime të deputetëve të opozitës lidhur me aktin normativ për buxhetin, dua ta them që rishikimi i buxhetit është një politikë e konfirmimit të stabilitetit financiar dhe buxhetor të vendit.

Në shumë vende, edhe në ato me ekonomi tepër të zhvilluar, gjithmonë qeveria vendos që në pjesën e dytë të vitit të bëjë një akt normativ apo të rishikojë buxhetin, me qëllim rialokimin e të ardhurave që burojnë nga miradministrimi fiskal.

Pa dyshim, ky akt normativ ka tri veçori kryesore, për të cilat unë, si kryetar i grupit të shumicës, dua ta falënderoj publikisht qeverinë për shkak se nuk ka ndryshime në të ardhura, nuk prek shpenzimet e përgjithshme të buxhetit dhe, pa dyshim, nuk prek as deficitin. Këta janë tre indikatorët kryesorë të gjithkujt që bën një analizë pa anësime politike. Pra, jemi në kushtet ku niveli i deficitit buxhetor mbetet aq sa ishte parashikuar në fillim të vitit.

Ju nuk keni qenë këtu në këtë sallë, por ata që ishin para jush kanë bërë turr dhe kanë qarë me arsyetimin se buxheti i vitit 2019 do të ishte një buxhet që do ta thellonte deficitin. Kjo nuk ka ndodhur aspak, pasi deficitin buxhetor është 1,9% e prodhimit të brendshëm bruto. Krahasuar me të gjitha vendet rajonit ky është deficitin më stabil.

Po kështu, borxhi publik qëndron në kufijtë e parashikuar të fillimvitit, 65,5% të prodhimit të brendshëm bruto.

Së treti, bilanci fiskal vijon të jetë një tregues pozitiv me suficit, siç ka ndodhur prej

vitit 2016, ku, për herë të parë pas 20 vjetësh, ky tregues u kthye nga negativ në pozitiv. Kjo është arsyeja pse ne kemi sot një akt normativ, i cili na lejon të mundësojmë një mbështetje më të madhe për pushtetin vendor, sepse nëpërmjet këtij akti normativ rritim financimin me 4 miliardë lekë për pushtetin vendor.

Duhet ta themi se, pas zgjedhjeve të 30 qershorit, në të gjithë territorin ka një miradministrim të të ardhurave në pushtetin vendor.

Në 9-mujorin e parë të këtij viti, i cili është treguesi i parë, kemi një rritje me 2,5 miliardë lekë ose 15 pikë përqindje në krahasim me planin e parashikuar.

Rritja e financimit të pushtetit vendor do të sigurohet nga rritja e të ardhurave të tij me 3 miliardë lekë dhe rritja e financimit të huaj vendor me 1 miliard lekë.

Kush ishte skeptik për 30 qershorin, besoj se edhe në kontekstin e të dhënave financiare në të gjitha 60 bashkitë e vendit tregohet se ka një miradministrim të pushtetit vendor.

Arsyeja tjetër e rëndësishë që ka ky akt lidhet me financimin e fondit rezervë të buxhetit të shtetit, i cili rritet me 450 milionë lekë. Pa dyshim, kjo masë siguron financimin e përballimit të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 21 shtator 2019.

Besoj se biem të gjithë dakord, t'i lemë mënjane tesaerë e partive që janë në këtë sallë, që kjo qeveri ka miradministruar si rrallë ndonjëherë një fatkeqësi natyrore, nga më të mëdhatë që kanë goditur vendin dhe, pa dyshim, vjen sot për të kërkuar edhe votën tuaj për të mbështetur të gjitha familjet që janë dëmtuar nga tërmeti.

Së katërti, sigurohet akomodimi i nevojave të reja të funksionimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, pra të vetëqendrës, si nga pikëpamja e shpenzimeve, ashtu edhe nga numri i punonjësve.

Kemi pasur një kërkesë të vazhdueshme nga të dyja komisionet e vetëqendrës për t'i rritur kapacitetet e tyre administrative, e cila impaktin e drejtpërdrejtë e ka në përsheptimin apo rritjen e numrit të gjyqtarëve apo të prokurorëve që kalojë përmes vetëqendrës.

Nuk besoj se mund të ketë një deputet në këtë sallë që të mos e vlerësojë faktin, ashtu siç vlerësohet nga të gjithë partnerët e Shqipërisë, që

procesi i vettingut po ecën në një mënyrë të shkëlqyer, ku nga 190 prokurorë e gjyqtarë që kanë kaluar deri më sot, afro gjysma e tyre nuk e kanë kaluar këtë proces. Kjo tregon se sa e thellë paska qenë kriza e sistemit të vjetër të drejtësisë, mungesa e pastërtisë së figurës, si dhe mungesa e transparencës së të ardhurave. Pa dyshim, ka edhe shumë raste, në të cilat KPK-ja apo KPA-ja kanë konsideruar se prokurori apo gjyqtari nuk ka për gatitjen profesionale të nevojshme për të vënë drejtësi në këtë vend.

Kush u mundua të pengonte reformën në drejtësi, e ka marrë sot mesazhin e qartë nga suksesi i këtij procesi, i cili, pa dyshim, është vetëm në fillimin e tij. Dua ta ritheksoj: ka ende prokurorë e gjyqtarë, të cilët e dinë fare mirë se nuk e kalojnë procesin e vettingut, por janë bërë pjesë e asaj bande të papranueshme “kçk”, për të cilën duhet gjetur mekanizmi për ta parandaluar.

Procesi i vettingut është garancia që Shqipëria europiane është në drejtimin e duhur për sa i përket ndërtimit të një sistemi drejtësie tërësisht të pavarur. Ne i kemi në proces në Kuvendin e Shqipërisë kandidaturat që i takojnë Kuvendit për Gjykatën Kushtetuese.

Komisioni i Çështjeve Ligjore po bën një procedurë, siç e përcakton Kushtetuta dhe, brenda afatit 30-ditor që ka Kuvendi, pa dyshim do ta ezaurojë të drejtën për të zgjedhur 1/3-ën e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Besoj se përpara Krishtlindjes Kuvendi do t'i plotësojë tri vendet që i takojnë, sikurse edhe Presidenti i Republikës duhet të veprojë sipas Kushtetutës dhe brenda afateve të përcaktuara.

Së pesti, midis zërave të shpenzimeve korrente janë bërë edhe disa rialokime të tjera: në Ministrinë e Brendshme rriten shpenzimet me 450 milionë lekë për pagesat e orëve jashtë orarit të efektivëve të Policisë së Shtetit, për ushqimin dhe orët e punës së Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë dhe kursantëve, si dhe 30 milionë lekë të rinj për pagat në gjendjen civile; në Ministrinë e Mbrojtjes rriten shpenzimet me 120 milionë lekë për mirëmbajtjen e sistemit Palantir dhe 330 milionë lekë për misionet jashtë vendit, ku duhet ta them se Shqipëria sot është jo vetëm një vend që eksporton stabilitet në rajon, por është edhe një vend që kontribuon, brenda forcave dhe kapaciteteve të veta, në vendet në konflikt në bashkëveprim të plotë me vendet e tjera anëtare të NATO-s, por, pa dyshim, edhe në atë që ne e

përmendim gjithmonë, në kuadër të njësimi 100% të politikës sonë të jashtme me atë të Bashkimit Europian.

Për sa u përket rialokimeve, besoj se edhe ju, kolegë të opozitës, duhet të jeni dakord që Ministrisë së Shëndetësisë t'i japim 300 milionë lekë të rinj për mbështetjen e skemës së paaftësisë së kufizuar, si kompensim i financimit të Paktit për Universitetin, i dakordësuar që në janar të vitit 2019.

Ndërkohë, në Ministrinë e Arsimit të rritim shpenzimet me 300 milionë lekë për financimin e arsimit bazë, si kompensim i financimit të Paktit për Universitetin, edhe kjo e dakordësuar në muajin janar të vitit 2019. Këto janë ndryshimet bazë të këtij akti normativ.

Lërimi mënjane partitë, por mbështesni qeverinë për këtë akt të rëndësishëm të rishikimit të buxhetit, me qëllim rialokimin e shpenzimeve aty ku kanë nevojë qytetarët.

Ralf, na kanë sjellë qytetarët këtu, jo partitë...

(Bie gongu)

Myslim Murrizi- Faleminderit, zoti Balla!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka deputetja Antoneta Dhima.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, zonja Dhima!

Për replikë, fjalën e ka zoti Gjoni, 2 minuta.

Ralf Gjoni - Faleminderit, zoti drejtues i seancës!

Zoti Balla, është e vërtetë që na kanë sjellë partitë në këtë parlament, por jo të gjithë komandohemi nga partitë. Për herë të parë në historinë e parlamentit shqiptar keni një grup opozitar deputetësh të pavarur, secili në pavarësinë e tij individuale, të cilët nuk marrin më urdhra nga partitë. Nëse ju si kryetar i grupit të Partisë Socialiste e shihni veten në cilësinë e një kontrolluesi të të drejtës së votës dhe orientimit të votës së deputetëve të caktuar në këtë parlament, qoftë të grupit tuaj, qoftë të anës tjetër, nga opozita, nuk habitem aspak, sepse kjo është tradita e partisë suaj, por unë ju siguroj, zoti Balla, se pavarësia e votimit dhe e gjykimit të deputetëve, ose të një grupi dërmues të deputetëve të opozitës, nuk është e ngacmuar nga asnjë linjë partiake, nga asnjë linjë bajraktarike dhe aspak nga Partia Socialiste.

Për sa u përket, nëse më lejohet, anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, zoti Balla, ju thatë se

Kuvendi po kryen detyrimet e tij brenda përcaktimeve kushtetuese për dëgjimin dhe për votimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Unë jam dakord, le të bëhet sa më shpejt, por, ju lutem, zoti Balla, në mbledhjet e Komisionit të Ligjeve të ketë më shumë integritet nga ana e deputetëve të Partisë Socialiste për sa i përket vetimit dhe dëgjimit që u bëhet këtyre kandidatëve për Gjykatë Kushtetuese. Ju kujtoj se 3 nga kandidatët, që erdhën para Komisionit të Ligjeve, nuk kanë marrë pikët e nevojshme për testin *Scantron*, i cili përdoret për hyrjen në Shkollën e Magjistraturës. Është e vërtetë që ata kanë kaluar vetingun, por këtu bëhet fjalë për një pikëpyetje të madhe sa u përket aftësive profesionale të atyre kandidatëve, që hyjnë në organet e reja të drejtësisë së re të reformuar. Kështu që, ndaloni ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë...

(Bie gongu)

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Gjoni!

Fjalën e ka deputetja Antoneta Dhima.

Antoneta Dhima – I nderuar zoti drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Të dashur qytetarë,

Rishikimi i buxhetit tashmë është një praktikë e konsoliduar ndër vite dhe një instrument ligjor, i cili mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, në disa vendime të Gjykatës Kushtetuese, si dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Nevoja, urgjenca dhe përkohshmëria e masave të propozuara janë kriteret kryesore për nxjerrjen e aktit normativ të ndryshimeve në buxhetin e vitit 2019, kriteret të cilat janë respektuar nga ana e qeverisë. Ndryshimet buxhetore të propozuara janë të nevojshme dhe urgjente, pasi krijojnë mundësinë për realizimin e disa programeve të rëndësishme ekonomike dhe sociale, duke respektuar afatet dhe procedurat për kryerjen e prokurimeve publike.

Për sa i përket përkohshmërisë së masave të propozuara, theksoj se ajo është e argumentuar me faktin se akti normativ merr fuqi brenda 45 ditëve nga miratimi i tij.

Ekonomia shqiptare gjatë 9-mujorit të vitit 2019 ka vijuar të zhvillohet me ritme pozitive

dhe kjo ka ardhur si rezultat i shfrytëzimit të plotë të kapaciteteve prodhuese, rritjes së punësimit, të pagave, si dhe përsheptimit të kreditimit të ekonomisë. Nëse do t’u referohemi statistikave të publikuara nga INSTAT-i, prodhimi i brendshëm bruto në tremujorin e parë dhe të dytë u rrit respektivisht me 2,4 dhe 2,3 %, duke theksuar se ndikim kryesor në këtë rritje ka dhënë zgjerimi i aktivitetit në sektorët e shërbimeve dhe bujqësisë. Sipas të dhënave paraprake, edhe për 3-mujorin e tretë parashikohet një ecuri e ngjashme.

Me të gjitha ritmet pozitive të ekonomisë shqiptare, gjatë 6-mujorit të parë ka pasur një rënie të ritmit të rritjes ekonomike, kryesisht për shkak të reduktimit të prodhimit të energjisë elektrike si pasojë e kushteve atmosferike, përfundimit të projekteve të mëdha energjetike, si dhe mbylljes së aktivitetit të shumë subjekteve të lojërave të fatit.

Tregjet financiare vijojnë të karakterizohen nga norma të ulëta interesi, situatë e mirë likuiditeti, qëndrueshmëri e kursit të këmbimit, trend në rritje i kreditimit dhe rënie e nivelit të kredive me probleme. Parashikimet për periudhën afatmesme janë që goditjet e ofertës të zbehen dhe rritja ekonomike të përsheptohet.

Për periudhën 9-mujore të ardhurat e përgjithshme të buxhetit janë realizuar në shumën 344 miliardë lekë, duke sjellë një realizim të planit në masën 98 %. Ndikim pozitiv në këto të ardhura ka dhënë rritja e të ardhurave tatimore me mbi 14 miliardë lekë ose 4,6 % në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Kjo rritje e të ardhurave tatimore ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së të ardhurave nga tatimet dhe doganat, të ardhurave nga pushteti vendor dhe të ardhurave nga fondet speciale. Nëse do t’u referohemi shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit për 9-mujorin 2019, ato janë realizuar me rreth 345,8 miliardë lekë, duke sjellë një realizim të planit në masën 96 %. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, shpenzimet e përgjithshme janë rritur me 19,8 miliardë lekë ose 6,1 %.

Ajo që dua të theksoj është fakti se akti normativ synon të pasqyrojë ndryshimet e ndodhura në ekonominë shqiptare për periudhën 9-mujore të vitit 2019, si dhe pritshmëritë për realizimin e treguesve kryesorë makroekonomikë e buxhetorë deri në fund të vitit 2019.

Nevoja dhe domosdoshmëria për rishikimin e buxhetit për vitin 2019 lindi për disa arsye: për të siguruar kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në disa njësi të qeverisjes vendore; për të rishpërndarë fondet për investime nga projekte me ecuri të ngadaltë drejt projekteve me ecuri më të mirë; për financimin e zërave të shpenzimeve buxhetore të Paktit për Universitetin; për të reflektuar ecurinë pozitive të të ardhurave të realizuara nga pushteti vendor dhe për një rishpërndarje të fondeve ndërmjet ministrive dhe institucioneve buxhetore, me qëllimin e vetëm realizimin e disa objektivave specifike, si: rritja e mbështetjes për fermerët, shtresat sociale në nevojë, arsimin e lartë, rendin, mbrojtjen dhe sektorë të tjerë të ekonomisë.

Me ndryshimet e parashikuara në aktin normativ të buxhetit për vitin 2019, së pari, do të ruhen të pandryshuar parametrat kryesorë të buxhetit, të cilët janë miratuar në fillim të vitit ose në buxhetin e vitit 2019, duke vijuar me qëndrueshmërinë e financave publike. Akti normativ nuk parashikon ndryshime në të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në deficitin buxhetor, në borxhin publik, si dhe në bilancin primar fiskal, i cili do të vijojë të jetë një tregues pozitiv.

Së dyti, do të mundësohet një mbështetje më e madhe për pushtetin vendor, duke e rritur financimin e tij me 4 miliardë lekë. Kjo për shkak të administrimit të mirë të të ardhurave nga pushteti vendor.

Së treti, do të sigurohet financimi i fondit rezervë të buxhetit të shtetit, i cili rritet me 450 milionë lekë, masë që synon të sigurojë financimin e nevojshëm për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti.

Së katërti, do të sigurohet akomodimi i nevojave të reja të funksionimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, si nga pikëpamja e shpenzimeve, ashtu edhe nga pikëpamja e burimeve njerëzore.

Së pesti, do të bëhen disa rialokime të tjera midis zërave të shpenzimeve korrente, të cilat bazohen në ecurinë e 9-mujorit dhe synojnë rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit nga ministrinë dhe institucionet publike, rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, si dhe reduktimin e detyrimeve të prapambetura. Nëpërmjet ndryshimeve të zërave të shpenzimeve korrente do të rriten shpenzimet

dhe do të mbështeten kryesisht Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Bujqësisë.

Së gjashti, do të rritet performanca e shpenzimeve kapitale, duke rishpërndarë fondet drejt projekteve të investimeve, që kanë pasur ecuri të mirë të punimeve deri tani. Lëvizja e këtyre fondeve do të bëhet kryesisht në Autoritetin Rrugor Shqiptar; Fondin Shqiptar të Zhvillimit; Ministrinë e Kulturës; Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; Ministrinë e Shëndetësisë dhe Bashkinë e Tiranës.

Gjatë diskutimeve në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave u dhanë disa mendime e sugjerime, si dhe u arritën disa konkluzione për aktin normativ të buxhetit 2019.

Së pari, ndryshimi i buxhetit të vitit 2019 me këtë akt normativ është me rëndësi të veçantë, por pa ndryshuar treguesit kryesorë makroekonomikë, të parashikuar në fillim të vitit, mundëson rritjen e financimit ndaj pushtetit vendor, përballimin e situatave emergjente, rritjen e eficiencës së përdorimit të fondeve publike dhe rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit. Këto ndryshime do të krijojnë mundësinë për reduktimin e detyrimeve të prapambetura nga ministrinë dhe institucionet publike.

Së dyti, Komisioni sugjeroi që për periudhën e mbetur të vitit strukturat ekzekutive të rritin më tej përpjekjet në drejtim të përmirësimit të administrimit fiskal, realizimit të detyrimeve kontraktore të projekteve të investimeve publike, thellimit të reformave strukturore, si dhe objektivave të tjera afatmesme për të arritur rezultatet e parashikuara në treguesit makroekonomikë e fiskalë të vendit.

Së treti, prioritet për periudhën e mbetur të vitit duhet të jetë edhe respektimi i detyrimeve kontraktore në fushën e investimeve publike nga të gjitha njësitë buxhetore.

Së katërti, duhet të përshpejtohen procedurat për kryerjen e reformës së fiskalizimit, duke filluar nga dërgimi në Kuvend, miratimi i projektvendimeve dhe projektligjeve për këtë çështje dhe duke vijuar me aktet nënligjore dhe zbatimin me korrektësi të kuadrit ligjor dhe nënligjor.

Së pesti, Komisioni ritheksoi, gjithashtu, kërkesën e tij të mëparshme drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila duhet të analizojë treguesit e pritshëm të buxhetit për vitin 2019 dhe të parashikojë një bonus për shpërblimin e pensionistëve dhe shtresave të tjera në nevojë për festat e fundvitit, shpërblim të cilin prej disa vitesh e kemi zbatuar dhe premtuar në fushata elektorale.

Së gjashti, analiza dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura për pjesën e mbetur të vitit 2019 mbetet një detyrë tjetër për t'u ndjekur dhe realizuar nga të gjitha strukturat buxhetore.

Në kushtet kur akti normativ që ne po diskutojmë sot nuk parashikon ndryshime të të ardhurave e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit dhe mban të pandryshuar treguesit kryesorë të buxhetit, të cilët i kemi miratuar në fillim të vitit, duke vijuar me një qëndrueshmëri financiare publike, të nderuar kolegë dhe kolege deputete, ju ftoj ta miratojmë atë!

Faleminderit!

(Drejtimitin e seancës e merr zoti Gramoz Ruçi.)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Dhima!

Këtu përfundon edhe debati për aktin normativ nr. 2, datë 02.10.2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”.

Kalojmë tek akti normativ nr.3, datë 02.10.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.12.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”.

Zonja Ministre e Financave, a keni dëshirë të flisni përpara se të fillojë debati?

Urdhëroni, fjala për ju!

Anila Denaj – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë dhe qytetarë,

Tërmeti i 21 shtatorit të vitit 2019 dhe tërmetet pasues patën ndikim në një numër të konsiderueshëm banesash në vend. Edhe në rastet e mëparshme tërmetet kanë pasur ndikim në zonat e banuara, duke shkaktuar dëmtime të natyrave të ndryshme në godina dhe shtëpi.

Duke vlerësuar situatën e ndikimit të tërmetit të muajit shtator, kohën e pamjaftueshme për rregullime ligjore sipas procesit legjislativ dhe nevojën e menjëhershme

për ndërtimin dhe për riparimin e ndërtesave të dëmtuara, Ministria e Financave dhe Ekonomisë propozoi nxjerrjen e një akti administrativ me efekt në procesin dhe koston e rikonstruksionit të banesave të dëmtuara.

Qëllimi i këtij akti normativ është përjashtimi nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë të investimeve të reja për banesat e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore. Në vijim po ndaj me ju ndryshimet kryesore që pëson ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Akti normativ parashikon shtimin e pikës 9 te neni 27, pra përjashtimin nga taksë e ndikimit në infrastrukturë të të gjitha investimeve të destinuara për rindërtim, riparim apo restaurim të ndërtesave të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore, si: tërmetet, zjarret e të tjera të ngjashme me to, të cilat janë vlerësuar nga komisionet e posaçme të ngritura për këtë qëllim.

Kushtet, rregullat dhe dokumentet, që e shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, në mënyrë specifike, nëpërmjet një dispozite kalimtare, është parashikuar të trajtohen si raste përjashtimi nga pagesat e kësaj takse të gjitha investimet e destinuara për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të dëmtuara nga tërmeti i shtatorit të vitit 2019.

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë vlerëson reagimin e shpejtë të qeverisë, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për të reduktuar ndikimin e fatkeqësive natyrore në familjet e qytetarëve shqiptarë. Për këtë arsye gjykoj se miratimi i këtij akti normativ është thelbësor dhe i domosdoshëm.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Janë regjistruar zoti Myslim Murrizi dhe zonja Evis Kushi.

Fjala për zotin Murrizi.

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Me aq sa po shikoj, ky është një ligj me dy nene, që heq taksën e ndikimit në infrastrukturë për banesat e dëmtuara nga tërmeti, të cilat do të bëhen të reja. Dua që t'ju korrigjoj, sepse thatë

“nga tërmeti i 21 shatorit”, ndërkohë që ditët e fundit ka pasur tërmet tjetër. Hiqini fjalët “tërmetin e 21 shtatorit” dhe thoni: “nga të gjitha tërmetet, përveç “tërmetit të Damianit”.

Së dyti, numri i banesave të dëmtuara plotësisht, të cilat do të bëhen të reja, do të ishte më e udhës që të ishte ekzakt, pra sa do të bëhen të reja dhe sa nga do të pësojnë rikonstrukcion. Nga 61 bashkitë që ka vendi, cilat janë ato që preken nga heqja e kësaj takse dhe çfarë do të bëhet për t’i mbuluar? Inshalla këta, që tremben kollaj nga tërmeti, nuk spekulojnë me ndërtuesit që bëjnë vila. 4 milionë shqiptarë u tremben nga tërmeti, Taulant, por vetëm njëri deri tani ka gjetur zgjidhjen perfekte: iku nga pallati i krisur dhe shkoi te vilat. Inshalla nuk hiqet taksa për vilat e oligarkëve, sepse pastaj do të bëhet vesi i keq dhe pak banorë të kësaj sale do të kenë hyrje në pallat; pra, do të degdisen të gjithë te vilat mbrapa TEG-ut.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Në emër të grupit, fjalën e ka zonja Kushi.

Evis Kushi – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Një qeveri e përgjegjshme duhet të reflektojë gjithmonë pas një fatkeqësie natyrore. Kjo nuk nënkupton vetëm adresimin e menjëhershëm të pasojave apo menaxhimin e ndihmave për komunitetet, por nënkupton edhe marrjen e masave për të ardhmen, pra si të parandalohen apo si të minimizohen pasojat në ndonjë rast tjetër të mundshëm fatkeqësie natyrore.

Një rast i tillë ishte edhe tërmeti i fuqishëm i datës 21 shtator 2019, i cili shkaktoi dëmtime të shumta në banesa, duke i kthyer në të pabanueshme shumë prej tyre, kryesisht në Durrës, Tiranë, por edhe në Elbasan.

Në këto kushte, ndërhyrja e shtetit për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve të prekur, me strehim, ushqime, shërbime spitalore apo ndihma të ndryshme ishte e menjëhershme. Por nuk dua të zgjatem në këtë pikë, sepse situatën e analizuam në një seancë të posaçme parlamentare.

Ajo ku dua të ndalem lidhet me nevojën për pajisjen e menjëhershme me leje ndërtimi dhe fillimin e punës për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e të gjitha banesave të dëmtuara.

Bëhet fjalë realisht për një situatë emergjente, pasi nevojitet që, sa më shpejt të jetë mundur, të gjithë banorët e prekur nga këto dëmtime të sistemohen në banesa në kushte normale jetese, aq më tepër që dimri është afër dhe ndërhyrja duhet të jetë sa më e shpejtë. Pikërisht për këtë qëllim, në datën 2 tetor qeveria solli për miratim në Kuvend një akt normativ, i cili ka si qëllim përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore.

Kështu, pra, ky akt normativ u vjen në ndihmë jo vetëm familjeve të dëmtuara nga tërmeti i datës 21, të cilat janë vlerësuar dhe janë identifikuar si të tilla nga organet e vetëqeverisjes vendore, por ka përcaktuar dhe ka mundësuar zgjidhjen e përhershme të rasteve të ngjashme që mund të ndodhin në të ardhmen.

Zgjidhja që qeveria i dha kësaj situatë me anë të aktit normativ ka shkurtuar ndjeshëm kohën e ndërhyrjes dhe marrjen e masave nga bashkitë për të proceduar me eliminimin e pasojave.

Në rast se nisma do të paraqitej në rrugë normale, si një projektligj i propozuar nga Këshilli i Ministrave, koha në dispozicion për të gjitha procedurat dhe hyrjen në fuqi, siç parashikohen në Kushtetutë, do të shkaktonin shumë vonesa për qytetarët.

Kujtoj, gjithashtu, që efektet financiare nga zbatimi i këtij akti normativ do të përfshihen në programin e miratuar të buxhetit për institucionet qendrore e vendore. Kujtoj, gjithashtu, edhe një herë, se është përgjegjësi e pushtetit vendor dhe e komisioneve të vlerësimit që, sipas akteve ligjore apo nënligjore në fuqi, të tregojë përgjegjshmëri, integritet dhe profesionalizëm në hartimin e listave apo në vlerësimin real të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 21, por edhe nga çdo lloj fatkeqësie tjetër natyrore.

Si përfundim, duke vlerësuar se miratimi i këtij akti normativ ishte nevojë dhe urgjencë e qeverisë për të reaguar pas rasteve të një fatkeqësie natyrore, siç ishte tërmeti i para pak javëve, kam besimin se të gjithë deputetët e Kuvendit, të majte apo të djathtë, do ta votojmë unanimisht atë.

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Kushi!

Këtu përfundon debati për aktin normativ nr. 3.

Kalojmë te projektligji “Për rininë”. A është prezente ministrja e Arsimit?

Janë regjistruar për diskutim deputetët: Vilma Bello, Florenc Spaho, Adelina Rista, Artemis Dralo, Almira Xhembulla, Rudina Hajdari, Myslim Murrizi, Halil Jakimi, Halit Valteri, Fatjona Dhimitri, Arlind Çarçani, Korab Lita, Arben Elezi, Elda Hoti, Nimet Musaj, Ralf Gjoni, Kostaq Papa, Zef Shtjefni dhe Artur Roshi.

Fjalën e ka zonja Rudina Hajdari.

Të përgatitet Vilma Bello.

Rudina Hajdari – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë, në veçanti të dashur studentë apo të rinj që po na ndiqni sot,

Siç e shikoni, zonja ministre e Arsimit nuk ndodhet sot në sallë për të na e prezantuar këtë projektligj. Pra, është fare e qartë se çfarë rëndësie ka ky projektligj për qeverinë sot. Gjithsesi, ata e prezantuan sot në seancë plenare. Shumë prej të rinjve ndoshta as nuk e dinë këtë fakt dhe jam e sigurt që nuk po e ndjekin seancën plenare, dhe nuk ju vë faj për këtë.

Të dashur të rinj dhe studentë, kabineti qeveritar ka propozuar një projektligj për rininë, që është tërësisht i pambështetur nga ju. Madje, mendoj se shumë prej jush nuk kanë nevojë për një projektligj të tillë, sepse ju nuk jeni një shtresë e marginalizuar që ka nevojë për një projektligj të veçantë. Ju keni nevojë për mbështetje, keni nevojë për një parlament, i cili me vullnetin e tij sjell risi, ju mbështet, nxit punësimin për rininë dhe ndërmerr shumë iniciativa të tjera që ju ndihmojnë konkretisht. Ministria përkatëse është munduar ta përdorë këtë projektligj si një lloj propagande të radhës për t’ju joshur me një gjë bosh.

Do të flas për këtë projektligj, sepse dua të respektoj procedurën dhe dua të ndaj me ju disa nga problematikat për ata që kanë dyshime për këtë projektligj. Dua t’ju them, e para, se ky projektligj ka ndoshta dy vjet që sorollatet nëpër korridoret e komisioneve për shkak të një lufte ndërmjet disa deputetëve dhe ministrisë përkatëse se cili do ta marrë stafetën e propozimit të tij. Normalisht, kjo e fundit me mënyra bllokuese jo vetëm e ka përvetësuar, por

nuk ka marrë parasysh asnjë nga propozimet e deputetëve, duke përfshirë këtu edhe sugjerimet që kanë ardhur nga shoqëria civile apo grupet rinore për këtë çështje.

Por problematika nuk qëndron vetëm këtu, ajo qëndron te fakti se ky projektligj nuk ka zbatueshmëri, pasi është formuluar keq. Fjala “diasporë” përmendet vetëm një herë, edhe pse ky projektligj synon të kujdeset edhe për të rinjtë e diasporës, por nuk shkruhet asnjë rresht se si do të ndodhë kjo.

Ministra e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dikton tërësisht menaxhimin e buxhetit dhe synon që të ngrejë disa struktura pranë bashkive që nuk sjellin asnjë risi apo përfitime konkrete për rininë. Gjithashtu, ky projektligj nuk është i bazuar në një praktikë të mirëfilltë ndërkombëtare. Në disa nga vendet, si në Letoni, në Bullgari, në Serbi apo edhe në Kosovë, që e kanë një projektligj të tillë për rininë, ka rezultuar i pasuksesshëm.

Çdo analizë, që mund t’i bëhet këtij projektligji, të sjell në një konkluzion: ky është dështimi i radhës i kabinetit qeveritar, të cilit i mungojnë idetë dhe vullneti për të bërë diçka që vërtet u shërben të rinjve dhe jo të propozojë një projektligj të radhës që nuk gjen as zbatim, por as edhe mbështetje nga të rinjtë.

Por, të dashur studentë, çfarë prisni nga një Kryeministër që ju keqtrajton me sjelljen e tij vulgare? Çfarë prisni nga një Kryeministër që nuk mban asnjë lloj përgjegjësie për ju?

Kush e ka fajin për këtë? Kush e ka fajin për këtë dërxhe, ku ne ndodhemi sot? Kush e ka fajin që ju nuk jeni më në prioritetet e tyre? Jetoni në një ambient, ku nuk ka kujdes ndaj kësaj shtrese të shoqërisë. Ju, të dashur të rinj, përbëni 30% të kësaj popullsie dhe nuk jeni një shtresë e marginalizuar. Juve sot ju jepet një projektligj për rininë, i cili nuk gjen absolutisht asnjë lloj zbatueshmërie, se nuk është për ju. Por le të ndalemi pak në ambientin tonë të dashur, se çfarë po ndodh jashtë kësaj salle.

Kush e ka fajin sot që një prokuror qëllohet në mes të rrugës me kallashnikov? Kush e ka fajin që një grua gjyqtare (mos e harroni) u vra në mes të rrugës nga burri i saj, edhe kur kërkoi të mbrohej nga ligji? Kush e ka fajin që sot niveli i dhunës dhe i krimit familjar është më i lartë se kurrë në këta 20 vjetët e fundit? Kush, ma thoni ju, e ka fajin që sot reforma në drejtësi ka hequr

nga sistemi më shumë se gjysmën e prokurorëve dhe të gjyqtarëve? Kush e ka fajin pse sot asnjë nga ju nuk ka besim tek organet e drejtësisë? Kush e ka fajin që korrupsioni dhe krimi i organizuar po lulëzojnë në nivelet më të frikshme dhe po kontrollojnë sot politikën e vendit? Kush e ka fajin që sot kemi ende persona të lidhur me botën e krimit, që kanë mbështetjen për t'u futur si në parlament, ashtu edhe në zyrat e bashkive? Kush e ka fajin që sot krimi i organizuar me origjinë shqiptare, trafikimi i lëndëve narkotike dhe aferat korruptive të PPP-ve po nxijnë çdo raport ndërkombëtar?

Pra, kush e ka fajin që sot të gjitha këto rrjete kriminale shqiptare, të cilat janë zgjeruar dhe kanë kapur tregun global, nuk mund të kontrollohen, rezultojnë të jenë tejet të frikshme dhe nuk po e lënë vendin të përparojë? Kush e ka fajin që sot ne kemi një mungesë të theksuar progresi, në krahasim me vendet fqinje? Kush e ka fajin për mungesën e mjedisit të biznesit dhe të investimeve? Kush e ka fajin që sot nuk ka filluar ende asnjë lloj procesi gjyqësor ndaj personave që janë përjashtuar nga sistemi i drejtësisë? Kush e ka fajin që sot nuk ka ende një ligj zgjedhor që garanton listën e kryetarëve, por jo votën e qytetarëve? Kush e ka fajin që zyrtarë të lartë dhe politikanë të përfshirë në praktika korruptive nuk ndiqen penalisht? Kush e ka fajin që çështja e pronave nuk është zgjidhur ende në këtë vend dhe vetëm vitet e fundit ka mbi 3000 të vrarë për këtë çështje?

Dil, pra, një herë, zoti Kryeministër, dhe mbaj përgjegjësi, qoftë edhe vetëm për një prej këtyre pikave që unë sapo përmenda! Por sot ti nuk ke më kë të blesh dhe kë të shesësh; sot ti ke vetëm veten tënde, madje nuk ke asnjë alibi që të të mbrojë! Sot nuk ke kujt t'ia hedhësh fajin! Sot je vetëm, lakuriq para shqiptarëve, pa asnjë shpresë dhe pa shënuar asnjë lloj arritjeje në këto gjashtë vjetët e fundit! Sot ti ke kabinetin më të dobët, me një performancë të dobët, që nuk ka bërë absolutisht asgjë për këtë vend; një vend të varfër, ku afërsisht 30% e popullsisë nuk arrin të shtyjë dot muajin! Sot ti ke shtresën më punëtore dhe më të vyer të kësaj shoqërie që po largohet nga Shqipëria!

Pra, çfarë presim ne sot? Një shprehje e famshme thotë: "Asnjë nuk është aq i pasur, sa ta blejë të kaluarën e tij". Por unë e di se ka vetëm një zgjidhje. Sot më shumë se kurrë shqiptarët,

veçanërisht të rinjtë dhe studentët, duhet të luftojnë për ndryshimin e sistemit, sepse nesër vota e këtyre të rinjve do të shkojë dëm dhe do të përfundojë në koshin e atyre që nuk mbajnë absolutisht asnjë përgjegjësi; do të shkojë në dëm të vendit!

Pra, unë sot deklaroj se jam kundër këtij sistemi! Poshtë ky sistem që po vret demokracinë në vend!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Hajdari!

Zonja Bello do ta merrni fjalën më vonë për t'ia lënë radhën ministres së Arsimit për të parashtruar projektligjin.

Fjalën e ka zonja Besa Shahini. Të përgatitet deputeti Nimet Musaj.

Besa Shahini – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Jam e lumtur që sot para jush prezantoj punën gati dyvjeçare të ekipit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për hartimin e ligjit "Për rininë", që nisi si një nevojë për të rritur përfaqësimin e të rinjve në vendimmarrje, por pas konsultimeve me të rinjtë në të gjithë Shqipërinë, sot para jush prezantoj një ligj, i cili për herë të parë krijon mekanizmat për fuqizimin e plotë të rinisë në Republikën e Shqipërisë.

25% e popullsisë shqiptare janë të rinj, nga moshë 15 vjeç deri në 29 vjeç dhe ata, përveç shkollimit dhe punësimit, kanë nevojë për aktivitete të tjera dhe për elemente të tjera në jetën e tyre. Ata kanë nevojë të organizohen për të çuar përpara interesat e tyre, të angazhohen për të mirën publike, të argëtohen dhe të shoqërohen. Këto aktivitete mundësojnë socializimin e tyre dhe rrisin empatinë për të tjerët. Ata kanë nevojën të çojnë përpara idetë novatore që vetëm të rinjtë mund t'i kenë, që kanë impakt në të gjithë shoqërinë.

Shkollimi dhe punësimi i të rinjve janë adresuar me ligje të tjera, ndërkohë që me këtë ligj mbështeten organizimi rinor, përfaqësimi në vendimmarrje dhe financimi publik i aktiviteteve rinore. Gjithashtu, projektligji bën disa gjëra që më parë nuk kanë qenë të mundura: definojnë si të rinj personat në moshën 15 vjeç dhe deri në moshën 29 vjeç; identifikon dy kategoritë e organizimit rinor, që janë organizatat rinore të përbëra nga të rinjtë dhe organizatat për të rinjtë,

që zbatojnë projekte prej të cilave përfitojnë të rinjtë, si dhe mundëson për herë të parë financimin publik të këtyre organizatave. Këto organizata bashkërisht mund të themelojnë një organizatë përfaqësuese që mundëson realizimin e dy qëllimeve: gjithëpërfshirjen e të rinjve dhe bashkimin e forcave të organizatave të ndryshme, në mënyrë që Shqipëria të mund të përfaqësohet sa më mirë ndërkombëtarisht dhe të ketë akses në financimet e ndryshme nga Bashkimi Europian apo edhe nga organizata të tjera ndërkombëtare për rininë.

Kriteret e përgjithshme për organizatën përfaqësuese rinore do të përcaktohen pas kalimit të ligjit, pas konsultimeve me OJF-të dhe me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret duhet të jenë të përgjithshme dhe të sigurojnë që organizata përfaqësuese duhet të jetë me të vërtetë gjithëpërfshirëse; të ketë përfaqësues nga i gjithë territori shqiptar. Pra, të evitohen situatat kur disa organizata të fuqishme marrin primatin e përfaqësimit, duke anashkuar plotësisht organizatat më të vogla me shtrirje rurale, që do të përfitonin më shumë nëpërmjet pjesëmarrjes nëpër konferenca të ndryshme ndërkombëtare, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve dhe përfitimit të fondeve të ndryshme ndërkombëtare.

Po citoj ligjin: “Objekt i tij është mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve. Përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë”.

Ligji është i ndërtuar mbi disa parime bazë, që janë shumë të rëndësishme, si: parimi i mosdiskriminimit, parimi i lirisë së organizimit dhe iniciativave rinore të vetëqeverisjes së organizatave, parimi i mundësive të barabarta dhe i pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat që inkurajojnë zhvillimin e tyre.

Garantimi i pjesëmarrjes sigurohet nëpërmjet themelimit të dy institucioneve të reja, të cilat themelohen për herë të parë në Republikën e Shqipërisë: Këshilli Vendor Rinor pranë çdo bashkie me përbërje nga të rinjtë, i përzgjedhur nga vetë organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, ku do të ketë edhe

përfaqësues të institucioneve të tjera relevante që merren me politika rinore në nivel bashkiak; tjetri dhe Këshilli Kombëtar Rinor pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, sportin dhe rininë me përbërje nga të rinjtë, përsëri të përzgjedhur nga organizatat rinore, si dhe do të ketë përfaqësues nga ministrinë e tjera, të cilët do të marrin vendime që prekin të rinjtë. Këta dy këshilla do të propozojnë prioritetet e politikave rinore që do të zbatohen nga bashkitë dhe ministria; orientimin e buxhetit drejt këtyre politikave; do të marrin pjesë në hartimin e strategjive për rininë dhe do të bëjnë monitorimin e strategjive të rinisë.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka disa agjenci që zbatojnë politikat dhe strategjitë e ministrisë sipas portofoleve të ndryshme që mbulon ministria. Sot agjencia që merret me zbatimin e politikave rinore, është Shërbimi Kombëtar Rinor, por kjo agjenci duhet të riorganizohet dhe të fuqizohet, në mënyrë që të realizojë kompetencat e reja ambicioze, të cilat ia jep ligji i ri për rininë. Më konkretisht, agjencia e re, përveçse zbaton politikat dhe programet për të rinjtë, financon dhe mbikëqyr programet rinore, duke përfshirë organizatat rinore dhe ato për të rinjtë; krijon dhe mirëmban bazën e aksesueshme të të dhënave për rininë, përfshirë këtu edhe atë për organizatat rinore dhe për të rinjtë; raporton në mënyrë periodike pranë ministrisë përgjegjëse për rininë lidhur me situatën e të rinjve, si dhe siguron financime nëpërmjet aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sipas raportit të Bashkimit Europian për rininë, gjysma e të rinjve në vitin 2018 në Bashkimin Europian rezultonin të ishin anëtarë të një organizate rinore dhe një e treta përfshihej në punë vullnetare. Një angazhim i tillë në organizata dhe në punë vullnetare zhvillon kapacitetet e të rinjve për punë dhe sidomos i bën qytetarë më të mirë, të angazhuar për të mirën publike dhe empatikë ndaj problemeve të të tjerëve. Në fakt, ajo që synojmë të arrijmë me këtë ligj është të rrisim përfaqësimin e të rinjve shqiptarë në vendimmarrje dhe të mbështesim vetorganizimin e të rinjve sipas interesave, duke mundësuar financimin publik të nismave të tyre. Ndaj ju ftoj ta votoni këtë projektligj.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjalën e ka deputeti Nimet Musaj. Të përgatitet deputeti Kostaq Papa.

Nimet Musaj – Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Për projektligjin “Për rininë” sot dua të flas edhe si prind, edhe si deputet i qarkut më të madh, pas Tiranës, siç është Fieri. Shumë prej problematikave që do të listoj gjatë fjalës sime, i kam mbajtur shënim për t’i përdorur në të ardhmen, në seancën e javës së gjelbërt, e cila u dedikohet pikërisht problematikave të qytetarëve.

Siç e thashë edhe në fillim, qarku i Fierit shquhet për një rini aktive në jetën sociale, politike, ekonomike dhe kulturore, por, të nderuar deputetë, ka jetë të mangët universitare. Hera e fundit që jeta universitare në atë qark gjalloi ishte koha kur ishin universitetet private, të cilat nuk kam ndër mend as t’i përmend, as t’i avokatoj. Reformën e atëhershme për universitetet private, sidomos në rrethe, e kam përkrahur, por ajo çfarë mund të bëhej ndryshe ishte amortizimi dhe zëvendësimi me degët shtetërore i atyre realiteteve lokale, në të cilat jeta universitare kishte sjellë edhe shumë zhvillime pozitive.

Qytetarët e atjeshëm, pavarësisht problematikave për gjallërinë dhe jetën rinore që u ngrit në qytet, ato pak vite kur universitetet ekzistonin, i kujtojnë si ditë të begata. Këtu ngre sërish pyetjen dhe idenë: a mos jemi vonë dhe a mos duhej menduar qysh në atë kohë që qarku i dytë universitar më i madh në vend të ketë filiale të Universitetit të Tiranës?

Në qarkun e Fierit qarkullon bindja se plagën dhe plogështinë e pashpjegueshme, që ka si një mplakje të jetës rinore, një jetë e rilindur universitare mund dhe duhet ta shëronte. Ndaj është koha që edhe nga kjo foltore dhe jo vetëm në fushatat elektorale të thuhet se qarkun më të madh të vendit e kemi pa një jetë universitare; qarkun me zhvillimin më të madh të bujqësisë, më të spikaturin për naftënxjerrje dhe më të madhin në vend për potencialet e pashfrytëzuara të turizmit detar e kemi pa jetë universitare, e cila, gjithsesi, mund të orientohej si fillim edhe në këto tri drejtime: turizëm, naftënxjerrje dhe bujqësi.

Siç e thashë, personalisht do të mbështes çdo nismë që na i mban fëmijët brenda vendit, si dhe do të mbështes me forcë çdo nismë që na i

kthen fëmijët shqiptarë nga jashtë vendit këtu, në vendin tonë, por në nivel qendror kanë një propozim tjetër madhor. Në nenin 24 të Rregullores së sapomiruar thuhet: “Për çështje të rëndësishme të veçantë, Kryetari i Kuvendit, 7 deputetë ose një komision i përhershëm mund të propozojnë të ngrihet një komision i posaçëm”. Një projektligj për rininë më duket i mirë, por është shumë pak. Po ngre një pyetje në formë propozimi (bashkërisht kemi pranuar se largimet nga ky vend i shohim edhe në shtëpitë tona, se nuk mungojnë të dhënat): mos ka ardhur koha për të ngritur një komision të posaçëm për rininë, i cili të ndërtojë një strategji për gjallërimin e jetës rinore edhe në cepat më të largëta të vendit tonë, për lidhjen e rinisë me atdheun, për kthimin e të rinjve dhe për kapërcimin e emigracionit në plan të dytë, për ndalimin një herë e mirë të maskimit të moderuar të emigrimit ekonomik me arsyet shëndetësore?

Shqipëria pa të rinjtë e saj këtu nuk do të jetë më e njëjta dhe as ne nuk do të jemi më të njëjtët pa rininë.

Në fjalën time gjej rastin të bëj thirrjen e sinqertë që të mos ndalemi vetëm me projektligjin për rininë, por duhet një plan kombëtar masash, duhet një rivlerësim i gjendjes së përgjithshme, duhet një ndërhyrje emergjente, por e mirëmenduar.

Të nderuar kolegë, muaji që shkoi ishte muaji i librit dhe i fillimit të universitetit, kurse në nëntor është panairi i librit. Në fakt, që në fjalën e parë të mbajtur në seancën për problematikën e elektoratit unë kam ngritur çështjen e çmimi të librave, një problem që më erdhi nga të rinjtë studentë dhe nga studiues që, për të përparuar në zanatet e tyre, kërkojnë të mos mbeten peng i dijeve sipërfaqësore, por duan të lexojnë si lëndë të parë tekstet perëndimore që i blejnë *online*. Në atë fjalë kërkoja përjashtimin nga taksa 20% të blerjeve *online* të librave ose alternativa të tjera. E kërkoja këtë gjë dhe e kërkoj përsëri edhe sot, që po diskutojmë projektligjin “Për rininë”, nga Këshilli i Ministrave, por sot, të nderuar kolegë, e kërkoj edhe nga deputetët e kësaj sale, nga zoti Hysko, nga zonjusha Lala, që përfaqësojnë shembuj të shkëlqyer të rinjsh që e meritojnë të jenë në këtë sallë, të cilët i dëgjoj më vëmendje. Kam bindjen se, nëse në Shqipëri futim libra më të mirë, patjetër do të kemi edhe një Shqipëri më

të mirë. Është e drejtë që dija nuk ka çmim, por edhe sakrifica për të duhet t'ia vlejë, por është po aq e drejtë që ne, si ligjvënës, të vëmë dorë për t'ua lehtësuar barrën lexuesve aty ku është e mundur. Më duket se ky propozim është i lehtë dhe mund të mbështetet.

Ju ftoj ta votojmë këtë projektligj!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Musaj!

Fjalën e ka Kostaq Papa.

Të përgatitet Vilma Bello.

Kostaq Papa – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar të rinj, studentë, gjimnazistë, të rinj specialistë të fushave të ndryshme, të rinj të papunë dhe të rinj emigrantë.

Sot në seancën plenare po shqyrtojmë projektligjin “Për rininë”, i cili është rëndësishëm, sepse do të koordinojë dhe do të rregullojë në marrëdhënie me shtetin, shoqërinë, veprimtarinë e atij grupi shoqëror që e quajmë rini. Projektligji është i rëndësishëm edhe për faktin se ky grup shoqëror konsiderohet si forca lëvizëse e shoqërisë, sepse përmban moshën e re më aktive, grupmoshën më të aftë për punë dhe pjesën më të shkolluar.

Gjatë punës në Komisionin e Edukimit u bënë përpjekje për ta përqsuar me projektligjin për rininë. Çdo projektligj që vjen në komision dhe në seancë plenare terrenin për votim mund të ketë të meta, mund të mos jetë varianti më i mirë. Unë do të ndalem në disa pika dhe të meta të projektligjit, të cilat bëjnë që përpjekja e mirë për ta miratuar këtë ligj të nevojshëm të rishikohet dhe të përmirësohet. I shpreha edhe në Komisionin për Edukimin, por këtu në seancë po saktësoj disa gjëra. Ligjin nuk e shohim nga këndvështrimi se cili e bën ligjin, as nga pikëpamja politike, por shohim brendinë e tij dhe nëse do t'i rezistojë kohës.

1. Projektligji ka ende nevojë për saktësime pas shumë ndërhyrjeve dhe rregullimeve që i kanë bërë Komisioni për Edukimin, si dhe komisionet e tjera.

2. Boshti i ligjit për organizimin rinor duhet të jetë këshillimor, se përndryshe rinia na del si në diktaturë, levë e pushtetit.

3. Projektligji është për rininë, ndërsa nëpër nene thuhet se do të kemi institucione të tjera

qendrore dhe të pushtetit lokal. Për shembull, titulli i nenit 7 është: “Njësia e vetëqeverisjes vendore”, kur duhej të ishte: “Organizimi rinor për njësinë e qeverisjes vendore”. Pra, duhet të shihen këto institucione nga këndvështrimi i organizimit për rininë. Në nenin 16 duket sikur flasim për buxhetin dhe jo për rininë.

4. Pas zgjedhjeve të 30 qershorit, kur në 61 bashkitë e vendit drejton maxhoranca, në këtë shtjellim të projektligjit “Për rininë”, për shembull në nenin 7, duket sikur organizmat rinorë dalin si leva të bashkisë ose të bashkisë monopartiake, në fund të fundit, të partisë.

5. Ky projektligj institucionet e rinisë i kthen në leva politike.

6. Në projektligj mbeten pa u definuar koncepte, riformulime në organizim, në politika dhe në veprimtari.

7. Projektligji është një përpjekje e mirë, por ende jo i arrirë për t'u sjellë organizmave rinorë dhe, në fund të fundit, të rinjve veprimtari të pavarur.

8. Ashtu si edhe ligji “Për Akademinë e Shkencave”, edhe ky ligj ka plot çartje teknike dhe togfjalësia të futur si mish i huaj nëpër të dhe në nene, pra një vizion i vjetër mbi një mbulesë të re. E abstenoj ligjin, me gjithë dëshirën e mirë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Papa!

Të përgatitet Myslim Murrizi.

Fjalën e ka Vilma Bello.

Vilma Bello – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Të reja dhe të rinj veçanërisht,

Është normale dhe e pranueshme që nga kjo foltore ne të maxhorancës të shfaqim dhe të flasim për qëndrime të kundërta me ato të opozitës, por për mua nuk është normale dhe as i pranueshëm fakti sesi mund të shfaqim qëndrime të kundërta, miratime apo mosmiratime për një projektligj, që lidhet me kategorinë më vitale, më cilësore: rininë që është e ardhmja. Rinia është e lumtur, sepse ka të ardhmen. Me këtë shprehje do të doja ta nisja fjalën për të theksuar në këtë mënyrë rëndësinë e këtij projektligji, si një projektligj që u adresohet të rinjve dhe të rejave, kategorisë më domethënëse, më cilësore, që meriton vëmendjen e duhur nga ana jonë,

vëmendjen e kujdesshme shoqërore, por edhe mbështetjen institucionale dhe shtetërore.

Diskutimi për këtë ligj të posaçëm Për rininë ka nisur si një kërkesë e artikuluar nga organizatat rinore që në vitin 2014, për të cilin janë zhvilluar konsultime dhe takime të shumta me të rinj, me organizata rinore nga qarqe të ndryshme të Shqipërisë, me organizata joqeveritare, të cilat kanë pasur komentet e tyre, dhe bashkë me shtysën reale të qeverisë shqiptare në këta 2 vjet për ta pasur këtë ligj e kemi atë sot për votim, si një rregullator për çështje që lidhen me rininë.

Projektligji “Për rininë” do të shërbejë për të adresuar politikatat rinore dhe do të jetë një mbështetje e madhe për të rinjtë e vendit, të cilët përbëjnë mbi 20% të popullsisë dhe, nëse i gjithë potenciali i tyre do të shpërfaqet dhe do të jetësohet, sigurisht që kjo do të sjellë më shumë shpresë, interes të të rinjve për të jetuar, për të investuar, për ta ndërtuar të ardhmen në Shqipëri: një të ardhme më të mirë për zhvillimin e Shqipërisë dhe të shoqërisë sonë.

Ky projektligj ka rëndësi të veçantë, pasi mbron dhe zhvillon interesat e të rinjve, synon të respektohen të drejtat e tyre, duke garantuar pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje.

Projektligji “Për rininë” ka si qëllim përcaktimin e veprimtarive, të mekanizmave dhe të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të të rinjve shqiptarë në diasporë, si dhe financimin e veprimtarive rinore në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti.

Si anëtare e Komisionit të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik, si prind i dy vajzave, si pedagogë në profesion, në kontakte të vazhdueshme me të rinj dhe të reja, e vlerësoj projektligjin të nevojshëm dhe të duhurin, që sjell ndryshime të rëndësishme dhe konkrete në legjislacionin për të rinjtë, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë vendor.

Kultivimi i të rinjve në rrjedhën politike dhe vendimmarrëse të vendit është i domosdoshëm, pasi të rinjtë dhe të rejt janë grupimi që formëson demokracinë e vërtetë, si promotor i proceseve demokratike në një shoqëri.

Projektligji përfaqëson një model të ri të përmirësimit të statusit shoqëror dhe të pozitës së

të rinjve, garanton hapësirat e nevojshme rinore, hapësira të sigurt, ku të rinjtë mblidhen, angazhohen në veprimtari që u përshtaten nevojave të tyre të larmishme, si faktorë të rëndësishëm në proceset vendimmarrëse, nëpërmjet një angazhimi të tyre në çështje të rëndësishme, që lidhen me qeverisjen qendrore dhe vendore, nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtari kulturore, sportive, argëtuese në komunitet, në hapësirat digjitale, që i ndihmojnë të rinjtë të ndërveprojnë virtualisht me njëri-tjetrin brenda dhe jashtë vendit. Bashkëpunimi i tyre është projektuar të realizohet nëpërmjet ndërveprimit aktiv, sistematik, transparent, të vazhdueshëm dhe afatgjatë, duke mundësuar shkëmbimin e eksperiencave dhe implementimin e politikave rinore të diasporës edhe në vendin tonë.

Përmes këtij projektligji qartësohen roli dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse, të institucioneve përkatëse dhe të strukturave të tyre në nivel qendror e vendor për mbrojtjen dhe fuqizimin e të rinjve. Për herë të parë do të funksionojnë dy struktura konsultative: Këshilli Kombëtar i Rinisë dhe Këshilli Vendor i Rinisë, të cilët marrin pjesë në hartimin dhe zhvillimin e politikave dhe të veprimtarive në fushën e rinisë.

Në projektligj përcaktohen qartë organizatat rinore, në veçanti specifikohet roli që përfaqëson Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore.

Për herë të parë sigurohen burime financiare ku përfshihen fondet grant të buxhetit të shtetit të dedikuara specifikisht për rininë në buxhetet vendore dhe lokale. Organizatat që merren me të rinjtë, do të financohen nga shteti.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është ndërtimi i aftësive bazike që të rinjtë duhet të kenë, në mënyrë që të jenë të suksesshëm në jetë.

Të nderuar kolegë, miratimi i këtij projektligji do të sigurojë një model të ri të përmirësimit të statusit shoqëror dhe të pozitës së të rinjve, duke krijuar kushtet e nevojshme për adresimin e nevojave të tyre në të gjitha fushat që përbëjnë interes për të rinjtë, për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve individuale dhe shoqërore, duke u kushtuar ligjërisht rëndësinë e duhur të rinjve si promotorë të zhvillimit të vendit. Një rini e shëndetshme sot është siguri për një të ardhme më të mirë nesër.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Bello!
Deputeti Murrizi nuk është në sallë.
Fjalën e ka Halil Jakimi. Të përgatitet Halit Valteri.

Halil Jakimi – I nderuar zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë,
Të dashur qytetarë,
Projektligji “Për rininë” që po diskutojmë sot, ka si qëllim përcaktimin e veprimtarive, të mekanizmave dhe të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen, promovimin dhe për të drejtat e të rinjve në Republikën e Shqipërisë, të të rinjve në diasporë, si dhe financimin e veprimtarive rinore në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti. Në analizën që i bëhet këtij projektligji, vihet re se në mënyrë të qartë ai bie ndesh me kërkesat dhe me nevojat që kanë të rinjtë sot. Përgatitja dhe draftimi i këtij projektligji lë për të dëshiruar.

Së pari, ky projektligj nuk është iniciuar nga baza, nga të rinjtë dhe të rejat e këtij vendi, nga organizatat rinore, por është me diktat nga lart-poshtë, pra i iniciuar nga ministria përgjegjëse.

Së dyti, ky projektligj u draftua në një kohë jashtëzakonisht të shkurtër, në një kohë ku nuk u lanë mundësi dhe hapësira të rinjve dhe të rejave, grupeve të interesit për të dhënë dhe për të shprehur mendimet e tyre.

S treti, ky projektligj nuk përfshin çështje të arsimimit, të punësimit dhe të përfaqësimit të të drejtave të tyre.

Numri i të rinjve që nuk janë as në punë dhe as në shkollë në Shqipëri është në nivele alarmante. 28,6% e të rinjve të grupmoshës nga 15- 29 vjeç nuk janë as në punë dhe as në shkollë. BE-ja këtë shifër e ka 14%. Pra, Shqipëria ka një tregues dyfish vlere. Pothuajse një vit më parë, me protestat masive, studentët ju shkundën rehatinë që kishit zënë në karriget tuaja. Ata me të drejtë kërkonin atë që u takonte dhe nuk e merrnin prej kohësh. Bravo ju qoftë, që ngritën krye!

Ju u premtuat shumë studentëve, por nuk ju keni dhënë asgjë, si për shembull ato kartat e studentit, të cilat ofrojnë më shumë shërbime për kafe e palestër, sesa për librari e kancelari. Ndërsa sot doni t’i gënjeni me një ligj që gjoja do t’iu vijë në ndihmë atyre, kur, në fakt, kjo që po krijoni sot është një strukturë, një organizatë si FRESH-i, vetëm se ia keni modernizuar emrin

dhe e quani Këshilli Kombëtar i Rinisë. E keni ngritur këtë organizatë dhe doni ta financoni me buxhet nga shteti.

Nëse do të ndalem nen për nen, jam i sigurt se do të gjej mjaftueshëm fakte dhe arsye që ta rrëzojmë këtë projektligj, por po ndalem vetëm te neni 5 i këtij projektligji.

Si mund të votohet pro ky projektligj për rininë, kur, në fakt, të gjitha kompetencat i ka ministria përkatëse, bashkia dhe Këshilli i Ministrave? Kjo do të thotë që një person, që ka në dorë të hartojë politika, të planifikojë buxhetin, të monitorojë procesin, të përfaqësojë të rinjtë në bisedime ndërkombëtare, dhe është e shkruar qartë që mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar Rinor funksionin në bazë të vendimit të KM-së. Ky këshill do të financohet nga buxheti i shtetit, por ç’kukur kanë qytetarët të paguajnë nga xhepi i tyre për një organizatë si FRESH-i, që i shërben PS-së dhe jo nevojave të rinisë shqiptare? Ata prindër që do të paguajnë për këtë strukturë duan që fëmijët e tyre të kenë mundësi punësimi, arsimimi dhe një sistem të drejtë meritokracie.

Ky projektligj nuk adreson çështjen e largimit të të rinjve që duan të braktisin vendin për të ndërtuar jetën e tyre në një shtet më të mirë në Europë apo përtej Atlantikut.

Dy nga shqetësimet më të mëdha të të rinjve janë arsimimi dhe punësimi, të cilat ky projektligj nuk i ka marrë në konsideratë. Shumica prej nesh në këtë sallë kanë ndonjë të ri në fis apo në familje dhe e sheh se si çdo ditë e më shumë ai kërkon të largohet për të ndërtuar jetën jashtë kufijve, dhe për këtë besoj se biem të gjithë dakord (ta nisim nga unë i pari, që kam anëtarë të familjes apo të fisit që kërkojnë të ikin), por nuk është kjo çështja. Çështja është që ne si parlament duhet të hartojmë një ligj, i cili u vjen vërtet në ndihmë nevojave reale që kanë sot të rinjtë dhe jo të krijojmë një organizatë që ka si qëllim të përdoret për votime, për fushata, për të arritur qëllimin e partisë që e ka krijuar këtë organizatë.

Do të ndalem edhe në dy gjëra specifike. Kryesorja është se lë për të dëshiruar edhe koha kur po miratohet ky projektligj, sepse ju e dini dhe gjithë shqiptarët e dinë, se keni 61 bashkitë e vendit, dhe të krijohet edhe një organizatë kur kompetencat për emërimin e këshillave vendore i

ka kryetari i bashkisë, kjo është me të vërtetë e rëndë.

Unë nuk e mbështes këtë projektligj, pasi rinia shndërrohet në një organizatë siç ishte në kohën e Enverit, pra mund të thuhet që shndërrohet në një rrip transmissioni. Kemi pasur për 70 vjet organizatë rinore, çfarë na duhet tani? Të krijojmë një organizatë që nuk ka asnjë lloj efekti? Unë mendoj se ne duhet të krijojmë modele suksesi, modele për të zgjidhur ato shqetësime që kanë të rinjtë dhe jo të krijojmë këtë organizatë, e cila nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë produkt final. Koha do ta vërtetojë këtë.

Të dashur kolegë,

Unë do të propozoja ta shtyjmë këtë projektligj për një seancë tjetër, me qëllim që ta konsultojmë më gjerë edhe me grupet e interesit dhe të rinjtë, pasi ata janë e ardhmja e këtij vendi.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Jakimi!

Fjalën e ka zoti Valteri.

Halit Valteri – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Projektligji për rininë, i cili ka si qëllim promovimin e të drejtave të të rinjve shqiptarë, ndoshta do të ishte më mirë të ndryshohej në promovimin e të rinjve në diasporë apo atyre që kërkojnë azil, pasi nuk latë asnjë të ri e të re në këtë vend të ketë minimumin e dëshirës për t'u shkolluar, punuar, jetuar dhe për të krijuar familje si bashkëmoshatarët e tyre europianë.

Edhe ata të rinj që kanë mbetur, mezi presin të vijë tetori për të aplikuar për lotarinë amerikane dhe me anktë presin përgjigjen në muajin maj. Ky është i vetmi motiv që u ndez shpresat e vakëta dhe që i mban mbërthyer në këtë vend si të largohen një orë e më parë e të mos kthehen më asnjë herë.

Të rinjtë në Shqipëri nuk kanë mundësi as të shkollohen, as të punësohen dhe as të jetojnë, sepse ju e mbushët administratën me familjarët tuaj, kushërinjtë, nipërit, mbesat, shërbëtorë dhe ithtarë partie, ndërsa atyre u latë tabakanë ose receptorin e telefonit, për t'u përgjigjur "pronto-pronto", "hello-hello".

Të punosh në administratë duhet të kesh mik njërin nga ju, ndërsa të punosh në *call-centre* nuk të mjaftojnë tri diploma, pale konkurset e parapërcaktuara të DAP-it, kriteret e të cilave shpallen tamam si ato PPP-të e

famshme, që vetëm emrin e fituesit nuk shkruani aty, se i gjithë formimi profesional dhe akademik është i sajuar që të përjashtojë nga gara gjithkënd tjetër, përveç mikut tuaj.

Me këtë ritëm ka shumë mundësi që në DAP do të shoh ndonjë ditë kriterë allasoj, sa i gjatë duhet të jesh, i hollë si peri, sytë me dimensione 60x90x60 apo kinezëri të tilla, që vetëm ju dini t'i bëni.

Po të shikosh se si e keni mbushur administratën, gjen aty lloj-lloj dallkavësh partie që zor t'i honepsësh.

I sugjeroj zëvendësministres, që ka bërë këtë ligj, t'i shohë mirë procedurat për të mbajtur të rinjtë në këtë vend, pasi ata janë motori i këtij vendi dhe nëse digjet motori, timonët tuaj nuk do të na çojnë në asnjë vend, por do të na lenë në mes të rrugës.

Të rinjtë sot janë më të palumtur dhe aspak optimistë për të ardhmen e tyre, ndaj kthejeni kokën nga ata, para se të jetë tepër vonë, pasi do të na duhet të bëjmë politika për rininë e diasporës, sepse të gjithë të rinjtë janë larguar dhe po largohen çdo ditë nga ky vend me shifra të tmerrshme. Do të mbeten vetëm ju dhe ai që i dhatë atë vilën, se vetëm ai i shkreti kishte ngelur pa vilë me pishinë.

Këtë vend e ka bekuar Zoti për nga bukuria dhe resurset natyrore, por e ka mallkuar për 30 vjet me palaçot e politikës që vetëm e zhvatin, pasi të dyja palët ndajnë lekët e shqiptarëve si t'ua kishte lënë baba. Janë e njëjta xhakëtë dhe shumë shpejt do t'u grisët ajo xhakëtë nga ata që nuk e presin, nga rinia e këtij vendi.

Të nderuar kolegë,

Kam edhe diçka shqetësuese. Nga opozita duhej të ishin çuar shumë deputetë, në çdo diskutim, se të gjithë kanë kaluar sot te bulevardi "Dëshmorët e Kombit" dhe nuk e di se si nuk ua vrasin sytë fotografitë e ca hetuesve të ish-Sigurimit të Shtetit, si Koço Benga, Xhemal Kodra, Nexhip Bejko, Nuri Luçi dhe ky Fejzi Meçolli, Hero i Popullit, që luftoi me Prek Calin e me të tjerë. Nëse kjo është fytyra realisht që i transmetoni rinisë duke na sjellë këto relikte të komunizmit, këta kriminelë që na kanë vrarë edhe familjarët tanë, atëherë s'na ngelet gjë tjetër, por edhe unë që jam deputet i Republikës së Shqipërisë të marr valixhen dhe të largohem nga ky vend se pas pak do të na detyroni të gjithëve të vemë shallin e pionierit dhe të

bërtasim “Parti – Enver” në këtë sallë parlamenti dhe jashtë kësaj salle.

Zoti Ruçi, do t’ju bëja thirrje juve, si drejtues i Kuvendit të Shqipërisë dhe të gjithë deputetëve të opozitës të bëjmë një kërkesë që t’i zhdukim ato fytyra të shëmtuara që kanë vënë aty dhe të na lënë rehat, të mos na kujtojnë njerëzit që na kanë vrarë dhe na kanë prerë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Një komb duhet të nderojë të rënë e tij. Nuk do të gjendet një shembull i dytë në asnjë parlament demokratik, ku të përgojohet, të mohohet Lufta Nacionalçlirimtare dhe t’i kërkohej seancës plenare, me fjalorin më të papranueshëm të hiqen portretet e heronjve. Prandaj do të kërkoja t’i tërhiqni fjalët që thatë. Lufta e Dytë Botërore dhe ata që dhanë jetën në këtë luftë i japin kombit shqiptar veçse krenari dhe lavdi, prandaj, siç ju kam bërë thirrje në hapje të këtij sesiioni parlamentar, do të ishte në nderin e çdo deputeti që në 75-vjetorin e çlirimit të nderohen luftëtarët, të nderohen të rënë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe të mos bëhen pjesë e retorikës politike në sallën e Kuvendit.

Fjala për Florenc Spahon.

Florenc Spaho – I nderuar drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë,

Në një kohë që Shqipëria po përpiqet me vendosmëri të kalojë mbi të gjitha pengesat që ngadalësojnë rrugëtimin e saj për në BE është shumë e rëndësishme të qëndrojmë për të vlerësuar se në ç’situatë gjendet ajo shtresë e popullsisë për të cilën, në fakt, po bëhen të gjitha këto përpjekje, pra rinia.

Si në çdo analizë apo vlerësim tjetër që bëhet te ne, gjërat nuk janë bardhezi. Në pothuajse 30 vjet nuk mund të themi se punët kanë shkuar ashtu si duhet, por do të ishte, gjithashtu, një gabim po të thuhet se asgjë e mirë nuk është bërë.

Në kaq e kaq vjet kemi parë të rinj që largohen për të kërkuar më të mirën diku tjetër, po kemi parë, gjithashtu, të rinj të qëndrojnë për të bërë më të mirën për vendin e tyre. Kemi parë rininë që qëndron e heshtur dhe indiferente, por edhe që godet me shuplaka apo me grushte politikën. Më lejoni të përdor shprehjen e Kryeministrit që thotë: “Kemi parë rininë të kërkojë për veten e saj, por edhe të përdoret nga

politika pa ndonjë merak të veçantë”. Pra, me pak fjalë i kemi parë të gjitha.

Ajo që na duhet është të kuptojmë nevojën e shoqërisë që rinia të jetë e përfshirë në vendimmarrje, politikëbërje dhe në të gjitha proceset e rëndësishme të përmirësimit dhe të ndryshimit, si aktorët kryesorë në filmin që do të shfaqë të ardhmen.

Duhet të mësohemi të pranojmë edhe kundërshtitë dhe jo-të e forta që na vijnë prej saj, duke i parë si momente reflektimi. Detyra jonë është të krijojmë për të rinjtë një ambient frymëzues. Duhet t’u japim atyre mundësinë që ta shohin të ardhmen në këtë vend duke u ofruar mundësi shkollimi nëpërmjet një këshillimi të drejtë dhe të përshtatshëm, por edhe mundësi punësimi, përmes krijimit të një klime të mirë për biznesin që do t’i lejojë të rrisin ekspertizën e tyre dhe si pasojë do të fitojnë më tepër eksperiencë.

Fryma e qeverisë gjatë gjithë këtyre viteve për t’i orientuar nxënësit drejt arsimit profesional ka rezultuar e suksesshme, ndaj sot përherë e më shumë të rinjtë e shohin arsimin profesional si një mundësi shumë të mirë për të ndërtuar të ardhmen e tyre.

Platforma e ekselencës dhe programi që realizon punësimin e të rinjve me rezultate të larta akademike është një ide e shkëlqyer, që njëherazi nxit dhe motivon studentët, por edhe rrit cilësisht administratën që ka aq shumë nevojë për nëpunës të zotë.

Sot vjen në parlament një projektligj që gjatë shqyrtimit dhe konsultimit të tij është ndeshur herë pas here me kundërshti dhe kundërshtitë janë më se normale. Në një vend ku gjithkush mund të thotë atë që mendon, është për t’u vlerësuar fakti që ky projektligj propozon një mënyrë organizimi, që ka munguar.

Deri tani kemi vepruar në spontanitet, jemi mbështetur kryesisht në vullnetin e atyre që drejtojnë, të cilët, nga ana tjetër, kanë orientuar çdo gjë sipas busullës së tyre.

Institucioni përgjegjës për rininë, këshilli kombëtar dhe këshillat vendore, pra i gjithë organizimi që projektligji parashikon, mund të diskutohen, por është gabim të paragjykojen. Nëse deri tani jemi ankuar se të rinjtë kanë qenë larg vendimmarrjes, këto struktura do t’u lejojnë atyre të jenë të pranishëm në tryeza të rëndësishme diskutimesh në nivel qendror apo

vendor, për të prezantuar platforma, për të korrigjuar qasje, por edhe për të kundërshtuar bindshëm atë që nuk i pëlqen.

Në këndvështrimin tim, këshillat vendorë të rinisë do të jenë struktura interesante. Pranë kryetarëve të bashkive, përfaqësuesit e të rinjve do të kenë mundësi të ndikojnë në politikëbërjen lokale jo vetëm për sa u përket çështjeve që lidhen direkt me ta, por edhe më gjerë.

Buxhetimi lokal dhe vendimmarrja do të kenë një sy më tepër për t'i monitoruar, ndërsa bashkitë do të kenë një qasje më miqësore ndaj të rinjve dhe organizatave që përfaqësojnë.

Natyrisht, ligji nuk është perfekt, por është një përpjekje e vërtetë për të strukturuar në mënyrë objektive dhe për t'i dhënë një formë konkrete iniciativave dhe punëve të shumë aktorëve, të cilët me dëshirë e kurajë synojnë të bëjnë më të mirën për të rinjtë në Shqipëri.

Në fund të fjalës sime, më lejoni të citoj një shprehje, e cila ka vend për çdo kohë: "Ai që drejton punë të mira, është njësoj si ai që i kryen ato".

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Spaho!

Fjala për Fatjona Dhimitrin. Të përgatitet Arlind Çarçani.

Fatjona Dhimitri – I nderuar zoti kryetar, Kolegë deputetë,

Të rinj e të reja anembanë Shqipërisë,

Sot, teksa po vija në parlament, vura re se në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" ishin vendosur disa fotografi të Qemal Stafës, Vasil Shantos, si dhe disa të tjerëve, që tani nuk i kujtoj dot të gjithë me emra, dhe mendova se ata kanë qenë disa të rinj, të cilët kanë luftuar për çlirimin e Shqipërisë nga okupatorët nazi-fashistë, ndaj sot po i kujtojmë, por nuk vëreja foton e udhëheqësit të tyre legjendar, Enver Hoxhës.

U çudita shumë, sepse në kohën që po jetojmë, vetëm ai mungon. Ndoshta ndokush nuk guxon ta vendosë aq haptas, apo ndoshta mendon që foton e tij ta vendosë pas disa ditësh. Se për kë e kam fjalën, mund ta imagjinoi vetë.

Sot po shqyrtojmë një projektligj për rininë, që të them të drejtën, ndonëse jeni rropatur ta shisni si një detyrim europian, nuk e keni gjetur në asnjë vend. E vetmja gjë europiane në këtë vend, është fakti se në Europë nuk ka një ligj për rininë. Gjithsesi, ju jeni mësuar të besoni

legjendat e Skënderbeut tuaj, ndonëse nuk është më i ri në moshë për të treguar përralla.

Sot po vulosni rininë komuniste, jo atë të para 45-ës, por atë të pas 45-ës. Krijoni organizatat e rinisë, që varen nga kryetarët e bashkisë, i detyroni ata të organizohen në 61 bashki, sipas idealit komunist. Por shpejtoni, sepse sapo kjo rini të kujtohet se çfarë po bëni, më besoni: ose do të ikin masivisht, si në nëntëdhjetën, ose do të dergjen burgjeve, që ju me shumë gjasë do t'i krijoni, kështu si ia keni nisur. Vetëm mos harroni se do të vijë radha për të gjithë, siç erdhi për Kadriun, për Mehmetin, për Beqirin e për shokët e tij.

Qeverisjes së dështuar të rilindjes nuk i intereson punësimi i të rinjve pas përfundimit të shkollimit të tyre, por i mjafton që ata të strehohen nëpër *Call Center*, ndërkohë që militantët partiakë, pa asnjë lloj merite e kualifikimi profesional, arrijnë të punësohen në dikasteret më të larta të administratës shtetërore. Arsyeja: lidhjet nepotike me Kryeministrin tuaj dhe të sektorit të tij.

Edi Rama nuk shqetësohet për të ardhmen e të rinjve, të trurit të Shqipërisë, që vit pas viti po e varfëron vendin tonë, por mendon si e si të pastrojë figurën e Valdrin Pjetrit, Agim Kajmakut, si dhe të bandës kriminale të krijuar nga vetë ai, nëpërmjet zgjedhjeve moniste.

Ja pra, kjo është panorama, që Kryeministri i dështuar i rilindjes u ofron të rinjve e të rejave shqiptare, kjo është e ardhmja e projektuar përmes krimit, korrupsionit, hipokrizisë e falsitetit.

Të nderuar deputetë,

Po veproni larg së ardhmes së ndritur që do të kishte ky vend. Po të mendonit për rininë ashtu siç mendojnë vendet europiane, do t'i krijonit mundësi, jo t'i rekrutoni në organizata partie të udhëhequra nga kryetarët e bashkive.

Projektligji i ardhur në Komisionin e Edukimit dhe Mjeteve për Informim Publik dëshmon më së miri paaftësinë e kësaj qeverie për të përgatitur ligje cilësore në dobi të qytetarëve shqiptarë.

Ky projektligj synon të vendosë nën diktatin e qeverisë dhe nën kontroll politik rreth 681 mijë e 548 të rinj e të reja të moshës 15 deri 29 vjeç në Shqipëri. Projektligji i rinisë po vendos një diktat absolut të ministrisë përkatëse ndaj të gjitha organizatave rinore.

Në nivel lokal, të gjitha organizatat rinore që zgjidhen nga kryetarët e bashkive vendosen gjithashtu nën kontrollin e tyre të plotë. Ky ligj u hap rrugën abuzimeve politike dhe nuk zgjidh problemet e të rinjve në Shqipëri.

Ligji nuk adreson aspak një prej çështjeve më të prekshme që po përjeton Shqipëria gjatë këtyre viteve të fundit: atë të ikjes së trurit dhe të fuqisë punëtore më aktive, rinisë.

Në ligjin e rinisë nuk përcaktohet në asnjë moment buxheti për rininë, si në nivel lokal, ashtu edhe qendror. Ligji nuk përfshin dhe nuk përmend ngritjen e strukturës së komisionerit për të rinjtë, si një autoritet i pavarur, që do të bënte të mundur mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve në Shqipëri.

Ligji përjashton kartën rinore studentore, një mohim ky prej vitesh nga MASR-ja, si shkak i vakuumit ligjor deri më tani. Ligji përjashton Shërbimin Kombëtar të Rinisë, si dhe mohon kompetencat e kësaj strukture. Ligji nuk fokusohet aspak në praktikën e punës së të rinjve dhe në nxitjen e praktikave në ligj, nuk kordinon strukturat rinore lokale e kombëtare dhe punën e të rinjve në nivel lokal e kombëtar, duke i mohuar pikën e kontaktit, siç është kordinatori i rinisë.

Ligji nuk garanton të drejtën e të rinjve e të rejave për një punësim dinjitoz. Ligji nuk garanton një të ardhme të sigurt për të rinjtë e të rejtat, që të mund të shmangë emigrimin e tyre drejt vendeve të tjera. Ligji nuk përfshin asnjë rregullim për të rinjtë pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, që jetojnë në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, në këtë ligj mungojnë një sërë elementesh mjaft të rëndësishme e ndihmues për fuqizimin e rinisë në Shqipëri, si sektori i rinisë pranë çdo bashkie, qendrat rinore, koncepti punonjësit e rinisë, çfarë është puna me rininë dhe ku konsiston ajo.

Po ashtu, ky ligj u mohon të drejtën rreth 255 mijë e 689 studentëve, nxënës të arsimit të mesëm e të lartë në Shqipëri, për të pasur shërbime rinore të përfituara nga karta rinore.

Kolegë deputetë,

Ju bëj thirrje të mendoheni për fëmijët tuaj, që nën diktatin e kësaj qeverisjeje të dështuar, nesër do të bëhen spiunët e radhës, persekutorët e radhës, do të vuajnë për bukën e gojës, sepse ju sot votuat për një rini, e cila nuk ka të ardhme.

Do të vuani për të parë fëmijët apo nipërit tuaj, sepse nuk do të keni mundësi të shkoni apo të vini, sepse propaganda komuniste do të jetë mbi kokat tuaja. Mendojeni mirë këtë që po bëni.

Fuqia ime është të votoj kundër dhe të shpreh hapur mendimin tim. Ngrihuni edhe ju me lirinë tuaj të mendimit dhe votoni sot kundër këtij projektligji, se po të hyjë në fuqi, do të fillojë riti funebër i rinisë sonë të mrekullueshme.

I bëj thirrje rinisë që të mos ndalet përpara kësaj që ju po i bëni sot, dhe të marrë fatet e saj në dorë.

Kryeministër i dështuar i këtij vendi, mbajti larg nga rinia shqiptare duart e tua të ndotura!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Dhimitri!

Fjala për Arlind Çarçanin. Të përgatitet Adelina Rista.

Arlind Çarçani – I nderuari drejtues i seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji që keni sjellë sot, për fat të keq si shumë veprimtari të tjera të kësaj qeverie dhe kësaj maxhorance, është një akt propagande dhe asgjë më shumë.

Ndoshta ky ligj duhet për propagandën tuaj, por fatkeqësisht nuk sjell asnjë ndryshim, veç përpjekjes së qeverisë për t'u dukur sikur e ka merak rininë.

Problemet e mëdha të rinisë zgjidhen, por ato duan vullnet politik. Problemi është se në vendin tonë, të jesh i ri nuk është bekim, siç do të duhej të ishte. Kjo konfirmohet çdo vit nga ikjet masive dhe nga kërkesat për azil në vendet e Bashkimit Europian. Gjatë gjithë këtyre viteve, ne kemi ngritur një sistem armiqësor për ta, gjë të cilën ata e refuzojnë duke ikur e duke marrë arratinë. E patë çfarë ndodhi me studentët gati një vit më parë. Ata djem dhe vajza të mrekullueshëm vërshuan nëpër rrugë dhe ngritën krye. Po pse u duk sikur erdhën nga askundi, sikur nuk ishin këtu mes nesh? Sepse thjesht ishin të harruar, ishin lënë në mëshirë të fatit, me tarifa të papërballueshme, me kosto tmerrësisht të larta.

Ju e mbani mend mirë se si u hodh përpjetë qeveria dhe si u mundua me mish e me shpirt, fillimisht ta dobësonte e ta prishte revoltën e tyre, ndërsa më pas u angazhua për të plotësuar

disa kushte. Po pse pikërisht pasi ata mbushën rrugët dhe sheshet, duke treguar vendosmëri e duke na dhënë të gjithëve një leksion të sjelljes qytetare e europiane, pse pikërisht atëherë u kujtua qeveria se duheshin rregulluar konviktet dhe duheshin reduktuar tarifat? Jua them unë, ndonëse e dini mirë të gjithë: qeveria reagoi për të ruajtur karrigen. Pra, reagoi nga frika se mos humbte pushtetin, jo pse i ka prioritet studentët. E di që me të rinjtë nuk ia del dot, sepse dihet fati i regjimeve, sa herë që përballen me rininë dhe studentët. Kjo qeveri kishte dhe ka prioritet interesat e saj, pushtetin e saj, të rrijë sa më gjatë në krye.

U desh revolta e tyre, që qeveritarët të mësonin se në çfarë kushtesh mizerabël jetonin ata nëpër konvikte. Kërkesat e tyre nuk janë plotësuar ende sot. Unë i kam ndjekur në intervistat që japin. Ulja e tarifave është e pakonsiderueshme dhe jo për të gjithë.

Pra, ky është trajtimi që ju u bëni të rinjve në shkolla dhe në universitete. Ata që premtojnë, që janë investimi më i sigurtë, janë lënë në harresë dhe shpërfillje. Mendoni pak se sa i ka në vëmendje qeveria edhe shumë të rinj të tjerë, të cilët nuk arrijnë të ndjekin studimet, që janë pa profesion dhe rinë rrugëve tërë ditën, apo ata që banojnë nëpër fshatra dhe nuk kanë asnjë mundësi.

Sigurisht, askush nuk mund të pretendojë të kemi një qeveri dhe një sistem, që t'i marrë ata përdore, për t'u siguruar jetën dhe të ardhmen, por qeveria ka në dorë të stimulojë politika, të nxisë reforma dhe masa, që të rinjtë të ndjehen të përfillur.

Jetojmë në kohën e inovacionit të teknologjisë së informacionit. Qeveria e ka për detyrë të ofrojë mundësi trajnimi për të rinjtë që përballen me tregun në ndryshim, sidomos me tregun europian. Frika është se do të jemi të fundit. Teksa teknologjia në Europë avancoi çdo ditë, të rinjtë tanë nuk do mund të kenë aftësi për t'u përballur me kërkesën për punë, dhe për fat të keq do të mbeten sërish në vonesë historike, në rastin më të mirë me punë të dorës së dytë dhe punë të paguara jo mirë.

Ky projektligj që keni sjellë sot nuk jep asnjë garanci për konkurset që do të bëhen nesër në administratë. Nuk jep asnjë garanci që konkurset s'do të jenë fiktive, se projektet apo financimet që jepen s'do të jenë klienteliste.

E pra, është kjo plagë e madhe, ajo që i detyron ata të ikin, sepse duket qartë që nuk kanë shanse të barabarta. Janë të rinjtë e lidhur me partitë politike, ata që favorizohen, të rinjtë që janë bij apo bija të dikujt të rëndësishëm, ata që kapin vendet e punës. Si mendoni se do t'i rregullojë ky ligj këto? Kjo mund të zgjidhet vetëm me vullnet politik, vullnet që fatkeqësisht ju nuk e keni.

Gjëja më dramatike është se ju që jeni në pushtet, por dhe kushdo tjetër që përfiton nga ky sistem tridhjetëvjeçar, nuk mërzhiteni fare që rinia po largohet. Përkundrazi, ju fërkoni duart kur ata ikin, sepse ndjeheni më të sigurtë në karriget tuaja. Dihet fare mirë se rinia, të rinjtë janë garancia e ndryshimit. Duke u larguar ata, ju bëjnë nder, sepse kjo favorizon qëndrimin tuaj sa më të gjatë në pushtet. Këtë dëshironi ju: largimin e rinisë dhe afrimin e sa më shumë trushpëlarëve pas derës së kryetarit.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjala për Adelina Ristën.
Të përgatitet Korab Lita.

Adelina Rista – I nderuar kryetar,
Kolegë deputetë,

Unë mendoj se kjo foltore ka peshë të madhe përgjegjësie, ndaj duhet të tregohemi të matur për çfarë përcjellim nëpërmjet saj.

Të gjithë ne, gjatë gjithë jetës sonë, në çdo hap që hedhim, ngado që shkojmë, kudo që jetojmë dhe punojmë, pavarësisht bazës familjare, kulturës dhe traditës së trashëguar, pavarësisht ngjyrës, racës, fesë, pavarësisht statusit shoqëror, pavarësisht se flasim dhe jetojmë duke gëzuar lirinë apo jemi në luftë për të kërkuar lirinë e munguar, pavarësisht arsimimit, kualifikimit, karrierës, pavarësisht se sa e sa gjërave që do të numëroja këtu, që të gjithë mendojmë në çdo hap, punojmë në çdo hap, bëjmë veprimet në çdo hap, duke menduar, punuar, kërkuar për fëmijët tanë dhe në emër të fëmijëve tanë. Sepse gjithçka u përket atyre, gjithçka e bëjmë për ta dhe në emër të tyre, prandaj them që kjo foltore ka peshë të madhe përgjegjësie. Nuk reshtim së menduari dhe kërkuari, nuk reshtim së punuari, nuk kënaqemi kurrë, por jemi kërkues deri në detaj për fëmijët tanë që t'i mirërrisim, që të mos iu mungojë asgjë, që ata të gëzojnë të drejtat e tyre, që ata nesër të ndjehen të realizuar në ëndrrën e tyre. Vetëm nëse ata nesër do të ndjehen të realizuar

në ëndrrat e tyre, ne e kemi bërë detyrën tonë. Kudo të jemi, kudo të shkojmë, ne mendojmë dhe punojmë për fëmijët tanë. Në emër të fëmijëve tanë ne bëjmë gjithçka. Para një muaji në sallën e konferencave të Kuvendit të Shqipërisë u organizua një event ku protagonistë ishin të rinjtë. Ky event ishte i mbështetur nga Kuvendi i Shqipërisë. Ndjeheh mirë kur je dhe bëhesh pjesë e një eventi të tillë, ku protagonistë janë të rinjtë, të organizuar në parlamentin rinor që e udhëheqin vetë dhe e drejtojnë vetë, të rinj që diskutojnë lirshëm, që diskutojnë me zell, që marrin një projektligj e sjellin aty në modelin e parlamentit të Shqipërisë duke zhvilluar debat konstruktiv për këtë projektligj nëpër komisione, duke dhënë me kompetencë dhe duke argumentuar qartë dhe saktë gjithë mendimet pro dhe kundër për këtë projektligj. Ndjeheh mirë kur sheh të rinj të tillë se sa me zell diskutojnë problematikat që i shqetësojnë, sa bukur shtrojnë çështjet që ata i shqetësojnë dhe sa bukur ata kërkojnë një projektligj ku përfituesit janë vetë ata.

Në këtë event të rinjtë e parlamentit rinor të disa rretheve të Shqipërisë prezantuan ligjin për rininë, debatuan në mënyrë konstruktive dhe votuan për projektligjin që u përket atyre dhe përfituesit janë ata.

Sot ne jemi në Kuvend për projektligjin për rininë. Nëse unë ju thashë që ne e kemi për detyrë që fëmijëve tanë dhe të rinjve tanë t'iu garantojmë një jetë të paqte dhe pa probleme, një jetë të sigurt, ku t'iu njihen të drejtat, ku ata nesër të ndjehen të realizuar, e kemi mundësinë që projektligjin që iu përket atyre, pasi e kemi diskutuar në komisionet përkatëse përgjegjëse ose për dhënie mendimi, pas dëgjësive të shumta që janë bërë për këtë projektligj, do diskutojmë dhe do miratojmë sot. Cili është qëllimi i këtij projektligji? E thashë pak më parë, në atë event që u bë në Kuvendin e Shqipërisë ne pamë të rinj që vendosën veten e tyre në pozitat e deputetëve të parlamentit shqiptar duke evidentuar dhe adresuar problematika të ndryshme, që i hasin në jetën e përditshme në çdo hap që hedhin, si: ngacmimi, abuzimi, bulizmi. Qëllimi i projektligjit është promovimi i të drejtave dhe përgjegjësi duke qëndruar fort në respektimin e këtyre të drejtave.

Në evente të tilla shkalla e ndjeshmërisë rritet, ndjenja e përgjegjësisë rritet. Ky projektligj që vjen sot në parlament është pikërisht në kuadër të zhvillimit të politikave rinore në funksion të një jete aktive, mbushur me veprimtari që synojnë mbrojtjen e të rinjve, duke i adresuar çështjet dhe problematikat në institucionet e ngritura posaçërisht për këtë qëllim në nivel qendror dhe vendor, duke përcaktuar rolin dhe përgjegjësinë e çdo institucioni ose strukture të ngritur vendore ose qendrore, duke vlerësuar se roli i çdokujt është i rëndësishëm. Adresimi i çështjeve nga të gjithë aktorët publikë dhe jopublikë sjell në projektligj konceptin e rrjetit rinor, pjesë e të cilit janë jo vetëm institucionet dhe organizatat, por edhe individët e rinj.

Projektligji për rininë që vjen sot në parlament, nismë e qeverisë shqiptare, i shërben përmirësimit të legjislacionit aktual, i shërben rritjes së aktivizimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve në veprimtari, i shërben vendosjes së standardeve për infrastrukturën në shërbim të të rinjve.

Projektligji ka gjithsej 20 nene, në të cilat përcaktohen qartë qëllimi, synimet, infrastruktura. Nen pas neni parashirohen parimet kryesore të mbështetjes dhe fuqizimit të të rinjve, si: respektimi i të drejtave dhe fuqizimi i tyre. Është për t'u përmendur përkufizimi i terminologjisë së përdorur, ku është përcaktuar qartë dhe saktë edhe përkufizimi për terminin i ri, si "target grupi përfitues".

Në projektligj parashirohet parimi për barazi në të drejta dhe mundësi; parimi i mosdiskriminimit; parimi i garantimit të të rinjve në proceset e politikbërjes dhe vendimmarrjes në fusha të ndryshme të jetës shoqërore e politike, në arsim, kërkim shkencor, politika financiare, punësim, vullnetarizëm e të tjera.

Po kështu projektligji prezanton konceptin e rrjetit rinor, që përfshin të gjithë strukturën e rinisë në Republikën e Shqipërisë, e cila përbëhet nga institucionet dhe organizmat në nivel qendror dhe vendor, që brenda fushës së vet të veprimtarisë ushtrojnë përgjegjësi në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së të rinjve.

Projektligji parashtron shumë mirë hap pas hapi kompetencat e Ministrisë përgjegjëse për Rininë, ku ndër të tjera theksohet roli kryesor i kësaj ministrie në hartimin e politikave dhe

veprimtarive për rininë; roli kryesor i kësaj ministrie në koordinimin, menaxhimin dhe monitorimin e zbatueshmërisë së këtij projektligji. Po kështu parashtrihen kompetencat e vetëqeverisjes vendore si përgjegjëse për krijimin e këshillit vendor të rinisë dhe krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë, për organizimin dhe koordinimin e veprimtarive në nivel vendor e të tjera.

Forma dhe kriteret për organizatat rinore parashikohen...

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Rista!

Fjalën e ka Korab Lita, të përgatitet Ralf Gjoni.

Korab Lita – Faleminderit!

Në fakt, unë nuk desha të flas për panoramën e bulevardit sot, por zoti Valteri më ngacmoi pak.

Zoti Valteri, ata burrat që janë aty në foto sot, në fakt, luftuan për një Shqipëri tjetër, jo për atë që u bë pas vitit 1944, por të garantoj që bashkë me shumë patriotë të tjerë të Ballit ose të organizmave të tjera që luftuan për lirinë e Shqipërisë, edhe ata janë viktimë të bandës së Popoviçit dhe Mugoshës. Duhet të jesh pak më i qartë për këtë. Ata meritojnë respekt, sepse luftuan për një Shqipëri tjetër, jo për atë që u bë.

Të nderuar kolegë, qeveria sot ka sjellë për miratim një projektligj me emër të bukur “Për rininë”, por që në brendësi të tij parashikon një aferë financiare për OJQ-të pranë Partisë Socialiste dhe një skemë të rafinuar për të vendosur kontrollin politik mbi të rinjtë shqiptarë. Projektligji për rininë sillet në këtë sallë si një premtim i pambajtur i qeverisë, si një refleksim pas protestave masive të rinisë studentore të një viti më parë.

Natyrisht nuk është as refleksim, as dëshirë e mirë e kësaj qeverie për të qëlluar në shenjë dhe për të përmirësuar kushtet e të rinjve shqiptarë. Të gjithë jemi dëshmitarë që qeveria ka një kontribut të jashtëzakonshëm në realizimin e ëndrrës aktuale të rinisë shqiptare, atë të ikjes dhe të fillimit të jetës së tyre jashtë vendit. Vërtet qeveria socialiste nuk i mbajti dot premtimet për 300 mijë vende pune, shëndetësi falas, rritje ekonomike, rimëkëmbje të bujqësisë, rritje të prodhimit vendas, përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e pensioneve, të pagave e të tjera, por të gjithë jemi dëshmitarë që ajo u hapi portën dhe po i përzhë qytetarët shqiptarë,

pasi ata e kanë të pamundur të rrisin fëmijët e tyre në Shqipëri.

Eksodi i viteve të fundit është më i rrezikshëm se ai i viteve '90. Nëse në vitet '90 nga Shqipëria komuniste iku krah i punës, familjet e tyre ishin këtu dhe për ta kishte shpresë se do të ktheheshin, por eksodi i këtyre viteve është shumë e shumë më i dhimbshëm, pasi sot shqiptarët po shesin shtëpi e katandi me vendimin për të mos u kthyer më kurrë. Kjo është shumë e dhimbshme dhe alarmante. Ende më e dhimbshme është sot ikja e rinisë. Shqipëria sot ngjason me një pyll, i cili dikur ka qenë i bukur, por sot i janë prerë lisat, i janë prerë edhe filizat duke e shkatërruar atë plotësisht.

Për ata që vendosin të rrinë në Shqipëri qeveria ka vendosur të marrë masa duke i kapur ata politikisht. Sa ironike! Është njësoj sikur të marrësh një zog të vogël, që nuk ka mësuar ende të fluturojë e ta fusësh në kafaz, ndonëse i jep të hajë e të pijë në kafaz, ai edhe mund të rritet, por kurrë nuk do të mësojë të fluturojë. Kjo do të ndodhë me rininë tonë sot, nëse miratohet ky projektligj.

Projektligji parashikon që fondet për rininë të administrohen nga borde që drejtohen nga ministrat e linjës për projektet kombëtare dhe nga drejtuesit lokalë për projektet lokale. Këto fonde drejtuesit politikë do t'i menaxhojnë me këto organizata qeveritare alla Erion Veliaj, të cilat janë shndërruar në gropa thithëse për milionat e buxhetit të shtetit dhe donacioneve të huaja në emër të të rinjve. Këto të ashtuquajtura borde për rininë do të organizojnë disa festa për rininë, ku do të flitet për të mirat e rilindjes suaj, për atë që e keni për zemër, përmirësimin e jetës së brezit të ri. Natyrisht, në këto festa, takime, aktivitete nuk do të flitet se si rinia, pjesa më vitale e shoqërisë, ka ikur ose po shpreson të ikë jashtë Shqipërisë për një jetë më të mirë. Në këto festa e takime të bordeve të rinisë do të flitet për përmbushjen e premtimeve të qeverisë, për përmirësimin e infrastrukturës studentore, por, natyrisht, nuk do të flitet se si investimit 6 milionë euro për sistemimin e konvikteve të Qytetit Studenti i doli boja për tre muaj dhe u rrëzua suvaja, e cila, për fat të mirë, nuk shkaktoi dëme te studentët.

Këto janë disa të vërteta të hidhura që ndodhin përditë, por ato nuk raportohen, nuk

publikohen nga mediat kryesore shqiptare, të cilat ose janë të joshura ose janë nën ndikimin qeveritar. Meqë mediet shqiptare, të gjendura nën tryshinë e pushtetit, nuk guxojnë të raportojnë disa të vërteta për të rinjtë, po i referohem një raportimi të një stacioni kryesor gjerman, Deutsche Welle. Në qershor të këtij viti raportimi medietik është nga Gjermania, nga ai vend që kryeministri në detyrë dhe të tjerët pas tij e trumbetojnë si vlerësuesi pozitiv i reformave qeveritare.

Në raportin e televizionit gjerman pasqyroheshin problemet reale të rinisë shqiptare, ato të cilat nuk gjenden në projektligjin e sjellë nga qeveria dhe as nuk janë në orbitën e saj për t' dhënë zgjidhje.

“Shprehja: “Guri i rëndë në vendin e vet” duket se nuk po vlen më për shqiptarët. Me sytë përtej kufirit, themelet e së ardhmes ata i kërkojnë medoemos larg Shqipërisë”, kështu e nis raportin gazeta, në sintezë të qartë të realitetit të rinisë shqiptare, të cilët po e ndjejnë dhe përjetojnë çdo ditë në këtë qeveri, por, kur këto kritika i paraqet opozita, për qeverinë dhe qeveritarët, janë thjesht shashka politike.

Vijmë më tej me shkrimin “Një jetë larg Shqipërisë duhet të jetë ëndrra e të rinjve shqiptarë”. Në një sondazh të kryer nga fondacioni “Fridrih Herbert”, në periudhën 2018-2019, rreth 40 % e të pyeturve kanë shprehur dëshirën për të ikur nga Shqipëria. Destincioni më i preferuar është sigurisht Gjermania. Si do ta zgjidhë ky projektligj për rininë këtë plagë të hapur të shoqërisë shqiptare?

Kolegë të maxhorancës dhe ju qeveritarë që po shijoni pushtetin e votave të vjedhura, për herë të parë e të vetme hiqni dorë nga projektligjet që shërbejnë si fasadë për shpërndarje fondesh mes klientëve tuaj dhe bizneseve!

Ne kemi detyrim të mblidhemi së bashku, jo vetëm deputetët në këtë sallë, por të gjithë faktorët politikë, socialë dhe ekonomikë, të hartojmë një platformë me themele të forta për të inkurajuar të rinjtë të qëndrojnë në Shqipëri. Është detyra jonë dhe e çdo intelektual shqiptar për të studiuar, miratuar dhe zbatuar praktikën më të mira, për t'i dhënë impuls rinisë shqiptare që të kontribuojë për vendin. Pa një platformë të tillë gjithëpërfshirëse dhe të vërtetë është e kotë

që Shqipëria të synojë Bashkimin Europian. Për shkak të keqqeverisjes së kësaj maxhorance Shqipëria e humbi sërish mundësinë për të hapur negociatat me Bashkimin Europian. Nuk e kanë fajin as Franca, Danimarka, Holanda apo kushdo vend tjetër që e sheh me skepticizëm vendin tonë. Një vend si yni, që humb me mijëra të rinj rrugëve të emigracionit, nuk është aspak i besueshëm për partnerët ndërkombëtarë. Pa zgjidhur mirë punët tona të brendshme askush nuk do të na e hapë rrugën për t'iu bashkuar një entiteti më të madh politik të vendeve të zhvilluara. Pra, për të gjitha këto arsye, boll me këtë politikë fasadë dhe mjaft u tallët me të rinjtë, me këto projektligje boshe që sillni për miratim.

Unë propozoj që ky projektligj të tërhiqet mbrapsht nga propozuesit dhe të hartohet një propozim i ri dhe në hartimin e tij të ketë gjithëpërfshirje nga të gjithë aktorët, të hartohet një ligj, i cili vërtet t'i shërbejë rinisë dhe silleni ta votojmë të gjithë. Në të kundërt, vota ime do të jetë kundër, por njëkohësisht u bëj thirrje të gjithë deputetëve, të cilët vërtetë votojnë me zemër dhe jo me urdhër të votojnë kundër.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Lita!

Fjalën e ka deputeti Ralf Gjoni.

Të përgatitet deputeti Zef Shtjefni.

Ralf Gjoni – Në fakt, do të kisha pritur një kërkesë ndjese nga ministrja për Arsimin, Sportin dhe Rininë, si dhe nga përfaqësuesit e ministrisë në parlament, sepse kur filloi debati për ligjin “Për rininë”, asnjë përfaqësues i ministrisë nuk ishte prezent në sallë. Kjo tregon për seriozitetin me të cilin merret rinia shqiptare sot nga kjo qeveri.

Zonja Ministre, ju përmendët faktin, nuk është fakt, se ministria ka 2 vjet që po punon me këtë ligj. Ky është një fakt i pavërtetë. Origjina e këtij ligji, për ironi të fatit, daton nga fundi i vitit 2018, ku me një propozim të dy deputeteve të reja të ish-grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integritet u hodh për herë të parë ideja e një ligji për rininë, kuptohet me propozim nga një grupim i shoqërisë civile.

Personalisht, kam qenë kundër parimit të një ligji specifik për rininë atëherë, por jam kundër edhe sot. Ky ligj, të nderuar qytetarë dhe të rinj, është jo vetëm problematik, por është tërësisht i panevojshëm. Unë nuk e kuptoj se pse

i duhet Republikës së Shqipërisë një ligj për rininë, për më tepër që ky ligj nuk merret fare me thelbin e problemit.

Përcjell në vëmendjen tuaj, të nderuar qytetarë, që ka shumë vende të Bashkimit Europian që nuk kanë një ligj për rininë si Çekia, Danimarka, Suedia, këto të fundit dy nga vendet më të përparuara për rininë në Europë, Greqia, Franca, Kroacia, Italia, Qipro, Hungaria, Malta, Austria, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Mbretëria e Bashkuar, përfshirë këtu Anglinë, Skocinë dhe Uellsin, si dhe vende të tjera të Bashkimit Europian, që janë ku e ku në krahë me ne për nga standardet e jetesës dhe mirëqenia ekonomike, nuk kanë një ligj për rininë.

Siç thuhet edhe këtu, ky ligj nuk synon përafrimin me *acquis communautaire* të Bashkimit Europian, pra nuk është kërkesë e autoriteteve europiane që ne të kemi një ligj për rininë. Atëherë, pse bëhet një propozim i tillë nga qeveria socialiste? Kujt i shërben ky ligj? Këtë duhet të kuptojnë të rinjtë shqiptarë sot që të mos gënjenen nga pallavrat e shkruara në projektligj.

Po ju lexoj vetëm një paragraf nga projektligji: “Përmes këtij projektligji përcaktohen qartësisht roli dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse, institucioneve përkatëse dhe strukturave të tyre përkatëse në nivel qendror e vendor për mbrojtjen dhe fuqizimin e të rinjve”.

Të dashur të rinj,

Gjatë konsultimeve që ka pasur ministria, por edhe ne në parlament me grupet e interesit, pra me organizatat përfaqësuese të të rinjve në Shqipëri, ka pasur shumë ankesa dhe kundërshti, sepse mendimet dhe propozimet e tyre nuk janë marrë parasysh.

Së pari, propozimi nuk ka ardhur nga baza. Këto janë disa nga ankesat e grupeve të shoqërisë civile që mbulojnë të drejtat e të rinjve, të cilat na janë adresuar edhe neve si deputetë të opozitës.

1. Propozimi nuk ka ardhur nga baza, por nga ministria e linjës. Pra, flasim për një diktim *top down* nga koka e poshtë për masat që duhen marrë për përmirësimin e sektorit të të rinjve.

2. Procesi i hartimit dhe i konsultimit të ligjit është kryer në një kohë relativisht të shkurtër, rekord, për rrjedhojë, ka mospërfshirje substanciale të zërit rinor dhe të grupeve të

interesit në të gjithë vendin në hartimin e një ligji të tillë.

3. Organizatat rinore janë ankuar se kontributi dhe mendimet e tyre nuk janë marrë parasysh në hartimin e këtij projektligji.

Për ta thjeshtuar pak debatin: çfarë ndodh me këtë projektligj, të nderuar të rinj? Trajtohet rinia, pra trajtoheni ju, si një grup i marginalizuar, ndërkohë që të gjithë e dimë se ku i ka problemet rinia. Rinia ka nevojë për arsim cilësor, për punë, për punësim, për mundësi përfaqësimi. Sipas të njëjtit studim, që përmendi edhe zoti Lita nga “Fridrih Herbert”, 54% e të rinjve shqiptarë nuk kanë besim se do të gjejnë një punë dhe një përqindje shumë e madhe e tyre dëshirojnë që të largohen nga vendi me mbarimin e studimeve. Shumica e të rinjve shqiptarë, siç e dini shumë mirë ju, të rinj, se nuk kemi kë të gënjejme këtu, më shumë vëmendje dhe investim i kushtojnë mësimin të lëndës së gjermanishtes sesa ndonjë lëndë tjetër në universitet. Ja pra, ky është bilanci i qeverisë socialiste, i Rilindjes Socialiste të Shqipërisë!

Ky ligj, të nderuar të rinj, nuk merret me thelbin e problemit, punësimin. Në asnjë moment në këtë ligj nuk përmendet fjala “punësim”. Edhe ato vende të Bashkimit Europian që kanë legjislacion për rininë, e kanë atë nën emërtimin e ligjit për punësimin e të rinjve, jo thjesht një ligj për rininë. Ky ligj synon ngritjen e një arkitekture burokratike për të futur në politikëbërje të rinjtë shqiptarë.

Pra, pak a shumë në gjykimin tim, ky ligj përmes strukturës burokratike hierarkike shtetërore, që propozohet, synon ta kthejë vendin 30 vjet pas, në modelin e organizatave rinore komuniste, duke i trajtuar të rinjtë si militantë të shtetit. Kuptohet, një qeveri që i ka të gjitha pushtetet sot, edhe pushtetin lokal, pse do të propozonte struktura hierarkike të varura nga shteti në nivel qendror dhe në nivel lokal? Kush e ka qeverinë qendrore sot? Partia Socialiste. Kush i ka 61 bashkitë sot? Partia Socialiste.

Të zgjedhurit e Partisë Socialiste do të diktojnë fondet dhe të do të favorizojnë organizatat që do të merren me të drejtat dhe përfaqësimin e të rinjve.

Të dashur të rinj shqiptarë,

Kjo qeveri nuk e çan kokën për ju, fare, kjo qeveri kujdeset për korporatën, kjo qeveri kujdeset për tepsinë, kjo qeveri kujdeset për

kazanin. Këto janë fjalë të Kryeministrit Edi Rama, i cili në vitin 2017 doli përpara jush për të bërë fushatë elektorale për të fituar zgjedhjet. I fitoi. Hallin nuk e kishte te rinia, sepse nuk doli me asnjë propozim konkret për rininë, hallin e kishte te tepsia. Po sot që nuk e ka aleatin e tij dhe tepsinë e ka 100% për vete, kush ia ka fajin Edi Ramës? Më thoni ju, kush ia ka fajin Partisë Socialiste për këtë gjendje të mjerueshme ku gjendet rinia shqiptare? Kush ia ka fajin, Berisha, Ilir Meta, LSI-ja, PD-ja? Tepsinë e keni për vete.

Të dashur të rinj,

A e dini se çfarë po mundohet të bëjë Partia Socialiste? Po mundohet ta fusë rininë në një enë tjetër, e cila e ka emrin "legen", për ta legenizuar më tepër atë pjesë militante të rinisë shqiptare, e cila do të mbesë në këtë vend, duke marrë parasysh ata qindra dhe mijëra të rinj që do të largohen nga vendi me të gjetur mundësinë e parë sapo të mbarojnë studimet.

Cila është strategjia socialiste, të nderuar të rinj? Është largimi i të rinjve, shpopullimi i këtij vendi nga të rinjtë dhe grumbullimi i atyre që mbeten nën një kupolë shtetërore që funksionon si korporatë politike socialiste. A e dini se cili është problemi sot, të nderuar miq, qytetarë dhe kolegë? Vendi është mbushur plot me tregtarë të shpresës. Këta kanë 28 vjet që tregtojnë shpresën, kanë 28 vjet që bashkërisht, të dashur të rinj, tregojnë shpresën tuaj për një të ardhme më të mirë, për një të ardhme europiane, për një Shqipëri, të cilën që nga viti 1991 e donim si gjithë Europa. 28 vjet më vonë, me paturpësinë më të madhe, grupe politike që gjenden në rrugë flasin ende për Shqipërinë si gjithë Europa dhe për ture shprese, sepse kanë dalë dhe duan të dalin nëpër qytetet e Shqipërisë për të tregtuar shpresën tuaj, për të luajtur me ndjesinë e shpresës.

Ajo që ju duhet të kuptoni dhe ta keni të qartë, të nderuar të rinj, është që këta tregtarë, që mbajnë kyçur sistemin zgjedhor, nuk kanë se çfarë të tregtojnë tjetër përveç shpresës, por edhe shpresën, siç ju e dini, jua kanë vuarë. Shpresën e të gjithë shqiptarëve po e vrasin dita-ditë përmes monopolizimit të tepsisë, përmes goditjes së kazarit dhe përmes legenizimit të të gjithë procesit zgjedhor demokratik në Shqipëri.

Të nderuar socialistë,

Të nderuar kolegë,

Po ua bëni këtë vend të rinjve shqiptarë të pajetueshëm dhe të padurueshëm. Është e turpshme që ne sot flasim për një ligj për rininë, ndërkohë që rinia e ka humbur shpresën dhe është në kërkim të shanseve të tjera jashtë vendit, ndaj edhe beteja jonë do të vazhdojë për sistemin zgjedhor, sepse tek ai sistem zgjedhor ne do të arrijmë të hapim dyert për përfaqësimin dinjitoz të të rinjve shqiptarë për t'u futur në politikë dhe për t'i marrë vete vendimet e tyre, jo kështu si militantë partie.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Gjoni!

Fjalën e ka deputeti Zef Shtjefni.

Të përgatitet deputetja Artemis Dralo.

Zef Shtjefni – Zoti Kryetar,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot po diskutojmë projektligjin për rininë. Ky projektligj vjen tani, ndërkohë që rinia e këtij vendi ka ikur në emigracion, pasi këtu nuk ka as punë dhe asgjë për t'u ofruar të rinjve shqiptarë, por edhe të rinjve shqiptarë në diasporë.

Kjo është një demagogji e gjallë, prandaj ky projektligj bëhet tani për të favorizuar disa bashki të vendit, të cilat tashmë i keni fituar dhe kërkoni të shtoni disa organika të reja që nesër t'i përdorni për vota në zgjedhjet e ardhshme.

Kjo nuk mund të funksionojë. Ky vend nuk ka pasur asnjëherë ligj për rininë, sepse ka pasur një ministri që mbulonte veprimtarinë e të rinjve, gjë që ka funksionuar gjithmonë, pasi shteti shqiptar ka pasur edhe dikastere të tjera që bënin politikat orientuese të të rinjve shqiptarë. Kjo bëhet për të ngritur struktura të tjera vendore dhe qendrore dhe për ta fryrë sa më shumë këtë organikë me hapje të reja vendesh pune, por, në fakt, ajo do të përdoret si strukturë për zgjedhjet e ardhshme.

Ky është një projektligj me fjalë boshe, i cili nuk i shërben vendit, por u shërben vetëm juve, pasi keni vendosur që forumin tuaj rinor ta shpërndani nëpër bashkitë e vendit dhe t'u jepni paga. Pra, çdo gjë është nën kontroll dhe kjo nuk diskutohet më.

Bashkitë e vendit nuk e kanë të nevojshme gjetjen e objekteve për rininë, për argëtim apo objekte çlodhëse, pasi çdo bashki në vend ka shtëpi kulture dhe këto shtëpi duhet të përdoren për aktivitetet që kryhen në këto zona, duke u vënë në dispozicion të rinisë.

Ju duhet të mendoni se si t'ua bëni jetën më të pasur dhe më të pandotur qytetarëve dhe rinisë shqiptarë aty ku ata jetojnë dhe në këtë mënyrë përfituesit do të ishin qytetarët shqiptarë dhe rinia bashkë me ta, ndërsa ju vazhdoni të shpikni ligje që ju hyjnë në punë vetëm juve dhe njerëzve tuaj. Kjo gjë nuk mund të bëhet.

U bëj thirrje të gjithë këshillave bashkiakë që të mos miratojnë asnjë fond për punësim në kuadër të këtij ligji, i cili bëhet vetëm për të favorizuar të rinjtë që ju përfaqësoni.

Ju bëni sikur do ta drejtoni Shqipërinë edhe për shumë vite të tjera, por gaboheni. Ky projektligj nuk thotë asgjë, por vetëm favorizon njerëzit dhe të rinjtë tuaj nga mosha 15 deri 29 vjeç. Ju nuk keni dhënë asnjë gjë për fëmijët që lindin, keni vite që nuk keni paguar fondin për ta, ndërsa tani kërkon të dërgoni para në organizatat dhe rrjetet tuaja rinore që ju i krijoni brenda natës.

Unë nuk jam dakord që paratë e shqiptarëve të përdoren për buxhete zgjedhore në forma të ndryshme, të cilat vetëm ju i dini.

Ju thoni që këshilli vendor i rinisë është organ këshillimor pranë kryetarit të bashkisë. A e kuptoni se çfarë doni të thoni? Kryetari i bashkisë ka punë të tjera për të bërë dhe nuk ka kohë të merret edhe me problemet e të rinjve.

E pra, këta të rinj do të punësohen, por problemi im nuk është punësimi i 4 apo 6 të rinjve në bashkitë e vendit, por problemi që mua më shqetëson është kapja e gjithë zinxhirit komandues që kryeson strukturat qendrore dhe vendore të shtetit. Ju edhe shoqatat i keni kapur, ndërsa tani po hapni fonde për strukturat rinore në mënyrë që t'i paguani vetëm me ligj.

Zgjedhjen e këshillit vendor duhet ta bëjë këshilli bashkiak, kjo është mëse e qartë. Ju e dini që kjo strukturë bëhet vetëm tani që keni bashkitë në të gjithë vendin, sepse po të kishte këshilla bashkiakë shumëpartiakë, formula juaj do të rrëzohej direkt.

Burimet e financimit ju i keni nga buxheti i shtetit, nga buxhetet vendore, siç thoni ju, nga të ardhurat e gjeneruara nga organizatat rinore, por ato janë zero lekë, sepse askush nuk paguan asnjë lek. Donacionet, të cilat i dini mirë se kush i financon dhe sponsorizimet po ashtu i keni po ju, sepse vetëm juve u shërben ngritja e strukturave të reja.

Keni folur në fillim të projektligjit për rininë e diasporës, por më pas keni harruar ta përmendni. Qëllimi i këtij projektligji është vetëm ngritja e strukturës rinore të partisë suaj, e cila ka kohë që nuk funksionon, ndërsa tani e gjetët mënyrën se si do të funksionojë, duke punësuar disa të rinj në bashkitë e vendit me ligj. Kjo do të jetë e pafalshme dhe nuk do të funksionojë në asnjë bashki, sepse do të degradojnë gjatë rrugës.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Shtjefni!

Fjala për deputeten Artemis Malo.

Të përgatitet Reme Lala.

Artemis Malo (Dralo) – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Unë jam shumë e kënaqur që sot në parlament kemi për diskutim një projektligj të tillë, të një specifike të veçantë për nga rëndësia, por njëkohësisht ndiej çudi dhe më duket ironike se si kolegët e opozitës deklarojnë abstenim me dëshirë të mirë ose janë kundër këtij ligji, por me dëshirë të mirë. Ky projektligj për rininë do t'u shërbejë më shumë se 700 mijë të rinjve sot në Shqipëri, të cilët nuk kanë asnjë ngjyrim politik, sepse asnjë ligj nuk është për grupe të caktuara me ngjyime politike. Pra, është projektligj për të gjithë rininë shqiptare, duke filluar nga mosha 15 deri në 29 vjeç dhe vjen si një përgjigje ndaj nevojave të tyre, më së shumti si adresim i sfidave të këtij brezi të ri për të ardhmen. Kjo e sotmja duhet shënuar si ditë e veçantë, e cila do të mbetet gjatë në kujtesën tonë, si ligjvënës, por kryesisht tek të rinjtë shqiptarë, të cilët mbështeten për herë të parë nga qeveria e tyre dhe nga kjo maxhorancë me një akt të vërtetë dhe shumë të rëndësishëm për të ardhmen.

Më lejoni, të nderuar kolegë, të sqaroj se për më shumë se 20 vjet shoqëria civile, rinia dhe komuniteti i atyre njerëzve, që punojnë me të rinjtë, e kanë kërkuar këtë ligj si një mbështetje të domosdoshme për të fuqizuar rininë. Kanë qenë vite të vështira dhe me sfida në fushën e rinisë dhe sigurisht një fushëveprimi që nuk ishte marrë kurrë më parë kaq seriozisht dhe asnjëherë më parë nuk ka pasur një mbështetje të tillë ligjore. Por erdhi koha dhe kjo kërkesë e kahershme finalizohet sot me votimin e këtij projektligji në parlamentin shqiptar.

Të nderuar kolegë dhe ju kolegë të opozitës, ju ftoj të përqafoji nisma të një rëndësie kaq domethënëse, duke lexuar mirë çdo paragraf të këtij projektligji para se të bëni deklaratat tuaja të hapura kaq agresive.

Nevojat për të pasur një projektligj për rininë kanë qenë të lidhura kryesisht me financimin e këtij sektori, por me kohën dhe me sfidat e kësaj epoke, elementet përbërëse të tij nuk kanë të bëjnë vetëm me financimin, po edhe me disa rregullime shumë të rëndësishme të sektorit dhe formalizimin e tij në rang kombëtar. Të rinjtë janë ata që kanë nevojë, në radhë të parë, për këtë projektligj, për të pasur më shumë mundësi edukimi, formimi, mbështetjeje, për të marrë pjesë në vendimmarrje, për t'u dëgjuar zëri i tyre, për të pasur më shumë qendra rinore, ambiente kreative, për të rritur eksperiencat e tyre aty ku jetojnë, por edhe për të pasur shërbimet që i nevojiten një të riu në çdo cep të Shqipërisë.

Nga ana tjetër janë edhe organizatat rinore, që punojnë për të rinjtë, të cilat kishin nevojë emergjente për të pasur një mbështetje të tillë ligjore, për të formalizuar dhe për të fuqizuar punën e tyre, me qëllim që t'u japim këtyre organizatave një rëndësi të veçantë, duke hapur një sektor krejtësisht të ri në fushën e shoqërisë civile dhe të edukimit joformal. Po njësoj kishte nevojë edhe qeveria si një instrument ligjor, që do të japë një mbështetje shumë më të madhe ndaj këtij sektori, që ai të ketë mekanizmat dhe institucionet e duhura me fuqi të plotë dhe kompetenca për të zhvilluar dhe për të monitoruar nga afër politikën rinore. Por edhe institucionet lokale, pra bashkitë, përveçse detyrimit që t'u përgjigjen kërkesave të të rinjve në territorin e tyre, do të kenë edhe mbështetjen e qeverisë për të realizuar objektivat dhe misionin, që parashikohen në këtë akt.

Është e natyrshme që sa herë diskutohet për një projektligj elementi bazë është financimi. A do të ketë ndikim në buxhet, a do të harxhojë para nga buxheti i shtetit? E pyetje të tilla me radhë. Por përtej këtyre pyetjeve duhet të pyesim edhe veten, a duhet vërtet të jenë në diskutim paratë, kur bëhet fjalë për të rinjtë dhe për të ardhmen e tyre? Unë mendoj se jo, megjithëse ndikimi vjetor që do të ketë në buxhet investimi për të rinjtë është krejtësisht i pakrahasueshëm me ndikimin që zbatimi i ligjit do të japë në

realitet. Ky projektligj e mundëson këtë, për herë të parë do të mbështesë financimin direkt të projekteve, programeve dhe politikave rinore, financimin direkt të organizatave rinore në të gjithë Shqipërinë. Tashmë e tutje organizatat tona nuk do të jenë më vetëm në varësinë e kontributeve të donatorëve të jashtëm, të cilët, në fakt, ndryshojnë dhe nuk janë të qëndrueshëm vit pas viti, por do të kenë mbështetjen e sigurt dhe të plotë të qeverisë shqiptare, që do të zhvillojë vazhdimisht projekte, programe dhe aktivitete rinore.

Të rinjtë shqiptarë, me miratimin e këtij akti, do të përfitojnë mundësinë në një kohë të shkurtër, në çdo bashki, investime për infrastrukturën rinore, siç janë qendrat rinore, hapësirat sportive, bibliotekat dhe ambiente të ndryshme rekreative, ku të rinjtë tanë mund të zhvillohen dhe të marrin shërbimet e tyre.

Është e domosdoshme që me ndarjen e re territoriale shërbimet për të rinjtë dhe infrastruktura të jenë të shtrira në çdo bashki, aty ku ata jetojnë.

Duke qenë që në hapat e parë të profesionit tim përherë pranë rinisë dhe nevojave të tyre, si pedagogë dhe si nënë, nuk mund të mos e përgëzoja sot këtë nismë me shumë krenari, që më në fund të rinjtë, pavarësisht se në cilin qytet jetojnë, do të marrin trajtim dhe mbështetje të barabartë nga qeveria shqiptare në bashkëpunim me bashkitë.

Ky projektligj mbështet pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse të vendit si në rang lokal, ashtu edhe qendror. Në projektligjin e ri do të kemi për herë të parë Këshillin Kombëtar të Rinisë dhe Këshillin Vendor të Rinisë, të cilët në sinergji me njëri-tjetrin do të mundësojnë pjesëmarrjen direkte të të rinjve në vendimmarrje si në bashki, ashtu dhe në qeveri.

Rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i Organizatës Përfaqësuese Rinore Kombëtare, si një organizatë ombrellë, e cila do të mbledhë brenda saj të gjitha këto organizata rinore dhe ato që punojnë me të rinjtë për të zbatuar më mirë politikën rinore, prioritetet, strategjinë e rinisë për t'i përfaqësuar denjësisht të rinjtë shqiptarë dhe organizatat e tyre në rang ndërkombëtar.

Ky projektligj është konsultuar gjerësisht me të rinjtë shqiptarë në të gjithë Shqipërinë në një tur në 12 qarqe dhe me pjesëmarrjen e mijëra të rinjve dhe organizatave rinore, të cilat kanë

dhënë mendimin e tyre për këtë draft, që kemi përpara, dhe kjo është shumë e rëndësishme për të arritur të një projektligji i mirë, i cili vjen si një adresim direkt i nevojave të të rinjve, duke kaluar pa dyshim në filtrin e ekspertëve.

Në fund më lejoni të them se, sigurisht, ky projektligji nuk është zgjidhja përfundimtare e sfidave, që kanë të rinjtë shqiptarë sot, por është një gur themeli, që vendoset një herë e mirë në sektorin e politikave rinore të shtetit shqiptar, ku fillon një rrugëtim i gjatë për të fuqizuar të rinjtë shqiptarë, për të mbështetur talentet e tyre dhe për t'i bërë në një kohë më të shpejtë të barabartë, në mundësi dhe në edukim, me të rinjtë europianë.

Ju ftoj, të nderuar kolegë, ta votoni dhe ta përqaftoni këtë nismë!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Dralo!

Fjalën e ka Reme Lala. Nuk është.

Fjalën e ka Artur Roshi.

Të përgatitet Arben Elezi!

Artur Roshi – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Projektligji për rininë, që ka ardhur sot në parlament, është një nismë e mirë, të thuash, e qeverisë, por e përciptë. Bie në sy që ai nuk është këshilluar me grupet e interesit. Rinia është pjesa më vitale e një kombi, më energjikja, por edhe më e papërvojë, prandaj ka nevojë për politika sociale, që t'i ndihmojnë ata të përballen me problemet e punës dhe të përditshmërisë së jetës së tyre, politika që kurrsesi nuk mund të bëhen pa pyetur të rinjtë dhe pa marrë parasysh nevojat e tyre. Politikat sociale për të rinjtë ndryshojnë jo vetëm nga politikat e të rinjve në vende të tjera, por duhet të ndryshojnë edhe nga njëra bashki në tjetrën, sepse problemet me të cilat përballen të rinjtë janë të ndryshme në zona të ndryshme.

Vitet e fundit ne kemi pasur një hemorragji të të rinjve, sepse nuk u kemi dhënë shpresë, jetesë më të mirë, punë dhe arsimim cilësor. Për këtë rrjedhje të të rinjve shteti duhet të ndërhyjë me politika të qëndrueshme dhe strukturore të studiuara mirë. Ky projektligji nuk prek thelbin e problemeve të të rinjve tanë, ai nuk e ndal dot largimin e tyre. Në projektligji përmenden shpesh togfjalëshat: “Zonë e sigurt, mjedis i sigurt”, por çfarë nënkuptojnë këta terma, kur ne nuk kemi siguruar ende një zonë sigurie në gjimnazet e Tiranës, ku më lehtë mund të sigurosh cigare

hashashi sesa një laps?! Çfarë sigurie mund t'u ofrojmë të rinjve, me të cilët ligji nënkupton moshën nga 15 në 29 vjeç, kur ne nuk kemi siguri me atë që ndodh me të rinjtë brenda dyerve të këtyre shkollave?

Mendoj se një nga komponentët e kësaj krize ekonomike e morale, që po kalon shoqëria jonë, nuk është vetëm kriza politike për shkak të mungesës së dimensionit kryesor të demokracisë, pra të votës së lirë, por është edhe mospasja e një prioriteti kombëtar të arsimit për çdo qeveri që vjen.

Mit'hat Frashëri thoshte: “Nëpërmjet diturisë bëjmë të mundur zhvendosjen e varfërisë”. Nëse shkollat vazhdojnë ende me plane mësimore abstrakte, ku teoria qëndron në ishull më vete nga praktika, sigurisht nuk është ky edukimi që duhet për të ndihmuar në integrimin e këtyre të rinjve në tregun e punës. Tekstet dhe mësimdhënia e dobët kanë bërë që të rinjtë të mos mësojnë gati asgjë dhe ajo që ka më tepër rëndësi sot është të luftojmë injorancën, e cila është një sëmundje kombëtare, që ende nuk na është shqitur. Fëmijët tanë mësojnë në filozofi idetë e Marksit, por në asnjë rresht të librit nuk u tregohet se këto ide të zbatuara në politikë sollën diktaturë dhe çuan në vrasjen e miliona njerëzve kudo në botë. Vrasja dhe diktatura fatkeqësisht vazhdojnë të jetojnë me jetët e njerëzve të pafajshëm ende në disa vende të botës. Çfarë u thuhet të rinjve për idetë e mbinjeriut niçean, të cilat Hitleri i përdori për të provuar racën e pastër arjane, në emër të së cilës u sakrifkuan tërësisht hebrenjtë? Asgjë.

Shkolla, e cila duhet të jetë dritarja më e madhe, nga duhet të hyjë dija në mendjen e fëmijëve tanë, nuk u mëson asgjë për idetë e majta dhe të djathta politike, për ndasitë e tyre dhe filozofët që i përfaqësojnë. Nga ana tjetër, ne nuk i kemi ende të ndaluar me ligj idetë dhe simbolet komuniste e as ato fashiste. Atëherë, si mund të pretendojmë të kemi zona të mbrojtura brenda organizatave rinore, të cilat në këtë amulli dhe zbrazëti që krijon shkolla dhe mungesa e ligjeve, që ndalojnë disa lloj organizatash, mund të kthehen në organizata terroriste apo në celula të tyre?! Prandaj do të ishte më mirë që të rinjtë, me mundësitë financiare, që parashikon buxheti i shtetit, të krijonin programe pranë partive politike, të cilat i zgjedhin ata vetë, të jenë të njohura dhe ta kenë

publike veprimtarinë e tyre, si dhe të mbajnë përgjegjësi ligjore për këto veprimtari.

Me fondin e buxhetit mund të krijohet një program edhe këtu në parlament, ku deputetët mund të krijojnë stafet e tyre të vogla me këta të rinj, të cilëve u interesojnë politika dhe ligjet. Të rinjtë sot kanë nevojë për shpresë, kanë nevojë të arsimohen dhe të edukohen, ata duhet të mësohen me faktin që vota e tyre vlen, numërohet dhe shërben për të ndryshuar jetën e tyre. Ata duhet të nxiten me bursa nga buxheti i shtetit, por ekselencia nuk është vetëm pronë e shkollave shtetërore, siç sillet qeveria sot, ajo duhet trajtuar njëllëj edhe kur vjen nga shkollat private. Kriteret e bursës duhet të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit. Shkollat private i ka akredituar e njëjta ministri që kontrollon edhe shkollat publike. Të rinjtë kanë nevojë për politika punësimi, nuk mund t'u kërkojmë atyre të mbajnë organizata me kontributet e tyre dhe të punojnë si vullnetarë. Vullnetarizmi që shërben te komuniteti është një e mirë e padiskutueshme, por nuk mund t'ua kërkojmë të rinjve, xhepat e të cilëve janë bosh, ndërsa nevoja, kërkesat dhe dëshirat e moshës që kanë janë të mëdha.

Vullnetarizmi nuk u njeh atyre asnjë të drejtë të tipit “karta e studentit apo e të rinjve”, që duhet t'u ofrojnë atyre disa shërbime falas, madje asnjë certifikatë për të aplikuar në shkollat e larta nuk ua ofron vullnetarizmi. Vullnetarizmi i tyre diku duhet paguar! Të rinjtë pa eksperiencë pune e kanë të vështirë punësimin, prandaj politikat sociale në ndihmë të të rinjve duhet të kompensojnë pagën e ulët të tyre, që mund t'u ofrojnë një biznes privat ku ata mund të aplikojnë me dëshirën e tyre dhe ky biznes të mos paguajë sigurimet për këta të rinj, por t'i marrë përsipër shteti.

Shteti duhet të njohë të drejtën e praktikës. Një student duhet të bëjë praktikë pranë një biznesi, për aq kohë sa ka dëshirë dhe mundësi. Por sot biznesi nuk mund t'ia afrojë këtë mundësi, sepse ka kosto. Biznesi duhet ta sigurojë këtë student edhe sikur të paraqitet në punën një herë në javë. Cili biznes do t'ua jepte mundësinë të rinjve të bëjnë praktikë në këto kushte? Të rinjtë kanë nevojë për shpresë dhe shpresën nuk mund t'ua japë një ligj që nuk hyn në thelb të problemeve të tyre, nuk konsultohet me ta dhe nuk siguron mbrojtjen për të cilën ata kanë nevojë. Në këtë ligj fasha e të rinjve figuron

që nga moshë 15 vjeç, kur ata janë ende të mitur, pra ne nuk mund të bëjmë një format ligjor me këto grupmosha, nga 15 deri në 29 vjeç. Prandaj unë ju ftoj që ta shtyjme këtë ligj ose ta rrëzojmë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Roshi!

Fjalën e ka Arben Elezi. Të përgatitet Elda Hoti.

Arben Elezi – I nderuar drejtues i seancës, Të nderuar kolegë deputetë, Të dashur qytetarë,

Në projektligjin “Për rininë”, që ka propozuar qeveria, thuhet se qëllimi është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të rinisë dhe financimi i veprimtarive rinore. Në këtë projektligj thuhet se kjo bëhet në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti. Po, është e vërtetë që të rinjtë kanë të drejtë dhe duhet që një orë e më parë t'u krijojmë kushtet.

Nga ana tjetër, është po aq e vërtetë që qeveria nuk e ka atë shqetësim, sepse, në rast se do të ishte e shqetësuar për të drejtat e rinisë, atëherë do ta kishte bërë këtë vend të jetueshëm për ta, do të kishte injektuar shpresën dhe jo pesimizmin, do të kishte krijuar mundësi për të rinjtë dhe nuk do t'i kishte injoruar ata.

Ligji për arsimin e lartë, i miratuar nga kjo qeveri, mungesa e kushteve në auditore, ngritja e çmimeve për studentët, rënia e cilësisë së mësimdhënies, korrupsioni në fakultete, bëri që studentët të shpërthejnë në protesta përpara një viti. Po çfarë bëri qeveria për të lehtësuar sadopak situatën e rinisë studentore? Në vend që të reagoonte me investime dhe reforma të shpejta që studentët të ndjenin ndikimin e saj në përmirësimin e gjendjes së fakulteteve, qeveria me strukturat e saj rinore të partisë u mundua ta sabotojë protestën e tyre. E gjithë struktura rinore e Partisë Socialiste, madje edhe ajo jorinore, vrapuan në mënyra të ndryshme që të sabotojnë protestën e tyre të ligjshme. Studentët u gjendën përballë presionit për ardhjen e tyre në auditore dhe deri te presioni ndaj prindërve të tyre për largim nga puna. Kjo ishte shumë e turpshme.

Qeveria ka një kontribut të padiskutueshëm në ëndrrën e vetme të të rinjve shqiptarë sot, dëshirën për t'u larguar nga vendi një orë e më parë, sepse në vend të aspiratave të të rinjve, ka përmbushur aspiratat e ushtarëve të bindur të

partisë. Deri tani këtë gjë e ka bërë në mënyrë të paligjshme, duke u dhënë militantëve të saj favore që nuk u takojnë, në kundërshtim flagrant me meritën dhe aftësinë, ndërsa me këtë projektligj, ky aktivitet i mbrapshtë qeveritar synohet të bëhet i ligjshëm, sepse rinia jonë do të jetë e varur nga qeveria dhe partia.

Ky projektligj është një thirrje e paligjshme dhe antikushtetuese, që të gjithë të rinjtë që duan të organizojnë ndonjë aktivitet t'u bashkohen organizatave rinore të Partisë Socialiste. Kjo vetëm e vetëm që ata të kenë financime nga buxheti i shtetit, sepse i gjithë procesi i organizimit të rinisë në organizata rinore parashikohet të mbikëqyret e të drejtohet nga ministri dhe kryetari i bashkisë. Të dyja këto pushtete, pra ai qendror dhe ai lokal, janë në duart e socialistëve.

Potenciali i rinisë ka nevojë të mbështetet dhe jo të formësohet e të drejtohet politikisht. Kështu, rinia shndërrohet në një hallkë plotësuese të sistemit, siç ishte në kohën e Enverit dhe humbet rolin e saj për të sjellë ide të reja, energji dhe emancipim. Të politizosh rininë në këtë mënyrë, përveçse është e dëmshme, është edhe e turpshme. Prandaj ftoj të gjithë deputetët e opozitës, por jo vetëm, që të votojnë kundër këtij projektligji.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Elezi!

Fjalën e ka Elda Hoti.

Elda Hoti – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Për mua rinia ka qenë kryefjalë në çdo seancë, kur kam folur përpara jush, të nderuar kolegë dhe qytetarë shqiptarë, si të jem pjesë e tyre. Rinia ka forcë, ka ëndrra dhe dëshira, por në Shqipëri ka më shumë probleme.

Unë e ndiej si detyrim të ngre zërin për një çështje madhore që ka tronditur të gjithë opinionin publik. Bëhet fjalë për rastin e transmetuar në emisionin “Le iene”, që transemtohet në Mediaset, për të miturin Alvin Berisha, i cili ndodhet ende në kampin “Al Hol” në Siri.

E nderuar zonja Ministre Spiropali, si ka mundësi të thoni se keni kontaktuar me shërbimet e Kosovës, kur Bedri Elezi, i cili po merret me riatdhesimin e kosovarëve të tjerë të

mbetur në Siri, thotë se asnjë nga qeveria shqiptare nuk ka kontaktuar me të?

Kampi “Al Hol” është një vend i pisët, i mbipopulluar me njerëz, të cilët përballen me mungesën e ushqimeve, ilaçeve dhe kushteve elementare të jetesës. Sipas informacioneve, dhjetëra fëmijë e gra shqiptare mbahen peng dhe janë në kurthin e luftës në Siri.

Alvin Berisha dhe fëmijët Dumani rezultojnë të rrëmbyer në skadat e Interpolit. Pra, bëhet fjalë për të mitur, për fëmijë shqiptarë jetim që ndodhen në vështirësi në një zonë lufte.

Aleatët tanë amerikanë kërkojnë tërheqjen dhe largimin e çdo shqiptari nga ky konflikt.

Në bazë të nenit 8 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, qeveria ka detyrimin të mbrojtë dhe të kujdeset për shtetasit shqiptarë edhe kur ata janë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Por dashuria dhe vëllazëria e Kryeministrit me Presidentin Erdogan, i ka errësuar gjykimin dhe e ka larguar nga detyrimi për t'u kujdesur për shtetasit e tij, të cilët po bëhen viktimat e një lufte terroriste.

Si është e mundur që Kryeministri, ministri dhe zëvendësministrat u prononcuan se nuk kanë referentë nga pala kurde? Si është e mundur që Kryeministri i një vendi në NATO, nuk e di që SDF dhe YPG kanë 8 vjet që janë në krah të forcave të NATO-s dhe kanë përfaqësitë e tyre në të gjithë kryeqytetet e Europës? Përse është kaq e vështirë t'i riatdhesoni, kur Presidenti Donald Trump ka thënë se shtetet duhet të tërheqin qytetarët e tyre nga kampet kurde në Siri?

Zoti Kryeministër, përfaqësues të Ministrisë së Jashtme dhe të Ministrisë së Brendshme, përpara se të jepni shpjegim, hiqni dy aleatët që keni përmendur, se po talleni me inteligjencën e shqiptarëve, sepse nuk dua ta besoj se jeni kaq të painformuar sa të anashkaloni faktin se armiku kryesor i kurdëve është Turqia. Edhe pas tërheqjes së trupave amerikane, që kanë pasur mbështetjen e forcave kurde në luftën kundër ISIS, ky opsion ra poshtë.

Zoti Kryeministër, ministra dhe zëvendësministra, më thoni nëse në këto dy javë keni kontaktuar me autoritetin kurd SDF/YPG?

Zoti Kryeministër, a keni pasur ndonjë kontakt me përfaqësuesin special të Kombeve të Bashkuara për Kurdistanin, zotin Sokol Kondi, i

cili mund të ishte ndërmjetësi për të marrë fëmijët shqiptarë nga kampi?

Pas marrëveshjes mes ushtrisë së rregullt siriane dhe forcave kurde SDF/YPG, administrata e kampit po u kërkon shteteve të tërheqin shtetasit e tyre, meqenëse ishit ankuar se nuk kishit referent. Në këta 18 muaj ju keni pasur kohë të veproni, por, me sa u kuptua nga deklarata që bëtë ju dhe zyrtarët tuaj, nuk është bërë asgjë. Çfarë hapash konkretë keni marrë nga data që u publikua rasti i Alvin Berishës në emisionin “Le iene”? Uroj që në emisionin tjetër “Le iene” të flasë për një qeveri që kujdeset për shtetasit e vet dhe që merr përgjegjësi morale e ligjore për fëmijët e mitur të braktisur në atë kamp.

Në rastin pozitiv, kur këta fëmijë e gra të riadhesohen, a keni marrë masa që të rehabilitohen dhe të integrohen?

Shqipëria pranon të marrë 3 mijë muhaxhedinë iraniane, por nuk ndërmerr asnjë hap konkret për të kthyer në atdhe fëmijët shqiptarë.

Gramoz Ruçi – Zonja Hoti, ju kujtoj se sipas Rregullores...

Elda Hoti – Që qeveria shqiptare...

Gramoz Ruçi – Zonja Hoti, një sekondë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Hoti, të është ndërprerë fjala.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Hoti, interpelanca ka mbaruar. Nëse ju vazhdoni të shpreheni për interpelancën, kjo tregon që ju nuk keni respekt për atë që autorizuat të bëjë interpelancën. Kemi ligjin për rininë, prandaj sipas Rregullores...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Ministre, si nismëtare, a keni ndonjë gjë lidhur me problematikën e ngritur nga opozita?

Besa Shahini – Të nderuar deputetë të opozitës, unë u trondita pak nga përshkrimet tuaja dramatike të projektligjit për rininë, ku shkuat edhe te mundësia për themelimin e organizatave terroriste përmes këtij ligji, por nuk u çudita, sepse duket se nuk e keni lexuar ligjin dhe as dokumentet e tjera përcjellëse që përshkruajnë të gjithë rrugëtimin e ligjit deri këtu.

Kritikat janë të mirëpritura, por deformimet e tejskajshme që i bëhen projektligjit këtu janë të

panevojshme dhe pa dashur t’ju them se si duhet ta bëni punën tuaj, është mirë të përmbaheni.

T’i marrim me radhë disa nga keqinterpretimet tuaja, ku një pjesë ishin të qëllimshme, ndërsa disa jo, dhe do të mundohet t’i jap një drejtim më real.

Zonja Hajdari përmendi parlamentin rinor, i cili rregullohet apo themelohet me ligjin për rininë.

Dua t’ju informoj që te ligji për rininë nuk përmenden fare fjalët “parlament rinor” dhe ligji nuk themelon parlament rinor. Ne si Ministri e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kemi nisur një nismë që themelon parlamentin e nxënësve, me nxënës nga arsimit 9-vjeçar dhe shkollat e mesme, ku ne do të kemi mundësi të testojmë nismat tona me ata dhe ata do të kenë mundësi ta ngrenë zërin për çështje që u interesojnë, por nuk lidhet fare me ligjin për rininë.

U përmend punësimi, i cili nuk adresohet në këtë ligj. Ekziston ligji për nxitjen e punësimit, prandaj nuk mund të ketë një ligj tjetër që i mbivendoset atij ligji.

Në kuadër të Paktit për Universitetin kemi ndërmarrë një nismë, ku të gjitha vendet e punës në administratën publike hapen për një vit për studentët ekselentë. Ne kemi punësuar një numër të madh të studentëve ekselentë, të cilët jo vetëm kanë përmirësuar CV-të e tyre, por edhe kanë freskuar administratën publike duke sjellë kreativitetin dhe energjitë e tyre.

Ligji për rininë nuk e adreson arsimimin e të rinjve, kjo është e vërtetë dhe nuk duhet të adresojë arsimimin e të rinjve, sepse ai adresohet përmes ligjit të arsimit parauniversitar, ligjit për arsimin e lartë, si dhe Paktit për Universitetin. Janë marrë të gjitha masat, ndoshta nuk është momenti t’i adresojmë nga e para, sepse ato u thanë kur u diskutua akti normativ, por është një buxhet shtesë për arsimimin e studentëve, janë ulur tarifat, janë dhënë bursa, për herë të parë është mundësuar karta e studentit. Në kuadër të Paktit për Universitetin është bërë shumë për arsimimin e të rinjve, pra janë marrë nisma, të cilat nuk janë ndërmarrë më përpara dhe nuk është e vërtetë që këto nuk janë marrë parasysh.

Atëherë, dua të bëj një përmbledhje...

Gramoz Ruçi – Mos flisni nga vendi, zoti Gjoni!

Besa Shahini – Shumë të shkurt, po bëj një përmbledhje lidhur me thelbin e ligjit “Për rininë”.

Për herë të parë mundësohet financimi me buxhet publik i organizatave rinore dhe i organizatave për të rinjtë. Për herë të parë mundësohet mbështetja e rinjve që të organizohen, të angazhohen për të mirën publike, si dhe të jenë pjesë përbërëse e zhvillimit shoqëror.

Kështu që unë ju ftoj ta votoni ligjin. Unë shpresoj dhe besoj se i qartësova disa nga elementet, që kishin mbetur pezull, lidhur me keqinterpretimet e bëra nga opozita.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Ministre!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Jo, nuk ka procedurë tani!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Zoti Gjoni, mësoni rregullat! Jemi në momentin kur deputetët do të flasin në emër të grupeve parlamentare dhe asnjë tjetër nuk ka të drejtë ta marrë fjalën!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Jo, asnjëri! Ishte sqarim për problemin që ngriti!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka zonja Almira Xhembulla.

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

Almira Xhembulla – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të dashur të rinj dhe të reja,

Kur flasim për rininë, në fakt, duhet të kuptojmë se ne nuk po flasim për jetën dhe të ardhmen e një grupi të caktuar, por për të ardhmen e të gjithë vendit. Kjo ka të bëjë pikërisht me hapësirat që ne po i krijojmë këtij grupi të shoqërisë, i cili do të vendosë se çfarë dëshiron të bëjë në të ardhmen, nëse do që të investojë në vendin e tij apo preferon t'i drejtohet tregut të punës përtej kufijve. Sigurisht, në kushtet ku jetojmë sot, për aq kohë sa u nënshtrohemi rregullave dhe normave ligjore respektive, gjithkush ka të drejtë të vendosë se ku do ta ndërtojë të ardhmen e tij. Ne, si politikanë, jemi të detyruar t'u krijojmë kushte më të mira dhe më të favorshme të rinjve tanë, në mënyrë që ata të investojnë dhe të kontribuojnë në vendin tonë. Natyrisht, e gjitha kjo ka të bëjë me shpresën që ne u japim këtyre të rinjve. Për

aq kohë sa ne do të krijojmë hapësira punësimi, edukim cilësor, angazhim në politikë dhe në të gjithë sektorët, që prekin jetën sociale të komunitetit; kushte më të mira ekonomike për një shkallë më të lartë mirëqenieje, si dhe shumë politika të ngjashme, pa diskutim që do t'u ofrojmë atyre një mundësi më shumë për të qëndruar në vendin tonë. Është fakt që qeveria shqiptare ka marrë një sërë nismash në këtë drejtim, qofshin këto për sa u përket masave të ndërmarra në fushën e arsimit apo edhe për angazhim e tyre në drejtime të ndryshme, që prekin jetën e tyre dhe të komunitetit. Sot jam shumë pozitive kur shikoj punën e qeverisë, por edhe të ministrive dhe të agjencive qeveritare, të cilat, deri diku, ia kanë arritur qëllimit t'i bëjnë të rinjtë shqiptarë të ndihen të barabartë me të rinjtë europianë në shumë drejtime.

Pikërisht ligji “Për rininë” do të krijojë një mjedis të përshtatshëm si nga ana institucionale, ashtu edhe nga ana sociale, në mënyrë që të rinjtë ta gjejnë veten të përfshirë, të përfaqësuar, të mbështetur dhe të edukuar për të qenë qytetarë të denjë, ashtu si bashkëmoshatarët e tyre në Bashkimin Europian.

Dua të vlerësoj faktin se Ministria e Arsimit, përveç konsultimit me organizatat rinore, të cilat kishin një rol proaktiv në nxitjen e hartimit të këtij projektligji, organizoi një tur dëgjësash në 12 qarqet e Shqipërisë.

Ky projektligj ka si qëllim përcaktimin e veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve. Projektligji synon plotësimin e kuadrit ligjor ekzistues, që ndikon tek të rinjtë, si dhe rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse.

Nëpërmjet kësaj nisme ligjore synohet përmirësimi i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre nëpërmjet mundësive për zhvillim, edukim, punësim, shëndetësi, kulturë, si dhe nëpërmjet rritjes së numrit të pjesëmarrjes të të rinjve në shoqëri dhe në vendimmarrje.

Kuadri ligjor institucional për të rinjtë plotësohet me mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e përputhshmërisë me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare në këtë fushë; me përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve qendrore dhe vendore publike; me organizatat, të cilat

operojnë në fushën e rinisë; me krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, për pjesëmarrjen dhe për mbështetjen e tyre në përmbushje të potencialeve të tyre në interes të shoqërisë.

Sipas INSTAT-it, në janar të vitit 2019, në Shqipëri kishte 680 mijë e 564 të rinj të grupmoshës 15-29 vjeç. Pra, është një përqindje shumë e konsiderueshme e popullsisë që i përket kësaj moshe. Prandaj, prioritet i programit politik të Këshillit të Ministrave është zhvillimi i politikave rinore, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve nëpërmjet disa aktiviteteve.

Në këtë kuadër, ky projektligj i shërben përmirësimit të legjislacionit, rritjes së aktivizimit, pjesëmarrjes së të rinjve dhe vendosjes së standardeve për infrastrukturën në shërbim të tyre, duke prezantuar standardin e hapësirave rinore të sigurta.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se edhe OKB-ja në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të saj, specifikisht në objektivin nr. 8, është e shprehur qartë se angazhimi i qeverive për rininë duhet të jetë në drejtim të rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, në punësimin e plotë dhe produktiv, si dhe në punën e denjë për të gjithë. Prandaj, target në këtë dokument deri në vitin 2020 është zvogëlimi i kësaj përqindjeje. Sipas të dhënave të INSTAT-it ka një rënie të përqindjes së numrit të të rinjve të papunë, të paarsimuar apo të patrajtuar nga viti në vit.

Qeveria shqiptare po bën përpjekje të vazhdueshme për të investuar në arsim, në shkolla profesionale, në ngritjen e qendrave multifunksionale, por edhe në ngritjen e qendrave rinore.

Ne jemi të ndërgjegjësuar që të rinjtë, ashtu si në çdo vend tjetër të rajonit, kanë dëshirë, por edhe të drejtë të edukohen, të punojnë dhe të jetojnë në vende më të zhvilluara, por është detyra e qeverisë të përpiqet, ashtu siç po bën, që të përmirësojë kushtet dhe infrastrukturën, të shtojë mundësitë e edukimit, të nxisë dhe të mbështesë të rinjtë.

Sipas INSTAT-it, shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë, meqenëse iu referuam disa herë, është 20,9% dhe në terma vjetorë kjo shkallë papunësie shfaq një tendencë në rënie.

Shkalla e papunësisë për të rinjtë, krahasuar me 3-mujorin e dytë të vitit 2018, është 1,7% më e ulët dhe, krahasuar me 3-mujorin e parë të vitit 2019, shkalla e papunësisë për të rinjtë ka pësuar një rënie me 1,3%.

Dua të përmend këtu se punësimi i më shumë se 600 studentëve ekselencë në administratën publike ishte një nismë shumë motivuese, por edhe inspiruese për të rinjtë. Ndërkohë, projektligji që po diskutojmë, pa diskutim, përfaqëson një akt ligjor të veçantë për të rinjtë, një bazë ligjore për një model të ri të përmirësimit të statusit shoqëror dhe pozitës së të rinjve e të rejave, i cili i shërben mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të tyre.

Nëpërmjet mekanizmeve efikasë, të pasqyruara në këtë projektligj, mundësohet fuqizimi i të rinjve dhe pjesëmarrja e tyre aktive në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, gjë që siguron edhe rritjen e numrit të tyre në politikë.

Nëpërmjet këtij projektligji bëhet edhe rregullimi i koncepteve të edukimit joformal për të rinjtë, përcaktimi i qartë i rolit dhe i përgjegjësisë të autoriteteve përgjegjëse, si dhe i misionëve përkatëse dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor për mbrojtjen dhe fuqizimin e të rinjve.

Në projektligj definohet qartë se cilat janë organizatat rinore dhe çfarë do të përfaqësojë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore.

Gjithashtu, projektligji bën një definicion shumë të qartë se kush do të merret me rininë, sepse, në thelb, ai do të mundësojë marrëdhëniet nëpërmjet organizatave rinore. Gjithashtu, për herë të parë, nëpërmjet këtij projektligji do të mundësohet financimi i organizatave rinore. Në fakt, theksoj se bashkëpunimi institucional me organizatat rinore është një hap shumë domethënës i një qeverisjeje të mirë për të rinjtë. Gjithashtu, dua të përmend se ky hap duhet të vlerësohet nga organizatat rinore dhe të shfrytëzohet prej tyre për të maksimalizuar përpjekjet.

Para se të mbyll fjalën time, nisur nga sa thashë më sipër, dua të theksoj edhe një aspekt tjetër pozitiv që do të sjellë ky ligj, sepse mendoj se është shumë i rëndësishëm për të gjithë ne. Pavarësisht hapësirave dhe synimeve që do të krijojë ky ligj, ai do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në zhvillimin, në trajnimin

dhe në formimin vazhdues të të rinjve, në një kohë kur shumë prej tyre, ndoshta më shumë në vendet e rajonit, kanë rënë dhe po bien pre e synimeve dashakeqëse të organizatave dhe grupimeve të ndryshme radikale dhe terroriste. Pra, nëpërmjet hapësirave dhe mundësive që do të krijojë ky ligj, të rinjtë tanë do të jenë më socialë, më të përgjegjshëm dhe më të përfshirës në vendimmarrjet e tyre.

Të përfshirë në proceset e ndryshme sociale të zhvillimit të shoqërisë ata, në shumicën e rasteve, do të dinë ta dallojnë të mirën nga e keqja dhe do të jenë më racionalë ndaj situatave, me të cilat do të përballen.

Unë dua të falënderoj kolegët, veçanërisht kolegët e Komisionit të Ligjeve, të cilët ndihmuan në përmirësimin e këtij projektligji, por edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, të cilët u angazhuan, punuan, si dhe morën kohën e mjaftueshme për të reflektuar ndryshimet e duhura, duke përfshirë në këtë projektligj edhe komentet me vlerë të grupeve të interesit.

Të nderuar kolegë, ju ftoj ta votojmë këtë projektligj, i cili i siguron rinisë hapësira, mundësi dhe mirëqenie.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Këtu mbyllet debati për ligjin “Për rininë”.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Urdhëro, merreni fjalën 2 minuta!

Rudina Hajdari – E para, zonja Shahini, më përmendi emrin dhe, sipas nenit 50 të Rregullores së Kuvendit, kam të drejtën e replikës 2 minuta.

Zonja Shahini, ju e keqcituat fjalimin tim. Gjatë fjalës sime unë nuk përmenda në asnjë fjalë që ky projektligj ka të bëjë me një parlament rinor. Para disa muajsh unë kam qenë e pranishme, si e ftuar nderi, në një parlament rinor, ku ju nuk ishit e pranishme, ku folëm pikërisht për këtë projektligj. Unë e kam lexuar shumë mirë ligjin dhe e di shumë mirë kur them se ky projektligj është i pambështetur nga shoqëria civile. Në fakt, nuk dua të përdor një gjuhë vulgare, sepse nuk më vjen mirë t’i drejtohem një zonje në këtë lloj mënyre, por juve duhet t’ju vijë turp që i thoni shoqërisë civile se jeni mbështetëse e opozitës apo e disa individëve këtu. Çfarë do të thoni ju me këtë?! Ju doni të tregoni këtu se shoqëria civile është e përçarë?! Ju doni të tregoni këtu se shoqëria civile ka

ngjyra politike?! Me çfarë risie i edukoni ju sot të rinjtë, duke u thënë se shoqëria civile ka tendenca politike?!

Zonjë, të më falni, por ju jeni e para që nuk e respektoni shoqërinë civile! Çfarë risie sjell ky projektligj? Ti nuk më the një organizatë që e ka mbështetur këtë projektligj; nuk më the si e nxit punësimin për rininë ky projektligj; nuk më the si do t’i shërbejnë rinisë këto qendra sot; nuk më the absolutisht asgjë, por hodhe vetëm akuza drejt opozitës. Unë nuk e di se kush të ka mësuar të flasësh në këtë lloj mënyre! Unë e kam parë në video edhe mënyrën se si ti u flet studentëve. Realisht, është turp të ju flasësh në këtë lloj mënyre. Më falni, por bazohu edhe te projektligji “Për rininë” në Kosovë. A ka sjellë ai ligj ndonjë gjë për rininë e Kosovës? Ma thoni ju sot, sepse ju e dini shumë mirë, se jeni edhe qytetare e Kosovës, pra ky ligj...

(I ndërpritet fjala, sepse i mbaron koha në dispozicion.)

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, zoti Gjoni!

Ralf Gjoni – Zoti Kryetar,

Është e pahijshme për ministren Shahini t’i drejtohet opozitës me tone fyese. Ju lutem...

(Zotit Gjoni i ndërpritet fjala)

Gramoz Ruçi – Uluni poshtë!

Nuk ka procedurë të thuash se është e papranueshme për ministren.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Uluni poshtë! Kjo nuk është për procedurë!

Uluni, se do të marr masa t’ju nxjerrin nga salla! Uluni! Mos e zaptoni foltoren, sepse do t’ju nxjerr nga salla! Uluni dhe mos abuzoni më me procedurën!

Vazhdojmë me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës”.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Për këtë projektligj kanë regjistruar emrat deputetët: Myslim Murrizi, Alket Hyseni, Luan Duzha, Sadi Vorpsi dhe Elona Gjebrea.

Fjala për zotin Murrizi. Të përgatitet deputeti Alket Hyseni.

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt, do të doja që dikush nga qeveria ta parashtronte ratifikimin e marrëveshjes, por, siç duket, pas fjalës së ministres së Arsimit, zonjës

Shahini, anëtarët e tjerë të kabinetit nuk e shohin me vend që të flasin për ligjin tjetër.

Kam dy fjalë për patosin me të cilin diskutoi drejtuesi, sikur na kishte thirrur argat dhe nuk më erdhi mirë fare! Ndoshta e ka për herë të parë që flet. Dufin e maxhorancës shfryje në vend tjetër, zonja Ministre, jo me ne. Nuk kam qejf të të kthehem, sepse të shoh edhe si mikeshë në këtë sallë, por, po të mos kisha pasur zotin Korab Lita afër... Gjysmat e fjalëve nuk t'i mora vesh, sepse unë jam matanë Shkumbinit me shtëpi. Gjithsesi, herë tjetër pak më ngadalë dhe më me qetësi, sepse nuk të kemi futur ne në punë dhe as besoj se të heqim ne nga puna. E bërthura e fortë nuk të bën ministre të fortë, je aty nga njohjet personale dhe nuk të kanë votuar këta këtu, si jo pak kolegë të tjerë.

Për ratifikimin e marrëveshjes për Konventën e Gjenevës, që ne po kërkojmë ta realizojmë sot, së pari, ne do të votojmë pro, ashtu siç kemi thënë ditën që unë, zonja Hajdari dhe dy kolegët e tjerë mbajtëm mandatet, por edhe kolegët e ardhur rishtazi. Ne do të vazhdojmë të votojmë pro për çdo ratifikim marrëveshjeje me çdo vend anëtar ose jo të Bashkimit Europian dhe për çdo nismë ligjore që i përket reformës në drejtësi apo ecjes së vendit përpara drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Ajo që dua të theksoj lidhur me këtë marrëveshje është që të mos na e sillni si diçka të re, sepse nuk është risi e kësaj maxhorance. Kjo konventë është ratifikuar nga qeveria e Ahmet Zogut, të cilin partia juaj paraardhëse për 45 vjet rresht e shau dhe çfarë nuk tha, më 20 prill të vitit 1929 dhe dy vjet, pasi është ratifikuar në të gjitha parlamentet e atyre viteve, ka hyrë në fuqi më 22 shkurt të vitit 1931. Ne, po të nisemi nga tabjatet që bëjmë, po i japim një dorë bojë gëlqeres së dalë të 29 vjetëve, meqenëse na vjen zor të kërkojmë falje, për atë që 90 vjet përpara ajo qeveri që ka qenë, paska qenë shumë largpamëse dhe e ka ratifikuar këtë marrëveshje.

Veprat penale për përdorimin e monedhës false ne i kemi të përcaktuara në Kod. Mua nuk do të më vinte mirë po ta dija se ky ligj ose kjo konventë, e cila ratifikohet sot këtu, vjen për t'i shërbyer edhe ngjarjes suaj të fundit. Po ta kishim ratifikuar pak më parë këtë konventë, Kajmaku i Vorës mund të rrezikonte më shumë nga ajo çfarë ka rrezikuar në Janinë për këtë

vepër penale. Kajmaku paska qenë me fat që ne e ratifikojmë sot, ai është larguar pardje. Pyetja që bëra edhe në Komisionin e Sigurisë ishte: a kemi ne kapacitete si vend (jo çdo gjë të zezë që na vjen nga importi duhet ta marrim përsipër sikur është një gjë e zezë jona) që të prodhojmë monedhë false?! Unë jam skeptik për këtë dhe them se nuk kemi kapacitetin e duhur. Ne, maksimumi që kemi bërë, nën politikën orientuese të qeverisë, kanë qenë serrat e hashashit, ku prodhuam hashash sa qelbëm dynjanë, por këtë teknologji të hollë me të cilën prodhojmë euro false nuk besoj se e bëjmë dot, sepse, po të ishte kështu, do të ishim vendi më i pasur në botë. A ka raste që këtu vijnë monedha false?! Po, disa vijnë me trasta dhe bëhen me targa CD dhe pasaportë diplomatike, sepse i shpallim konsuj nderi ata që vijnë me trastë, kur paguajnë xhake, dhe disa na vijnë ilegalisht me skafe e patenta trajleri dhe skafi kapen me trastë në Elbasan, siç ishte rasti i kampionit tuaj. Ndaj, nuk dua t'i bëni shumë reklamë dhe të na e paraqitni si arritje të madhe që po e ratifikojmë apo po gërricim atë që vetë e kemi anashkaluar, apo abandonuar për 45 vjet komunizëm, gjë që është miratuar nga një qeveri para 90 vjetësh. Gjithsesi, raste konkrete, kam pyetur edhe zëvendësministrin në komision dhe nuk mora ndonjë përgjigje, për këtë lloj vepre, përveç Kajmakut, nuk gjykoj se ka pasur ndonjë historik apo rekord të madh, që ne duhet ta mbajmë shënim, në Republikën e Shqipërisë. Rastet më të shumta janë ato kur shqiptarët janë përdorues të atyre monedhave, që i fusin nga jashtë, ose ua japin nga andej dhe vijnë e marrin në qafë ndonjë fatkeq këtu që i merr në xhep. Nuk besoj se asnjë nga ne, aq më shumë 1 milion e 200 mijë familje shqiptare, të kenë aparat, siç ka banka, për të parë ato 5 lekë nëse janë ose jo false kur shesin domate, qumësht, shalqi apo djathë në pazar. Historiku më i rëndomtë i kësaj vepre dhe i këtyre ngjarjeve në prokurorinë shqiptare ka qenë që është kapur përdoruesi i fundit, pra, më fakiri. Ndaj, mendoj se duhet parë me kujdes. Po t'i bllokoni mirë portat hyrëse dhe të mos i lini ata, të cilët i titulloni "Konsuj nderi", të vijnë me trasat me nga 4-5 milionë euro dhe të zhvishni me rrip pantallonash bizneset kur ikin për të blerë po i kaluan 10 mijë e 1 euro, unë besoj se prokuroria dhe drejtësia shqiptare, nuk do të kenë asnjë lloj ngarkese për këtë vepër penale.

Ne duhet të jemi koshientë që nuk prodhojmë dot lekë falsë, maksimumi që mund të bëjmë është të marrim në aeroport të Rinasit lekët që bankat i çojnë jashtë shtetit, por që të kemi fabrikë, e cila prodhon këto lloj monedhash, nuk e besoj.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi - Dua të bëj një sqarim. Lidhur me ndërhyrjen për Ministren e Arsimit, me përjashtim të zonjës Rudina Hajdari, e cila kishte të drejtë të replikonte për të vetmen arsye se gjatë kohës që ajo foli ministria nuk ishte në sallë, zoti Murrizi, dua t'ju tërheq vëmendjen për një gjë: nuk mund t'i thuhet ministres së Arsimit që s'ju mora vesh gjysmën e atyre që thatë këtu në sallë. Nuk ka komb....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dëgjo deri në fund! Nuk ka komb në botë që treva të ndryshme të mos kenë dialekte të ndryshme, qoftë në Francë, qoftë në Itali, qoftë në Gjermani, po kështu edhe në Shqipëri. Megjithatë, ashtu sikurse kam unë dialektin tim andej nga jam, ashtu sikurse keni ju dialektin andej nga jeni, të njëjtin dialekt ka edhe zonja andej nga është. Ne jemi të gjithë të detyruar të respektojmë dialektin e njeri-tjetrit dhe të gjithë jemi shqipfolës. Prandaj, ju lutem shumë, mos krijoni probleme të tilla në sallën e parlamentit!

Deputeti Alket Hyseni nuk është.

Fjalën e ka deputeti Luan Duzha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ju njoftoj për të disatën herë, mos ndërhyri nga vendi!

Luan Duzha - I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në seksionin VII të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, neni 183, shohim se falsifikimi i monedhave ose vënja e tyre në qarkullim dënohet me burgim deri në 5 vjet, ndërsa në rastin e përsëritjes dhe të qenit në bashkëpunim dënimi për këtë vepër penale shkon deri në 15 vjet.

Në fushën e falsifikimeve, me vend është të theksojmë se falsifikimi i monedhave ndëshkohet më rëndë se llojet e tjera. Për shembull, falsifikimi i letrave me vlerë dënohet me 5 vjet, dhe, në rast sjelljeje pasojash të rënda, përsëritjeje dhe bashkëpunim, dënimi shkon deri në 10 vjet. Prodhimi i mjeteve të falsifikimit dënohet me 3-10 vjet; 3-7 vjet shkojnë kategoritë e ndryshme të dënimit të falsifikimit të dokumenteve dhe deri në 5 vjet, në varësi të

rrethanave, shkon falsifikimi i dokumenteve shkollore dhe shëndetësore. Në këtë logjikë, kjo barrë më e rëndë dënimesh nënkupton, së pari, nivel më të lartë rrezikshmërie shoqërore dhe, së dyti, nevojë më të madhe shoqërore për parandalimin dhe ndëshkimin për ta dekurajuar këtë lloj veprë penale për një shoqëri.

Raporti që zë falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2017 është 0,26 % e kriminalitetit të përgjithshëm. Në të njëjtin nivel, 0,26% e kriminalitetit, mbetet edhe në raportin e vitit 2018. Po t'u referohemi raporteve që Prokuroria e Përgjithshme i paraqet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për vitet 2017 dhe 2018, vërehet se koeficienti i kriminalitetit për 100000 banorë për këtë grup veprash penale në vitin 2017 është 2,8, ndërsa për vitin 2018 ka një rritje të lehtë, rreth në 2,86.

Në vitin 2017 janë rreth 78 procedime për veprën falsifikim, ndërsa në vitin 2018 numri i procedimeve është rritur me saktësisht 80 të tilla. Këto të dhëna na dëshmojnë se dukuria e falsifikimit të monedhave është prezente dhe e luhatshme. Nga grupet kriminale ajo shihet përherë si një formë e shpejtë dhe e paligjshme përfitimesh në para dhe pronash të paluajtshme. Qarkullimi i tyre zinxhir në ekonominë vendase, siç studimet ndërkombëtare tregojnë, rëndojnë qarkulluesit më të paktë të shumave kesh, pra, shtresat më të varfra. Në këto rrethana në Kuvendin e Shqipërisë vjen edhe projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës”, e cila është nënshkruar në Gjenevë më 20 prill 1929 dhe ka hyrë në fuqi më 22 shkurt 1931. Kjo Konventë bën të mundur realizimin e një hapi përpara drejt konsolidimit të kuadrit ligjor në fushën e falsifikimit të monedhës. Me anë të aderimit vendi ynë merr përsipër të drejta dhe detyrime që lindin nga kuadri ndërkombëtar ligjor, si dhe siguron parandalimin dhe dënimin e veprës penale të falsifikimit të monedhës nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare, duke shkëmbyer informacion me anë të zyrës qendrore. Ky bashkëpunim pritët të realizojë objektivat lidhur me evidentimin e shkeljeve dhe marrjen e masave të përbashkëta në luftën kundër falsifikimit të monedhës, duke respektuar

legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi.

Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj konvente lidhen me luftën kundër falsifikimit të monedhës, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit. Palët kontraktuese do të konsultohen lidhur me problematikat që mund të lindin brenda kuadrit ligjor vendas dhe do të ndërmarrin masa të përbashkëta kundër veprës së falsifikimit të monedhës. Hetimet mbi subjektin do të organizohen nga një zyrë qendrore, e cila do të krijojë komunikim të drejtpërdrejtë me zyrat e tjera simotra. Ngritja e zyrës qendrore nuk do të ketë kosto shtesë, pasi do të pozicionohet në ndërtesën aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në buxhetin aktual të Policisë së Shtetit për vitin përkatës. Nuk do të ketë efekte financiare shtesë për personelin, pasi punonjësit do të jenë pjesë e strukturës aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Krijimi i kësaj qendre nuk do të sjellë mbivendosje me sektorët e tjerë, që luftojnë krimin ekonomik dhe financiar në Policinë e Shtetit, pasi detyrat e qendrës janë të mirëpërcaktuara dhe të pavarura nga detyrat e sektorëve të tjerë.

Sa më sipër, është një zhvillim pozitiv që e shëndoshë sigurinë e monedhave, që qarkullojnë në ekonominë tonë dhe, si e tillë, meriton të mbështetet pa mëdyshje nga të gjitha palët.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Fjalën e ka deputeti Sadi Vorpsi.

Sadi Vorpsi - I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës”. Kjo konventë bën të mundur realizimin e një hapi para drejt konsolidimit të kuadrit ligjor në fushën e falsifikimit të monedhës. Shqipëria e ka ratifikuar konventën në vitin 1929, por që nga ai vit nuk është bërë pjesë e rendit juridik të brendshëm, sepse nuk është depozituar dhe nuk është aprovuar kurrë një instrument ratifikimi.

Të gjithë e dimë se Shqipëria ka ndërmarrë procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian, në kuadër të kapitullit XIV “Liria, drejtësia dhe siguria”. Pasi të bëhej

ekzaminimi i thellë i legjislacionit ekzistues dhe të krahasohej me atë të parlamenteve europiane, duhej të adoptohej një instrument i tillë. Gjithsesi, është një instrument i vlefshëm që shkon në të njëjtin drejtim me politikat e Ministrisë së Brendshme dhe me impenjimet konkrete të Policisë së Shtetit për sa i përket luftës kundër krimit, duke pasur parasysh se falsifikimi, por edhe qarkullimi i monedhave të falsifikuara shpeshherë paraqesin probleme për ekonominë.

Në kuadër të Planit Kombëtar për Integritetin Europian, por edhe të programit analitik të akteve të Ministrisë së Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke analizuar përmbajtjen, ka parë të arsyeshme të propozojë aderimin në këtë Konventë, pikërisht për të forcuar parandalimin, hetimin dhe dënimin e veprave penale, që lidhen me falsifikimin e monedhës.

Të gjithë kemi dëgjuar raste sporadike, sepse ky fenomen nuk është shumë i theksuar në vendin tonë, por, gjithsesi, duhet të theksojmë fort se, për sa kohë do të tentojmë ta përafrojmë legjislacionin tonë me standardet ndërkombëtare dhe standardet e BE-së, një hap i tillë është i domosdoshëm.

Me anë të aderimit, vendi unë merr përsipër të drejta dhe detyrime, që lindin nga kuadri ndërkombëtar ligjor, si dhe siguron parandalimin dhe dënimin e veprës penale të falsifikimit të monedhës nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare, duke shkëmbyer informacione me anë të zyrës qendrore. Ky bashkëpunim pritet të realizojë objektivat në lidhje me evidentimin e shkeljeve dhe marrjen e masave të përbashkëta në luftën kundër falsifikimit të monedhës, duke respektuar legjislacionin ndërkombëtar në fuqi.

Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj konvente, lidhen me luftën kundër falsifikimit të monedhës, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin dhe do të përmirësojnë shkëmbimin e informacionit. Palët kontraktuese do të konsultohen në lidhje me problematikat që mund të lindin brenda kuadrit ligjor vendas dhe do të ndërmarrin masa të përbashkëta kundër veprës penale të falsifikimit të monedhës.

Hetimet për subjektin e falsifikimit do të organizohen nga një zyrë qendrore, të cilat do të krijojnë komunikim të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën.

Aderimi në këtë konventë ka edhe kosto financiare për krijimin e zyrës qendrore edhe për personelin përkatës, por nuk do të ketë efekte mbi buxhetin shtesë, sepse është menduar që kjo zyrë qendrore të krijohet brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pra, për sa u përket ambienteve ato do të jenë në të njëjtën seli. Gjithashtu, do të jetë i njëjti personel i Policisë së Shtetit, që, natyrisht, do të bazohet te buxheti i këtij viti dhe i atij pasardhës.

Krijimi i kësaj qendre nuk do të sjellë mbivendosje me sektorët e tjerë, që luftojnë krimin ekonomik dhe financiar në Policinë e Shtetit, pasi detyrat e qendrës janë të mirëpërcaktuara dhe të pavarura nga detyrat e sektorëve të tjerë. Besoj se shumë shpejt do të paraqiten edhe ndryshimet e Kodit Penal, në mënyrë që të harmonizohet dhe të unifikohet gjuha e përdorur. Pra, duke pasur parasysh se teksti i Konventës është relativisht i vjetër, duhet që gjuha e përdorur të harmonizohet me termat modernë që përcaktojnë fenomene të caktuara.

Të nderuar kolegë, nisur nga sa më sipër, si dhe për vetë rëndësinë që paraqet ky projektligj, pasi aderimi në këtë Konventë është një detyrim formal, në kuadër të procesit të hapjes së negociatave, i cili e vendos Shqipërinë para përgjegjësisë për të përshtatur legjislacionin e saj me atë ndërkombëtar, kryesisht të BE-së, por edhe për ta plotësuar në ato vende ku nuk është konsoliduar, ju ftoj ta miratojmë të gjithë së bashku këtë projektligj.

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Vorpsi!

Në emër të Grupi Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka zonja Gjebrea.

Të njoftohen kolegët deputetë së pas këtij diskutimi do të fillojmë me procesin e votimit.

Elona Gjebrea – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë dhe qytetarë,

Unë do të flas shkurt për Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës, pasi folën të gjithë kolegët. Kjo Konventë siguron parandalimin dhe dënimin e veprës penale të falsifikimit të monedhës nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare, duke shkëmbyer informacione me zyrën qendrore.

Shkurtimisht, kjo Konventë përcakton rregullat për të siguruar parandalimin dhe dënimin e veprës së falsifikimit të parave;

përcaktimin e veprës penale të falsifikimit të monedhës; rregullimet për parimin e ekstradimit të shtetasve; masat ligjore për sekuestrimin dhe konfiskimin e monedhës së falsifikuar; transmetimin e mostrave dhe kopjeve të zyra qendrore në rastet kur ligji vendos kërkon ruajtjen e tyre si dosje për hetimin penal; funksionimin e zyrës qendrore, parimet e komunikimit midis palëve, me qëllim centralizimin e informacionit dhe përcjelljen e tij dhe dhënien e ndihmës në procesin e hetimit dhe ndjekjes penale; rregullimin e transmetimit dhe ekzekutimit të letër- kërkesave nga palët kontraktuese; dënimet për veprat e lidhura me falsifikimin e monedhës, si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me këtë konventë.

Pa dyshim, zyra qendrore ka rolin kryesor për centralizimin e të gjithë informacionit dhe lehtësimin kështu të hetimit, parandalimit dhe dënimin të falsifikimit të monedhës.

Republika e Shqipërisë shpreh angazhimin e saj për ta bërë këtë Konventë pjesë të rendit juridik të brendshëm. Prandaj, të nderuar deputetë, ju ftoj që ta miratojmë atë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Këtu mbyllet debati për çështjet që kishim sot në rendin e ditës.

Të njoftohen kolegët që të marrin pjesë në votim.

Uluni, kolegë, që të fillojmë votimin.

(Pas pushimit)

Gramoz Ruçi – Uluni, kolegë!

Rifillojmë seancën me votimet.

Të futet media!

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

Janë të pranishëm 108 deputetë.

Fillojmë me aktin normativ nr. 2, datë 02.10.2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019””. Ky akt normativ kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim. Është një votim i hapur me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 80 vota pro, 25 kundër, 3 abstenime.

Miratohet.

Vazhdojmë me aktin normativ nr. 3, datë 02.10.2019 “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar””. Edhe ky akt normativ kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 83 vota pro, 22 kundër, 2 abstenime.

Miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për rininë”.

Ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 78 vota pro, 24 kundër, 4 abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen me kartonë, sipas variantit integral të paraqitur nga komisioni përgjegjës dhe sipas rekomandimeve të bëra nga komisionet. Komision përgjegjës është Komisioni për Edukimin...

Ju lutem, dëgjoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Komisione për dhënie mendimi janë Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Komisioni i Integritetit Europian.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Nga neni 3 deri te neni 20 u ndoq e njëjta procedurë votimi.)

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 79 vota pro, 23 kundër, 4 abstenime.

Miratohet në tërësi.

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës”.

Zoti Balla...

Taulant Balla – Kërkoj mirëkuptimin edhe të grupeve të tjera parlamentare, duke qenë se te kjo marrëveshje është përdorur termi “ratifikim” dhe ka pasur një diskutim për të qenë edhe termi “aderim”. Në këtë kontekst, do të nevojitet që edhe Ministria e Jashtme të japë një opinion të vetin.

Kërkoj shtyrjen e votimit të këtij projektligji në seancën pasardhëse. Ky diskutim është bërë në Komisionin e Çështjeve Ligjore. Besoj se kam edhe miratimin e kolegëve të grupeve të tjera parlamentare për ta shtyrë votimin për seancën pasardhëse.

Gramoz Ruçi – Kush është dakord, me kartonë, për ta shtyrë votimin për radhën tjetër? Diskutimi është bërë.

Dakord. Shtyhet për votim në seancën e radhës.

Projektvendim për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”.

Nga maxhoranca, zoti Balla, ka ndonjë gjë për të shprehur? Nuk ka.

Nga grupet parlamentare të opozitës ka ndonjë gjë për të shprehur? Nuk ka.

Komision përgjegjës është Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese. Komisione për dhënie mendime janë Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shqyrtimi do të bëhet në seancën plenare të datës 14.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë vota 94 pro, asnjë kundër, 1 abstenim.

Miratohet.

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim projektrezolutën “Për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare”. Shqyrtimi i kësaj projektrezolute në komisionet përkatëse të bëhet me përparësi për t’u shqyrtuar në seancën plenare të datës 14. Komision përgjegjës caktohet Komisioni për Sigurinë Kombëtare, kurse komision për dhënie mendimi do të jetë Komisioni për Politikën e Jashtme.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 92 vota pro, 2 vota abstenime, asnjë votë kundër.

Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 100/2017 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar””. Me

propozim të Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, deputetja Artemis Dralo caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 97 vota pro, asnjë votë kundër.

Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 99/2017 “Për ngritjen e Nënkomisionit për Qeverisjen Vendore, në përbërje të Komisionit të përhershëm parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, të ndryshuar”. Me propozim të Kryetarit të Grupit Parlamentar të Pavarur, deputetja Aurora Mara caktohet anëtare zëvendësuese në këtë nënkomision.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 98 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim.

Këtu përfundon votimi për çështjet që kishim në rendin e ditës së sotme.

Faleminderit!

Seanca e radhës do të njoftohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Më falni!

Ju lutem, janë regjistruar dy deputetë për të diskutuar për çështje jashtë rendit të ditës.

Fjalën e ka deputeti Kostaq Papa.

Ju lutem, kolegë deputetë, kush dëshiron të qëndrojë në sallë, të ulët, kurse të tjerët të largohen pa bërë zhurmë.

(Diskutime pa mikrofon në sallë)

Kostaq Papa – ..., sepse përpjekjet e kodifikimit të proceseve të përfaqësimit të popullit nuk mund të mbysin dot vullnetet politike, proceset dhe kërkesat për ndryshime reformatore procesesh apo formatesh klishe, sepse përmbajtja përcakton formën dhe jo forma përmbajtjen.

Pavarësisht se partitë shtetformuese në 30 vjet tranzicion të vështirë dhe të pështirë shqiptar, bazuar në reminishencën e paraardhësve të tyre të nomenklaturës, u përpoqën dhe garantuan qeverisje drejt shifrave absolute edhe në mandatet e dyta, koha i përgënjeshtroi ata, sepse vjen momenti dhe gjërat ndryshojnë.

Prurjet e reja janë vlera e këtij parlamenti, sepse sjellin ndryshimin, kërkojnë ndryshimin

dhe krijojnë rotacion me procese të shpejta. Në ndryshim nga stancioni i parlamentit të mpakur, sherrxi, politikëfrenues, procesfrenues, ndryshimi fillon me forca demokratike, sepse vota e popullit nuk mund të ishte përfaqësuar në një panel prej vitesh. Të gjitha votat e djathta i përfaqësonte partia e djathtë me emër, por që realizoi vetëm procese të majta tranzicioni, duke filluar me ligjin nr. 7501 “Për token”. Tani të djathtët po përpiqen të dalin në dritë, të gjejnë vetveten, të përfaqësojnë grupin e tyre shoqëror, sepse i pengonin të dilnin në dritë më parë.

Zotërinj, ka 30 vjet që është shembur Muri i Berlinit, që ishte i pashembshëm, kurse ju flisni akoma për formatime dhe firmosje për gjëra që mund të ndryshojnë në mënyrë të shpejtë.

Lejojeni reformimin politik të ndodhë, sepse është i domosdoshëm, është emancipim dhe zhvillim. Ju keni frikë, sepse po vjen koha për rformatimin e së majtës dhe doni t’i trembni ata përmes rreshtimit dhe ligjeve tuaja.

Në fjalën time doja t’i jepja një përgjigje Mentorit, Muçit, por, më falni për shprehjen, edhe disa MM-ve të tjerë, që përpiqen të hedhin baltë mbi opozitën parlamentare. Nuk përbën ndonjë problem se janë dy-tri raste problematike në këta djem dhe vajza të së djathtës, në një kohë kur tellallë të tillë të medias dhe shtypit nuk folën asnjëherë për këta 30 vjet, por u bashkuan me maxhorancat e ndryshme të kësaj periudhe vetëm e vetëm për të përfutur në situata të caktuara rrogën dhe të ardhura të tjera si media të blera.

Këta tellallë të mirëpaguar duan zgjidhje të menjëhershme që të mos ndryshojë sistemi, të mos ndryshojë klasa politike, të mos ndryshojë fytyra e Shqipërisë, që të vazhdojnë marrjen e fitimit të tyre nga padroni ku ata lehin në çdo gjiriz dhe që bashkë me padronin kanë 30 vjet që i qëndrojnë atdheut mbi kurriz.

Si nuk thonë një fjalë këta tellallë për pjesën tjetër në parlament, për këta rilindas që më së shumti janë analfabetë dhe u bëjnë temena të parëve të tyre? Jo këta djem e vajza të opozitës së re parlamentare, por ju, medie, bashkudhëtarë të kësaj klase të shitur politike, jeni pjesë e shitjes që kjo klasë politike të ngelet dhe të uzurpojë vendin në këta 30 vjet tranzicion të vështirë shqiptar.

Opozita e re parlamentare është një opozitë kombëtare, që përpiket të ndërmarrë reforma

radikale për të dalë shteti nga përgjumja, të dalë vendi nga kllapia, të largohet përmes votës së lirë klasa e kalbur politike dhe të përparojë Shqipëria. Opozita e re parlamentare, si opozitë kombëtare, është dhe do të jetë këtu derisa të garantojë zgjedhje të lira dhe të ndershme, vazhdimësinë e të gjitha reformave, kurse ata që kanë shpërdoruar pasurinë publike kombëtare do të shkojnë atje ku e kanë vendin. Kjo opozitë e re nuk do të shkojë pas avazit të askujt, por po përfaqëson denjësisht popullin e harruar nga ju, nga këta dhe nga ata që ikën, dhe është në anën e duhur të historisë për ta rikthyer Shqipërinë, këtë vend të mbrojtur nga Zoti në qiell dhe nga SHBA-ja në tokë, në binarët e duhur drejt integritetit të saj në Europë.

Vetëm opozita e re parlamentare mund të sjellë ndryshimin, ndaj merruni me vetveten për t'u reformuar ju si maxhorancë, por edhe tellallët tuaj të propagandës së drejtimit të paditur dhe të Shqipërisë që nuk duam.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Kujtim Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Do t'ju kisha thënë "I nderuar, zoti Kryetar", por nuk shkon të më thuash "Ulu poshtë!". Edhe kolegëve të tjerë u thua: "Ulu poshtë, ulu poshtë!".

Zoti Gramoz, nuk jemi në Salari, që të ulemi në bregun e Vjosës dhe të bëjmë dush, por jemi në parlamentin e Shqipërisë. Ju jeni Kryetar i Kuvendit dhe është e drejta juaj të rrini aty. E kam përsëritur dhe e them sërish: keni 50 mandate, që janë tuajat. I keni nga partia kriminale, Partia e Punës, Partia Socialiste. Keni edhe 24 mandate të tjera, që janë të dyshimta, plus 4 që i keni blerë këtu. Mos blini të tjera, sepse jeni duke blerë brenda grupit të së djathtës! Keni qejf të përçani të djathtën. Çfarë doni të bëni? Doni të ikim edhe ne? Nëse doni që të ikim edhe ne, është e sigurt që do të shkoni në zgjedhje të parakohshme. Në momentin kur të shkoni në zgjedhje të parakohshme, të mos gënjejë mendja njeri se do të vijë Lulzim Basha, Kryeministër. Të mos gënjejë mendja njeri! Ju këtu kërkon diell përmes Monika Kryemadhit që të ruani Presidentin dhe të mos e shkarkoni.

Taulant, pse nuk e shkarkoni Presidentin? I keni votat, Taulant. Pse nuk e shkarkuat, Taulant? Je kryetar i grupit, apo jo? Çfarë doni të

bëni? Nëse ju doni ta mbani Presidentin këtu, përgjegjësitë do të jenë më të mëdha. I fundit do të jetë Gramoz Ruçi, se e kam vëlla dreqin, e kam bektashi. Është vëllai më i madh. Çfarë t'i bësh?!

Unë po ju them të gjithëve se kemi ngërç Gjykatën Kushtetuese, Prokurorinë e Përgjithshme. Këtu ka ardhur mesazh kërcënues. Kryeministri thotë: "Nuk ishte kërcënues, ishte shaka, ishte kështu, ishte ashtu". Unë nuk e di pse në celular më ka ardhur ashtu. Unë nuk trembem, sepse kam jetuar në këtë vend. E thashë, edhe herën tjetër, që i kam pasardhësit. Jam nip në Mukje. Keni qejf ta provoni forcën? Nuk është mirë. Nëse dikush do të provojë forcë, që nga Kryetari i Kuvendit, le të vijë të përballet me mua. Si të doni. Si të keni qejf. Unë mendoj të jemi më të kujdesshëm.

Ti je toskan, unë jam alban, edhe me dardanët. Ti e di që kur u ngatërruat një herë, nxore punë të mëdha në këtë vend. Nuk është mirë.

Duke përfunduar sot, po them: Taulant, kur do ta bëjmë reformën për zgjedhje të lira, që të mos vjedhësh më, të mos thuash "nëndetësja" apo "vapori"?

Taulant, me ty e kam. Të kujtoj se në datën 26 shkurt 2017 keni filluar bisedimet me Lulzim Bashën. Mund të them edhe vendin ku ke qenë me Oerd Bylykbashin. Ta them edhe vendin ku ke qenë? Dakord?

Do ta bëni reformën në drejtësi, apo jo? Do ta bëni reformën zgjedhore, apo jo? Do ta bëni reformën administrative, t'i hiqni kryetarët e "Komitetëve Ekzekutivë", se del kryetari i Tiranës, që i ka autobusët zhul, zhul... Autobusët vijnë rrotull Tiranës dhe nuk pastrohen në stacionet fundore, Taulant. Çfarë e keni atë kryetar bashkie të kukllarasë, që na e bëri Tiranës kukllaraj? Kush është ai? Shmanguni! Kryeministri ka të drejtë ta heqë. Ka dy seanca që nuk është këtu. Është pa qejf, nuk e di si është puna e tij.

Taulant, do të flasim seriozisht, apo do të përdridheni? Juve ju gënjen mendja që do të merrni pushtet në vitin 2021? Harrojeni, sepse ka rotacion politik për herë të tretë, 8-vjeçare... Nuk ta falin ndërkombëtarët, edhe nëse doni, Taulant. Jemi anëtarë të NATO-s, jemi anëtarë të një aleance të Atlantikut të Perëndimit. Nuk ka shanse as një agjenturë që është lindore, jo se

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 4 NËNTOR 2019

nuk duhet Lindja, sepse pa Lindje nuk ka Perëndim, por ta harroni që mund të merrni pushtet tjetër këtu. Ta harroni! Ta harroni! Ta harroni! Le të shkojmë në qeveri akademike, transitore, 1 vit e gjysmë qeveri akademike në zgjedhjet e vitit 2021.

Nëse njerëzit e duan Partinë Socialiste, le ta gëzojnë, nuk ka asgjë të keqe, por ne do të jemi këtu në parlament, në opozitë me ju. Ta keni të sigurt që fryma konservatore, sa të vijë edhe ambasadorja e re, do të shikoni si do të ndryshohet.

Taulant, jam duke folur me ty. Ke përgjegjësi, je djale i ri. Ke edhe 20 vjet të tjerë për të ndenjur këtu në parlament. Ndryshe, të gjitha krimet që janë bërë këtu, që nga 15 mijë vajza shqiptare që janë shitur, i keni fshehur të gjitha ju: PD-ja, PS-ja, LSI-ja.

Janë 1500 kriminelë. Taulant, janë 1500 kriminelë. Taulant, kur unë di vendin ku drekon ti me Oerd Bylykbashin, imagjino se çfarë di ndonjë gjë tjetër. Nuk i di këto nga që jam shumë i zgjuar, sepse e kam thënë, e kam mangët 25% të formimit si pasojë e gjyshit që më keni vrarë ju...

Faleminderit, zoti Kryetar!

Herë tjetër do t'ju them "I nderuar", sikurse sot që e ktheve pikën e fundit të rendit të ditës për çështje të ndryshme.

Faleminderit për sot!

Gramoz Ruçi – Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.

(Seanca u mbyll në orën 17:00)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimi

Alket Hyseni

Drejtori i Shërbimit të Botimeve

**Parlamentare
Krenar Hajdëri**